

## **PROCESVERBALI**

Nga mbledhja VIII-të e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 28.06.2018, duke filluar nga ora 10:15, në sallën e Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm 38 anëtarë.

Të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, OSBE-ja, Zyra e EULEX-it, KFOR-it dhe përfaqësuesit e mediemeve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Artan Abrashi, kryesues.

Për këtë mbledhje janë paraparë këto pika për:

### **R E N D D I T E**

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;**
- 3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;**
- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2019 – 2021;**
- 5. Informatë rreth nivelit të zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal;**
- 6. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Planit të punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;**
- 7. Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Prizrenit;**
- 8. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale;**
- 9. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimvendimit për lejimin e hartimit të planit rregullues të hollësishëm “Parku i Inovacionit dhe Trajnimit“ për qytetin e Prizrenit ( ish zona e KFOR - it Gjerman);**
- 10. Informatë mbi raportin e Komisionit të përzgjedhjes së drejtorëve në Shkollë në Komunën e Prizrenit.**

**Pika e parë:**

**Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e Kuvendit të datës 31.05.2018.**

**Kryesuesi**, e hapi debatin lidhur me procesverbalet, duke pyetur se a ka dikush për të shtuar diçka?

**Shukri Quni (PDK):** Në procesverbalin e datës 26.04.2018, nuk është përfshirë debati në mes meje dhe drejtorit të Financave Ertan Simitçiu. Kërkoj që bisedat, debatet që zhvillohen, duhet të përfshihen të gjitha në procesverbal.

Nuk ka nevojë aty mi përmirësua dikush, ose mos mi shkrua. Ne, në mbledhjet e mëhershme i kemi dhënë edhe nga një CD çka kemi fol, kanë qenë incizimet. Kështu që, nuk mu dukë jo e mirë kjo që nuk është përfshi. Ka qenë dashtë mu përfshi krejt. Edhe të matet tjetër herë, pata mi thënë diçka, po s'qenka këtu, po e lë për tjetër herë. Kështu që ti përfshinë të gjitha tjetër herë.

**Alush Shala (PDK):** Edhe unë e përkrasi kolegun Shukri Qunin, pse mungon. Edhe unë mendoj që është bërë me qëllim, dhe nuk buhet bërë. Qoftë edhe nëse ka fol dikush, ai jep përgjegjësi vet. Edhe këtë po e mbro, kolegu im. Po megjithatë ka plot gabime. Unë e di që ju personalisht keni qenë nga ata ithtarët që s'duhet me pas shumë gabime. Ato po vazhdojnë përsëri me gabime. Ju kisha lut që edhe teknika ta ketë parasysh këtë pjesë të përgjegjësisë së vetë. Për këtë arsye unë nuk do ta votoj këtë procesverbal.

**Kryesuesi:** Dikush tjetër? Në qoftë se debati është zhvilluar me mikrofonta të ndalur, ju e dini shumë mirë ajo nuk regjistrohet në procesverbal. Mirëpo, në qoftë se është zhvilluar debati dhe është incizuar, atëherë ajo patjetër duhet të jetë pjesë e procesverbalit. Pavarësisht çka diskutohet në Kuvend, duhet këtu të shënohen. Andaj, e lus shërbimin e Kuvendit që këto vërejtje të anëtarëve të Kuvendit ti shqyrtoj edhe njëherë, të procesverbalit të kaluar. Dhe pse jo të kthehet praktika e mëhershme, ku krahas procesverbalit të shkruat të shpërndahen edhe audio incizime, ku nuk do të kemi më problem. Në qoftë se nuk ka dikush diçka tjetër të shtoj rreth procesverbalit, atëherë e hedh në votim, kush është për?

Për? – 21.

Kundër? – 1.

Abstenim? – 11.

Atëherë, konstatojmë se me 21 vota për, 1 kundër dhe 11 abstenime është miratuar procesverbali i mbledhjes së kaluara.

**Pika e dytë:**

**Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës të propozuar.**

**Kryesuesi,** a ka dikush të shtoi diçka për rënd dite të cilin e kemi paraparë në mbledhjen e fundit të KPF-së?

**Shukri Quni:** Qenka i ngarkuar shumë sot rendi i ditës, se unë kam pas me propozua edhe me hy në rend dite edhe çështja e Emblemës të Komunës së Prizrenit. Për të diskutua, që Emblemës të Komunës së Prizrenit ti kthehet viti 1878. Qysh po e shoh tash qenka shumë i ngarkuar ky rend dite! Për dy pikat,

ne, material nuk kemi për to. Në KPF i keni propozua, a neve s'na keni informua. Unë nuk po e shoh që na keni informua për këto dy pika. A kur më thatë që mi bind unë në mbledhjen e kaluar, deputetet e Kuvendit të Kosovës, në Parlamentin e Kosovës, që me ndërrua Kushtetutën e Kosovës, ajo nuk është detyrë e imja. Detyrë ime është me paraqit para Kuvendit një propozim, të cilin besoj që e përkrahin të gjithë, dhe votohet. Atëherë, është detyrë e Ministrisë a e pranon a jo. Kjo është detyra, e jo me bind askënd tjetër. Tjetër herë mos mu përgjigje në këtë farë mënyre! Edhe kërkoj që edhe kjo pikë mu fut në rend të ditës. Sot qenka i ngarkuar, po në mbledhjet tjera ta përgatitësh. Kemi me votua ne këtë. Besoj që tash i ke votat të gjitha. Nuk i pengon askujt viti 1878. Po shkojmë në atë, që lidhja është gjallë! Po lidhja nuk është gjallë përderisa nuk e ka vitin 1878.

**Kryesuesi:** Dikush tjetër rreth rendit të ditës? Nëse nuk ka, atëherë 35 anëtarë jemi prezent në sallë. E hedh në votim këtë propozim për rend dite, kush është për?

Për? – 31.

Kundër? – S'ka

Abstenim? – 4.

Atëherë konstatoj se me 31 vota për, asnjë kundër dhe 4 abstenim, miratohet rendi i ditës për këtë mbledhje. Para se të kaloj tek pika e tretë e rendit të ditës, për pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme, shfrytëzoj rastin që ti informoj të gjithë anëtarët e Kuvendit që angazhimi i jonë në asociacionin e komunave të Kosovës, që ka të bëjë lidhur me kërkesën e kamotshme të anëtarëve të Kuvendit për ngritjen e pagës së tyre. Siç duket ka filluar ti jap rezultatet pozitive. Tash në takimet e shpeshta që i kemi mbajt edhe në kuadër të asociacionit dhe, asociacioni me Qeverinë e Republikës së Kosovës, në projektligjin e ri është përfshirë kërkesa e gjithë anëtarëve të kuvendeve komunale në nivel të Kosovës, për rritjen e pagës. Kjo kërkesë nënkupton që të gjithë anëtarët e komunave të kompensohen me mëditje të njëjtë. Dhe që ky nivel i mëditjes të jetë sa 20% e pagës bazë të kryetarit të komunës. Pra, është fjala vetëm për kuvendet komunale të cilët i kanë 35 anëtarë. Në këtë rast përfshihet kuvendi i komunës së Prizrenit që i ka 41 anëtarë. Dhe se paga bazë dhe kompensimi për mbledhje do të thotë të jetë 125 €, plus këto tjerat. Shfrytëzoj rastin që ta informoj Kuvendin, dhe se tash kjo çështje është përfshirë në projektligjin për pagat. Nëse miratohet në Kuvendin e Kosovës, të gjithë anëtarët e kuvendeve komunale në nivel të Kosovës, po sigurisht edhe të komunës së Prizrenit, do të ketë rritje të pagës.

**Pika e tretë:**

**Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme.**

**Ganimete Babuna (Nisma Socialdemokrate):** Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të mbajtura deri më tash, është shkelur rregullorja e punës të këtij Kuvendit. Veçanërisht në pikën e tretë të rendit të ditës, pyetjet e kuvendarëve dhe çështjet e ngritura, duke mos e respektuar kohën e caktuar nga kuvendarët. Gjë kjo që e ka zbeh mjaft punën e Kuvendit. Andaj, ne si kuvendarë të Nismës Socialdemokrate, kërkojmë që t'ju përmbaheni kësaj rregulloreje. Përndryshe, nëse vazhdohet si në mbledhjet e kaluara, ne nuk jemi të interesuar të qëndrojmë në mbledhje. Pra, do ta lirojmë sallën gjatë kësaj pike të rendit të ditës. Kam edhe një kërkesë tjetër për kryetarin e komunës Mytaher Haskuka, i cili s'qenka këtu, po besoj se do ti përcjellët kjo kërkesë. I nderuar kryetar, duke e ditur se shumë veteran të luftës janë të pa punë si shumica e popullatës sonë në vend, por edhe në komunën tonë. Kishte qenë shumë mirë që edhe komuna e Prizrenit si disa komuna tjera, kategorinë e veteranëve të luftës, ta lirojnë nga shërbimet publike dhe ti mundësoj lehtësime në tatimin mbi pronë.

**Simir Krasniqi (PDK):** Do të ishte mirë që të ishte edhe kryetari i komunës këtu. Më lejoni që të shprehë indinjatën e shumë qytetarëve të komunës së Prizrenit, të cilët mendojnë se organizimi i festave të qershorit, nuk ishte mirë i organizuar, dhe jo profesional. Por ishte një dështim nga Drejtoria e Kulturës, nga organizatorët e komunës së Prizrenit. Aktivitetet kulturore dhe aktivitetet tjera nuk janë përcjellë masovikisht nga qytetarët, sepse informacioni nuk ka qenë si duhet dhe as përformancat nuk kanë qenë të përzgjedhura. Këtë e dëshmojnë edhe pjesëmarrja numerike e vogël e qytetarëve të rastit, në hapësirat ku janë mbajtur aktivitetet nga pesë dhe dhjetë qytetarë, apo vetë këshilli organizativ që kanë marrë pjesë. Komuna e Prizrenit, saktësisht Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me rastin e shënimit të 140 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, përmes përfituesit të tenderit për organizimin e aktiviteteve të ndryshme, ka qenë drejtpërdrejtë e involvuar në këtë organizim. Sepse ka pasur të formuar edhe këshillin organizativ, i cili është kujdesur për mbarëvajtjen e aktiviteteve. Përfituesi i tenderit ekonomik nga Prizreni, ka organizuar aktivitete kulturore dhe argëtuese, të cilat më thënë të vërtetën aspak nuk kanë ngjall kureshtjen e qytetarëve të Prizrenit. Dhe aspak nuk është ndie aroma e festave të qershorit. Mendoj se organizimi ka qenë joprofesional. Koncertet dhe aktivitetet kulturore të organizuara janë mbajtur për vetë këshillin organizativ, pa asnjë përcjellje nga njerëzit. Sepse qytetarët nuk kanë qenë pjesëmarrës, duke mos ditur asgjë. Të marrësh 30.000 €, nga taksapaguesit e Prizrenit për shënimin e 140 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe 12 Qershorit të Çlirimit të Prizrenit, dhe të ftosh shoqëri dhe grupe kulturore nga Berati, nga Obiliqi, të cilëve u është dashtë tu paguhet transporti akomodimi dhe ushqimi. Për derisa në komunën e Prizrenit veprojnë pesë apo gjashtë shoqëri kulturore shqiptare, që kanë dëshmuar vetën me shumë rezultate dhe kanë një publik të mrekullueshëm, si nga qyteti i Prizrenit, po ashtu nga

Zhuri dhe nga rajoni i Hasit. Pastaj kemi edhe shoqëri kulturore të komunitetit turk, boshnjak e të tjerë, të cilët nuk janë ftuar. Andaj, parashtroi pyetje, pse nuk janë ftuar shoqëritë e komunës së Prizrenit, të cilat gjithmonë në festat e qytetit, e kanë madhështuar atë festë. Kush ua ndalon atyre pjesëmarrjen në festën e qytetit, për këtë anashkalim. A duhet dikush të jap shpjegime dhe llogaridhënie. Athua më e leverdishme, paska qenë të ftohen grupet kulturore nga Shqipëria dhe qytete tjera të Kosovës, apo më lehtë paska qenë manipulimi me të huaj. Sepse ata shumë lehtë mund të mashtrohen dhe manipulohen, duke mos ditur fare se çka po ndodh në komunën e Prizrenit. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me doemos mos duhet ti përgjigjet qytetarëve të komunës së Prizrenit dhe të japin llogaridhënie, pse u është mohuar e drejta e shoqërive kulturore të komunës. Dhe adhuresve të shumtë të këtyre grupeve muzikore, të cilët vinë nga vise të ndryshme të komunës sonë, që janë pjesë e festës. Apo dikush ka menduar ti jap konotacion, kinse organizim me qytetarët, këtij aktiviteti. Duke mos ftuar shoqëritë dhe grupet nga fshatrat dhe rajoni. Ata janë ndier shumë të ofenduar nga ky anashkalim. Komuniteti artistik dhe kulturor, qofshin ata grupor apo individual, janë në pritje të një përgjigje nga Drejtoria e Kulturës. Nëse ne lejojmë si kuvendarë që të manipulohet kësaj vit, atëherë kjo traditë mund të vazhdojë edhe viteve tjera. Komuniteti artistik është shumë i indinjuar dhe shumë i frustuar në këtë përlule që i është bërë nga Drejtoria e Kulturës dhe Këshilli organizativ. Kujt i takojnë këto grupe folklorike apo muzikore dhe për çka ekzistojnë ato. Sigurisht që ato janë pjesë përbërëse e qytetit të Prizrenit. Ku të gjithë ne krenohemi se Prizreni është qytet kulturor, artistik dhe historik. E më këtë veprim vallë a mund ta quajmë më! Të nderuar të pranishëm, në këtë rast kërkoj që kësaj indinjate ti bashkohen edhe anëtarët tjerë asamblast, nga të gjitha partitë, si dhe nga komuniteti turk dhe boshnjak. Pyetje për kryetarin Haskuka. Do të ishte mirë që edhe ai të ishte prezent këtu. Pas përfundimit të konkursit për angazhimin e pesë nëpunësve në shërbime të veçanta si bashkëpunëtor profesional, për regjistrimin e tatimit në pronë në Drejtorinë për Ekonomi dhe Financa, të shpallur më 17.05.2018, personat e pranuar në punë përveç militantëve partiak, aktivistëve të VV-së, dhe partive tjera të koalicionit. Aty pranohet në punë edhe çika e axhës suaj kryetar, Nora Haskuka. Në njoftimin e shpallur nga Drejtoria Komonale e Arsimit, për përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave, përveç militantëve partiak të VV-së, dhe partive të koalicionit, aty e keni të pranuar në një shkollë edhe baxhanakun e kryetarit të LDK-së, pra, Haxhi Avdyllit në Prizren, parti në koalicion me ju. Në konkursin e shpallur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe pranimin në punë të punëtorëve shëndetësorë edhe këtu kemi shkelje ligjore në përzgjedhjen e kandidatëve. Drejtoresha e Shëndetësisë, përveç që ka qëndruar aty gjatë intervistës, kandidatëve apo militantëve të VV-së ju janë ofrua pyetjet para testit me shkrim. Që është një shkelje ligjore dhe shkelje e të drejtave të njeriut. Disa ditë më herët pranohen në punë në Qendrën e thirrjeve dhe disa pozita tjera në Kuvendin komunal, të gjithë militant, aktivist dhe anëtarë të VV-së. Nga

reagimi i zëdhënësit të PDK-së në Prizren, ku të gjithë të punësuarit dëshmohen me fakte dhe fotografi si aktivist të LVV-së, përgjigja e kryetarit para gazetarëve ishte, se të gjithë këta të punësuar në këtë konkurs në komunë paskan punuar në mënyrë vullnetare dhe këta duhet pranuar. Shtrohet pyetja, ku u angazhuan të gjithë militant e partisë së VV-së, që të kryhen punët vullnetare në komunë. Dhe në fund po ashtu për kryetarin e komunës. Keni ardhur në pushtet, që ti rehatoni dhe ti punësoni të afërmit e juaj dhe të partive në koalicion. Apo ta rritni nepotizmin, të punësoni militant, aktivist të VV-së dhe partive tjera në koalicion. Apo t'ju përmbaheni premtimeve elektorale, ku nga ju është thënë, nuk do të ketë punësime në baza partiake, nepotizëm e tjerë. Po kjo paska qenë një mashtrim dhe një gënjeshtër para qytetarëve nga kryetari i komunës Haskuka.

**Shkodran Kryeziu (PDK):** Unë i kam tri kërkesa nga banorët e Prizrenit. Kërkesa e parë është nga banorët e rrugës Mehmet Hasi, ku aty rruga është dëmtuar shumë dhe është e pakalueshme për momentin. Andaj, kërkojnë që të mënjanohej aty dëmet. Pastaj në rrugën Salajdin Berisha, banorët kanë bërë kërkesë edhe në Kuvendin komunal. Se kanë problem me kanalizim, afër zyrës së vendit. Andaj të riparohet rruga. Po ashtu edhe banorët e fshatit Leskovec, kanë kërkuar që të bëhet sanimi i rrëshqitjeve të dheut, sepse është duke e dëmtuar rrugën.

**Vjollca Kabashi (AAK):** Unë desha ti shtroj një pyetje drejtoreshës, njëherit një falënderim për kthimin e shëndetësisë ... Mirëpo unë nuk kam kërkuar që të blihet karrige komplet në stomatologji. Por vetëm të bëhen investimet e pjesëve të tyre, që nuk ka mjetet të imta për gërryerje. Se karrige nuk kam kërkuar se e dimë buxheti sa është 10.000 € për shëndetësi. Edhe ai buxhet nuk arrin të blihet komplet një karrige.

**Alush Shala:** Unë do të vazhdoj ti kërkoj, apo ti përsërisë pyetjet e mëparshme, bile disa edhe të mandatit të kaluar. Kur është në pyetje pastrimi pranë ish-Benafit, ku është bërë një varrezë makinash, varrezë mbeturinash. Gjithçka keq, veç mirë jo! Në veçanti po na lënë përshtypje që kanë qit reklama nga dy-tri vetura për bartjen e kufomave. Këto ditë makinat janë në të gjitha hyrje-dalje të qytetit të Prizrenit. Problem tjetër është dezinfektimi, ku në veçanti po e përmendi në lagjen Dardania. Kam argumente që po sëmuren fëmijët, apo për mos më thënë sikur se u bie Lija e ujit, apo si i thonë asaj sëmundjeje. Andaj, kisha kërkuar në mënyrë urgjente të ndërhyhet. Gjithashtu kërkoi të di deri ku ka shkua procesi për ndërtimin e shkollës së muzikës, të vendi ish-Benafit. Besoj se Drejtori për Arsim do të na jep një përgjigje. Problemi i ujit të pijshëm në lagjen, "11 Marsi" dhe "2 Korriku", është i pashmangshëm sepse nuk ka ndonjë përmirësim. Në veçanti po ju them "2 Korriku", ku prej orës 8 deri në orën 15 ka ndërprerje, çdo ditë. Desha ta pyes

edhe kryetarin, më qenë se s'është këtu, për disa punonjës në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, në Drejtorinë e Inspektoratit dhe të Drejtoria e Administratës. Nuk po i përmendi me emra për shkak të etikës. A kanë vendime, apo e kanë vendimin mbi vepër. Por realisht rolin e luajnë të drejtorit, apo më shumë se të drejtorit. Nënshkrimin e bëjnë drejtorët përkatës, ata marrin vendime. Nuk po dua me i përmend me emra, sepse unë e kam një letër që unë e kam marrë personalisht, nga njëra nga këto drejtori. Andaj kisha dashtë, ndoshta është mirë, jo vetëm për mua po për të gjithë kuvendarët, ta dinë strukturën udhëheqëse të komunës sonë në Prizren.

**Antigona Bytyqi (PDK):** Në mbledhjen e katërt të Kuvendit të komunës, të mbajtur amë 15 mars të këtij viti, kam ngritur një çështje mjaft shqetësuese për banorët e një lagje në Hoçë e Qytetit, çështje e cila i takon Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Mirëpo, unë nga ajo datë nuk kam ndonjë përgjigje nga ajo drejtori. E di që ka kohë që edhe nga këshilli i fshatit kërkesa është dërguar në këtë Drejtori, por ende as ata nuk kanë ndonjë përgjigje. Kështu që unë detyrohem edhe njëherë ta paraqes në këtë Kuvend, sepse nuk është rast që duhet lënë pas dore. Kam kërkuar që të vini ta vizitoni këtë lagje dhe të ndërmerri masa për rrënimin e murit ekzistues dhe ndërtimin e një muri të ri. Sepse muri ekzistues nga vjetërsia po paraqet rrezik permanent për banorët e kësaj lagjeje, e sidomos për fëmijët. Sepse kjo rrugë është shumë e frekuentuar nga ata. Duke e ditur që edhe fëmijët tanë kanë të drejtë të luajnë nëpër vende të sigurta, të ecin nëpër rrugë të sigurta. Ne edhe njëherë po ju ftojme që të vini sa më shpejt të na evitoni atë rrezikshmëri dhe jo të na vini në vizitë atëherë kur të jetë tepër vonë.

**Behar Begaj (LDK):** Unë kam një shqetësim lidhur me përzgjedhjet e këshillave lokal, apo bashkësive lokale, të cilët janë zgjedhur më datë 25 nëntor 2015. Kam një pyetje për drejtorin e Administratës, ju përket edhe juve kryesues i nderuar. Ne jemi zgjedhur para tri viteve në këtë detyrë të caktuar nga Kuvendi i mëparshëm. Dhe aty thuhet se kompetencat të cilat ne i gëzojmë, janë thuajse të pakëta dhe pa asnjë mbështetje nga ana komunale. Ne nuk gëzojmë asnjë të drejtë. Aty është thënë se duhet të gjithë këshillat lokal të kenë zyre. Gjë të cilën jam shumë i sigurt se shumica nuk e kanë. Unë personalisht e kam, se Zhuri ka pas gjithnjë. Kam bërë kërkesë edhe në pushtetin e kaluar për pajisje të zyrës të cilën e posedoj, nuk kam has në mirëkuptim. Të njëjtën gjë e kam bërë edhe tash në Drejtorinë përkatëse z. Osmani dhe ende nuk kam marrë ndonjë përgjigje, se a do ti gëzojmë ato të drejta apo nuk do ti gëzojmë. Unë kisha kërkuar nga ju që të merrni me seriozitet këtë çështje dhe të dalim me një vendim, se a duhet të ekzistojnë këto këshilla apo nuk duhet të ekzistojnë. Në rast se po atëherë duhet ti mbështesim, si nga ana financiare, ashtu edhe nga ana materiale. Ndërsa kam një përgjigje për kuvendarin Krasniqi, i cili pak më herët tha se organizimet e muajit qershor nuk kanë qenë si duhet. U përmend edhe

ansambli i Zhurit. Unë po ia përkujtoj kuvendarit se ansambli i Zhurit ka qenë i anashkaluar edhe nga pushteti i juaj, kur ju keni qeverisë. Ansambli i Zhurit nuk ka qenë i ftuar asnjëherë dhe nuk ka marrë pjesë asnjëherë. Ju e dini shumë mirë se nga kush janë bërë këto organizime, joadekuat, joprofesional. Dhe sot këtu para nesh doni të hidheni pluhur syve.

**Petrit Hoxhaj (LDK):** Nga kjo foltore dua të ngrejë shqetësimin e mbi 30 bizneseve dhe shumë qytetarëve tjerë, për çështjen e lokaleve tek tregu i gjelbër në Ortakoll. Aty dita ditës po shtohen lokalet e klubeve të natës. Ku tash janë të hapur edhe ditën. Bizneset janë në hallë prej këtyre lokaleve, të cilët po punojnë femra nga shtetet rajonale si: Shqipëria, Bullgaria apo edhe Moldavia pa leje qëndrim, në mënyrë ilegale. I nderuar kryesues, këtu nuk punohet asgjë tjetër përpos që ushtrohet veprimtaria e prostitucionit ilegal, ditën dhe natën. Sipas qytetarëve që kalojnë në atë pjesë, këto janë shumë shqetësuese dhe ngacmuese për ta. Shumë biznese po mbyllën nga aty. Pasi që vetëm është duke u shtuar numri i prostitucionit në atë pjesë. Kërkoj nga organet përgjegjëse, që të merren sa më shpejt me këtë çështje, sepse bizneset në Prizren po mbyllën në atë pjesë nga neglizhenca e komunës që i është bërë. Përkundër asaj që shpesh herë kanë edhe petition këto biznese. Ndërsa pyetja tjetër ka të bëjë dhe kisha dashtë që të më jepet me shkrim përgjigja për çështjen e çerdhes publike “Çerdhja”. Kush e menaxhon këtë çerdhe? Sa është vlera totale që i merr komuna nga shfrytëzuesi i kësaj çerdhe? Dhe pse komuna bënë ndërtimin e një çerdhe tjetër, kur veç e ka çerdhen dhe nuk e menaxhon vetë.

**Cenet Sajadi (KDTP): Cennet Sayhadi:** Meclis Başkanım, Meclis Başkan yardımcım, müdürlerim, meclis üyelerim, medya mensupları ve siz değerli katılımcılar hepimizi saygıyla selamlıyorum. Ebedi ve ezeli dostumuz Türkiye Cumhuriyetinde 24 Haziran Pazar günü gerçekleşen Cumhurbaşkanlığı ve Milletvekilliği genel seçimlerinde oyların salt çoğunluğunu alarak Türkiye Cumhuriyetinin 13.Cumhurbaşkanı seçilen, Balkanların en büyük dostu sayın Recep Tayyip Erdoğanı ve milletvekilliği genel seçimlerinde büyük başarı gösteren Cumhur itifakını Türk temsilcisi olarak tebrik ediyorum. Türkiye ve Türk dünyasına hayırlı olmasını Yüce Allah'tan temenni ediyorum. Saygılar.

**Cennet Sayhadi:** I nderuari kryesues, zëvendëskryesues, drejtor, anëtarë të kuvendit, përfaqësues të medjave dhe ju të nderuar pjesmarrës, ju përshtëndes të gjithëve. Si një pjesëtare e komunitetit turk dëshirojë të urojë fitoren e mikut të përhershëm dhe të kah motshëm të Republikës së Turqisë që në zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare të mbajtura ditën e diel më 24 qershor nga e cila rezultojë që më shumicë absolute të zgjedhet si Kryetar i 13 i Republikës së Turqisë z. Recep Tayyip Erdoğanı poashtu edhe për rezultate të larta të aleancës

republikane. Lus nga zoti i gjithëfuqishëm që kjo të jetë e dobishme për Turqin dhe botën turke. Me nderime.

**Haziz Hodaj (LDK):** Unë po shoh që shumica e pyetjeve i drejtohen Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ku fatkeqësisht drejtori i Shërbimeve Publike nuk është këtu. Edhe unë kam pyetje që i drejtohen Drejtorisë të Shërbimeve Publike. Po në mungesë të drejtorit, është mirë që drejtori ta delegoj një përfaqësues të zyrës së vetë, zëvendës apo çka do qoftë, të marr shënime dhe të merret seriozisht me kërkesat tona. Sepse nuk jemi këtu veç për të bërë kërkesa edhe për me dal në televizor, të bëjmë një kërkesë dhe hajt. Unë po e shoh fatkeqësisht në propozimin në kornizën afatmesme buxhetore, nuk është përfshirë asnjë pozicion buxhetor për fshatin Gjonaj. Po ju bëj me dije juve gjithë opinionit dhe drejtorit të Shërbimeve Publike, inshallah na dëgjon në televizorë, apo e merr procesverbalin. Fshati Gjonaj është fshati më i madh në Has. Fshati Gjonaj është pa rrugë! Fshati Gjonaj është sot pa ujë! Fshati Gjonaj është sot pa shkollë! Andaj po ju pyes, pse nuk janë të përfshira në pozicionin buxhetor. Kërkoj urgjentisht, që të përfshihen të tria këto pozicione. Shkolla ishte e përfshirë në Gjonaj, ishte në pozicion buxhetor. Që e kemi biseduar edhe me drejtorin mënyra se si do të implementohen përmes Ministrisë, kjo le të mbetet. Mirëpo çështja e infrastrukturës edhe njëherë po ju them. Sinqerisht po ju them i kam ndal qytetarët javën e kaluar mos me ardhur te kryetari. Sepse u thash do të informohem vetë personalisht, pastaj ju informoj. Mungesa e ujit me ditë të tëra. Rrugët janë katastrofale. Ju ftoj juve si kryesues i Kuvendit, po ju lus, boni një delegacion prej anëtarëve të Kuvendit, prej të gjitha partive dhe hajde ta vizitohet, se në çfarë gjendje është Gjonaj. Përndryshe po ju lajmëroj ende pa ardhur kjo pikë e rendit të ditës, që unë nuk do ta votoj këtë kornizë afatmesme buxhetore, sepse nuk dua ta vras vetveten me dorën time.

**Ilir Gashi (LVV):** Dua të përcjellë një kërkesë të banorëve të lagjes Dardania apo Jaglenica rruga Muhamet Çami. Banorët e kësaj lagje kanë ankesë se nuk mund të kyçen në rrugën kryesore. Sepse gjatë viteve të kaluara punimet janë ndalur, pasi që një person nuk ka lejuar të vazhdojnë për rreth 100 metër të bashkohen me rrugën kryesore. Dhe tani fal mirëkuptimi të një banori të lagjes, banorët tjetër kalojnë nëpërmjet truallit të tij privat që nuk ka kushte elementare për të lëvizur me veturë apo edhe në këmbë. Dhe pas çdo reshje atmosferike ka dëmtime serioze në rrugë. Prandaj kërkoj që drejtoria përkatëse të merr parasysh këtë kërkesë të banorëve kësaj lagje. Përndryshe lagja është e urbanizuar dhe kanë nevojë që të kenë ndërhyrje sa më shpejt.

**Xhavit Uka (LDK):** Pyetja ime është për drejtorin e DKA-së, z. Susuri. Z. Drejtor prej marrjes së detyrës suaj, a jeni të njoftuar me ngecjen e punëve në shkollën “Dy Dëshmorët” në fshatin Piranë. Shkollë e cila është ndërtuar një

skelet prej dy katëshe. Ku punimet kanë filluar para katër-pesë vite. Mirëpo, para dy viteve kanë ngecur dhe nuk është duke punuar aty askush. Desha ta di deri ku jeni të njoftuar dhe çka më tutje.

**Memnuna Ajdini (Vakat):** Pitanje se takode odnosi za Direktorijat za Javne Usluge. Radi se dakle na pitanje koju sam postavila i na prošloj sednici. Deonica puta to jest ulaz iz pravca Župe, još uvek nije zavčršen. Još uvek se vrše radovi koji se jako sporo odrađuju. Te se ovim putem zahtevam da se ovi radovi ubrzaju. Jer je ugrožen saobračaj upravo na ovoj deonici. A takode i čitava deonica Prizren – Kerk bunar, ja jako u lošem stanju. I ima jako negativne posledice za soabračaj. Takode ja bi predložila, ali takoda imače svakako vremena da ovo ponovim. Da se za narednu godinu u budžetskoj godini, planira proširenje ulaza iz pravca Župe. Jer je ovaj ulaz verovatno najlošiji ulaz u gradu Prizren. Takode još jedan zahtev koji dolazi od meštana Župe, to jest okolnih sela. Takode je vezano sa puteve, traži se horizontalna i vertikalna signalizacije. Takode iz bezbednosnih razloga.

**Kujtesa Kabashi Shatri (LDK):** Në kornizën afatmesme buxhetore komunale, nuk ishte përfshirë asnjë projekt për fshatin Kushnin. Gjatë vitit 2012-2013 në Kushnin, janë shtruar me kupëza katër rrugë të fshatit. Mirëpo banorët kanë kërkesë që rrugët e mbetura të pashtuara, që janë në gjendje të mjerueshme, në gjatësi përafërsisht shtatë kilometra, të rregullohen. Andaj, kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike të merr parasysh kërkesën e banorëve që e përfshinë edhe lagjen e Meseleve, pasi që janë banorë të këtij fshati. Kushnini si vendbanim më i largët i komunës së Prizren, kërkon një vëmendje nga institucionet komunale, që banorët e fshatit të kenë kushte më të mira për jetë.

**Azem Durmiši (NDS):** Analizirajući dosadašnji rad mi Nova Demokratska Stranka, koalicioni partner u Skupštini opštini Prizren sa vladajućom koalicijom na čijem čelu je partia Vetvendosje Samoopredeljenje. Imamo nekoliko primedbe u vezi sa počev od koalicionog sporazuma potpisan od naše strane sa predsednikom SO Prizren g. Haskukom i niz drugih problema kojih neprekidno insosimo na svakoj sednici Skupštine. Reč transparentnost za mene a i za svih nas, traba značiti kako je fakat. Ali za našu zajednicu onda samo se spominje. Ta transparentnost na bosanskom jeziku je nema. Ta transparantnost se ne poštoje. Kao što ne poštuje se u potpunosti naše ustavno pravo, i provo po ustavu i po zakonu za lokalno samoupravu. Ovim govorim argumentavano. Zato što u proteklom periodu ugrožena su naša prava, pre svega ljudska prava u pogledu jezika i zapošljavanja koja nam pripadaju zakonom. Pa ču da nabrojim: U Direktorijatu za Finansije od pet primljenih radnika tri su iz albanske a dva iz turske zajednice. Nemamo ništa protiv ali nas nema. U Direktorijatu za Kulturu da dva radnika iz albanske zajednice. Opet nemamo

protiv, i mi imamp pravo da budemo zapošljavani. U direktorijatu za Zdravstvo, tu mogu da se pohvalim. Ali primljen je kandidat iz bošnjačke zajednice, koji ovde među nama. I ako je u poziciji potrebno je da on diže ruku. Ne po zaslugi ali očigledno zbog vlasti. I čini mi se da poštoje lični interes je na površini, a narod koji nas je birao može a i mora da čeka. Vjerujem g. Adis Aljilji da čekam da vam se zahvali. Tako da mi bošnjaci i naša bošnjačka zajednica da je druga po broju u oštini Prizren. I kao pošten narod ovo gospodo ne zaslužuje. Sledeća moja primedba i naše stranke je u vezi konkursa za stipendiranje. Od 80 studenata samo četiri bošnjaka i to pod znacima navoda staviču, dobili su stipendiju. Devet studenata iz turske zajednice. Gde je ovde proporcija gospodo. Ako smo mi preko 10% zastupljeni po broju stanovnika u gradu Prizren. A konkurs je čak bio objavljen na albanskom jeziku. I tu se potvrđuje što je i ovde ovim dokumentom sada na samoj sednici što smo dobili da je samo na albanskom jeziku. Ja nemam ništa protiv jezika. Ali ono što me sleduje hoću da dobijem. I ne samo da dobijem odgovore da je to bilo ubrzano i da nije imalo vremena za prevod. Sva dokumentacija koja dobije kao radnik u obrazovanju. Znam i lično i arguemntovano tvrdim da nijedan dokumenat u školi ne dobijamo u bosanskom jeziku, konkretno u Manistirici gde sam zaposljen. Prihvatili smo koalicioni sporazum, jer smo za promjenu. Ali u pozitivnom a ne da se vraćamo. Dokaz je konkrsa direktora škole, gde je u komisiji za izbor direktora opet našeg predstavnika neme. A još veći absurd da bošnjački kandidati na intervju su dobijali pitanja na albanskom jeziku. I članovi komisije koji nisu znali nijednu reč na bosanskom jeziku. Dobijali su odgovore na bosanskom jeziku. Pa ja ne znam kakav je to način izbora direktora. Ja ovim kao radnik više od 25 godina u obrazovanju, ne mogu da prečitim niti ovde nite bilo gde. Jer ovaj čin je totalno nezakonit. A promjene i reforme nema. Izabrani su isti direktori koji su već više od deset godia na funkcijama.

**Kryeseusi:** I nderuar, ju lutëm që të përmbyllni, sepse veç keni kalua kohën e përcaktuar.

**Durmiši:** Te zahtjevam od gradonačelnika, pošto nije ovde prisutan. Da ovaj čin poništi i ponovo objavi konkurs za direktore i konkurs za stipendiranje. Svi znamo da obrazovanje glavni faktor i stub države. Upućujem ponovo zahtjeve koje sam više puta ovde upućivao sa ovog mesta. Zahtev direktoru Javne Službe da dovrši prvo započeti projekat obeležavanja i sinjalizacija ulica u svim selima Župe. A što skorije vreme u svim delovima opštine Prizren, gde treba. Jer znamo svih kao vozači da je to prekopotrebno. A pogotovo u periodu koji dolazimo. Još jednom ću zamoliti gradonačelnika za njegovu uticaj i autoritet. Da utiče u kompaniji KED-sa u vezi projekta, gde sam prošle seance naglasio. Da su meštani sela Manistirica učesnici preko 75% projekta. Koji se čeka već tri godina da se realizuje i gdeje naknadno oštećena električna mreža, i to na dan našeg najvećeg praznika Bajrama. U vremenu kada svih znata kada

naša deca idu od kuće do kuće. Odrušila su se još četiri električna stuba. Zahvaljujući što taj projekat i dalje sedi negde u fijoci. A zaislite opet ču da ponovim. Meštani su učesnici svojim finansiskim učešćem od 75%. Gde zahtevam da u što skorije vreme da ne bi nastali još kvarovi, da se reši taj slučaj.

**Kryesuesi:** I nderuar i ke kalua të gjitha afatet kohore, të lutëm përmbyle.

**Drumişi:** Ako se ovako nastavi sa kršenjem ustavnih i zakonskih normih NDS će biti prinuđena da napusti i poništi koalicioni sporazum. Kao i da se obrati međunarodnim institucijama za pomoć.

**Ilir Baldedaj (AAK):** Paralajmërimi im i mëhershëm në Drejtorinë e Kulturës dhe paralajmërimi për kryetarin e Komunës. Sepse drejtori aktual është kah e qon në humnerë klubin “Liria”, po e dëshmon çdo ditë e më shumë. Së pari ja ka filluar me Skender Hasin, tani me Ilijaz Ilijazin. Dhe po pretendon të hy edhe në klubin e basketbollit “Bashkimi”. Nuk është mirë sepse e ka një vendim nga asambleja e kaluar. Ju ftoj të gjitha partive politike, ti thirremi mendjes sepse ka pas donator serioz që kanë ardhur nga Gjermania për tu marrë me “Lirin”. Dhe ky zotëri që ka ardhur në mes të natës anëtar i bordit duhet të shkarkohet nga kjo asamble. Të krijohet një raport detal sepse ky Kuvend ka marrë vendim për mbështetjen financiare të klubit “Liria”. Dhe natyrisht që ne duhet të merremi me të, sepse është aset i qytetarëve. I njëjti drejtor ndoshta ka luajt për Metohinë një kohë të gjatë dhe tani po mendon që “Liria” është Metohi. Po Metohia ka përfunduar në vitin 1999 dhe më nuk është në Kosovë dhe as në Prizren. E kam paralajmërua edhe në seancat e tjera, ka vazhdua njëjtë dhe po vazhdon njëjtë. Pyetje për Drejtoreshën e Shëndetësisë. Njëra nga kandidatët e punësuar në Urgjencë një javë më herët e ka lënë punën në ABI Center, dhe ka thënë se unë jam punësuar në Urgjencë. Unë e kam edhe emrin edhe mbiemrin të gjitha por nuk do ti jap. Ftoj organet e drejtësisë të merren me këtë çështje. Kisha kërkuar të njëjtën gjë, të hiqet pika e rendit të ditës për drejtorët e shkollave sepse është anuluar konkursi. Veç sa e pash në ueb faqe se konkursi është anuluar. Dhe është mirë, ne, të mos merremi me këtë çështje dhe ajo çështje, të shkoj në prokurori dhe le të merren organet e drejtësisë. Pse tani u anulua, për derisa drejtori Skender e ka mbështetur komisionin, ndërsa tash del që kryetari i komunës e ka anulua. Pyetje për kryetarin e komunës. Si u arrit marrëveshje me Infrakosin të cilët për gjashtë muaj ditë e bllokuat qytetin dhe nuk dhatë asnjë leje? A është ndërmarrë ndonjë masë nga Drejtoria e Urbanizmit, apo e Inspektoratit? A është liruar ndonjë hapësirë, sepse kontest ka qenë hapësira e tokës së Hekurudhës? A është ndërmarrë ndonjë gjë dhe cili është pazari i kësaj marrëveshjeje? Sepse informacionet të cilat vinë, flitet që përball ish-Benafit do të ndërtohet një restorant dhe një pompë e benzinës.

**Dafina Alishani (LVV):** Duke marrë parasysh që kemi hyrë në sezonin veror, më siguri do të kemi edhe shumë vizitorë në qytetin e Prizrenit. Fatkeqësisht kemi disa informata dhe ankesa nga qytetarët dhe nga disa përgjegjës të hoteleve dhe hosteleve të ndryshme në qytet, që ka ngacmime seksuale, plaçkitje dhe dhunë përgjatë rrugës së Marashit dhe në rrugën e Kalasë. Duke marrë parasysh dhe duke qenë në dijeni të plotë, që siguria është përgjegjësi e policisë. Unë dëshiroj të apeloj tek përgjegjësit dhe drejtoritë përkatëse të cilët mund të bëjnë diçka në këtë dukuri kaq fatkeqe. Pasi që ne si qytet i Prizrenit, shquhemi për një mikpritje dhe harmoni multi- etnike dhe multi-fetare. Andaj, kërkoj nga Drejtoria e Turizmit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, së paku të bëjnë disa shërbime, si ndriçimi apo diçka tjetër që mund ta eliminoj këtë fatkeqësi shumë të keqe, që do të ndikoj shumë keq edhe tek vizitorët, por edhe tek imazhi i brezit tonë.

**Adem Shabanaj (LVV):** Kam dy kërkesa, një për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe tjetra për Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Duke e falënderuar Drejtorinë e Shërbimeve Publike, e cila ka marrë iniciativë për rregullimin dhe mënjanimin e gropave në lagjen Tusus, përkatësisht përreth spitalit. Kërkojmë që edhe rruga prej, të rrethi kryesor tek spitalit, të Spahia Petroll deri të barnatorja në hyrje të Tususit të rregullohet tërësisht ose pjesërisht. Dhe të shikohet mundësia të bëjmë zgjerimin e asaj rruge. Ngase trotuaret e asaj rruge janë shumë të mëdhenj dhe muri përgjatë spitalit është në rrënim e sipër. Dëshiroj që të merret masa për këtë. Tjetra pyetje është për Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Banesat sociale që janë ndërtuar në transit, nuk e di se kush ka qenë projektues i atyre banesave dhe çka ka menduar me ato banesa. Kur kemi të bëjmë për dy çështje shumë, shumë të ndjeshme për rastet sociale dhe familje të dëshmorëve të cilët janë përfitues të atyre banesave. Nuk e di se si mund një prind i dëshmorit të ngjitet në katin e shtatë pa lift. Dhe si mund një familje me rast sociale, të ngrohet pa nxehtë qendrore. Unë kërkoj nga drejtori, që ti sjell këtu paramasat. Të shikojmë që a ka qenë në projekt ndërtimi i liftit dhe i nxehtës qendrore. Kërkoj që të merren masa ndaj kompanive të cilat kanë bërë ndërtimin e atyre banesave

**Fatmir Kastrati (AAK):** Një pyetje ia kisha bërë drejtorit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, mirëpo ai nuk qenka këtu. Le të interesohet pak, pse i pamundësohet pingpongistëve të Prizrenit të bëjnë ushtrime në Qendër sportive, kur kanë rezultate kulminante në nivel vendi. Pyetja e dytë që është vazhdimisht prezentë dhe kam thënë që derisa nuk zgjidhet do ta parashtrori pyetjen lidhur me çështjen e ujit të pijes në lagjen “2 Korriku” dhe “11 Marsi”. E përmendi edhe z. Alush Shala më herët. Aq më keq në kornizën afatmesme buxhetore ishin heq edhe ato mjete financiare të cilat kanë qenë të parapara. Vazhdimisht bëj pyetje, mirëpo përgjigje nuk kam marrë asnjëherë. Apo ndoshta ka mbetur

që në këtë vit do të rregullohet uji i pijes. Unë nuk e di edhe drejtori i Shërbimeve Publike nuk qenka këtu dhe mbetet pikëpyetje edhe më tutje.

**Shukri Quni:** Unë e kam një kërkesë, që i është bërë nga Ministria për Kulturë dhe Sport kryetarit të komunës. Kërkesë për të përgatitë një dokumentacion lidhur me kompleksin sportiv në Nashec. Më sa jam i informuar Drejtoria për Kulturë dhe Sport, i ka ndarë 100.000 €. Kjo i është drejtuar kryetarit të komunës, kryetari e ka dërguar në Drejtori për Kulturë dhe Sport këtu në Prizren. Edhe është kërkuar vendimi i asamblesë. Do më thënë janë kërkuar dokumentet që duhet mi plotësua Kuvendi komunal edhe me ia dorëzua Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Kërkesa është bërë nga Veton Firzi sekretar i përgjithshëm i Ministrisë. Do më thënë dokumenti është këtu. Unë tash çka po kërkoj, dokumentet të cilat janë kërkuar. Vendimi i Asamblesë i cili është aprovua në kuvendin e komunës, për ndarjen e asaj parcele, ja ku është. Kopja e planit edhe kjo do të thotë këtu është. Pastaj shpimi, kjo nuk është se nuk është ndërtim i lart, s'ka kush e di çka me bo aty shpim. Projektin kryesor që ka pas me bo drejtoria nuk e ka bërë. Edhe para masat për para llogari si ka bo. Pyetja është, sepse këta janë arsyetua se gjëja nuk ka vend në Nashec. Në Nashec ka vend, nuk di me kënd kanë dal këta e kanë kërkuar atë vend. Edhe ku është ai vend. Do të thotë që këta janë bazua në atë që s'mundet mu ndërtua kjo. Tash nuk e di arsyetimin. Për atë thash po drejtori nuk qenka këtu, po edhe kryetari jo. Këto që i ka kërkuar Ministria për Rini, Kulturë dhe Sport në dokument janë të gjitha. Me kënd kanë dal dhe e kanë këqyrë terrenin, unë kam me hulumtua edhe me këqyr, kush janë ata! Unë më duket e kam një këmbonë që thonë me rreth në Nashec. Jo që ngajë kush e di sa për ato, por në rast se ka dhënë dikush përgjigje se nuk ekziston. Unë me dokumentacione jo vetëm drejtorinë po edhe Ministrinë e mbuloj me të gjitha dokumentacionet. Edhe është mirë që ky projekt mos me na ik. Sepse unë i kam bërë kërkesë Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, ish-drejtori i mëhershëm që kurrë nuk i ka aprovua. Se unë kam qenë për të opozitë gjithë. Edhe për të gjithë drejtorët kam qenë në opozitë. Jo veç tash po edhe për ata po. Edhe për tonit po. Asnjë projekt nuk e kemi qua nëpër vende tona pa i prish marrëdhëniet me drejtorët. Për këtë po ua jap një vërejtje kuvendarëve që janë këtu. Mos të mendojnë që kanë ekzekutivin e vet edhe projektet i qojnë lehtë atje. Unë jam habit pse ky projekt mu kthye mbrapa. Kërkoj edhe ndihmën tënde që ky projekt mu zbatua. Jo për hatër timin a tendin, po ai është, që tri fshatrat e shfrytëzojnë atë kompleks sportiv. Kam qenë edhe te drejtoresha për Turizëm. Është bërë një plan për Nashec, nuk kemi mund me gjet. Një plan ideor po, më shkurt, është neglizhua kjo. Kjo kërkesë është për kryetarin edhe për drejtorin që s'janë këtu. Për drejtorin e Arsimit desha me pyet, deri ku ka arrit busti i Komandant – Heroit Xhevat Berisha. Këtë pyetje e kemi bërë shumë herë edhe vetë keni qenë këtu si kuvendarë. Kurrë një përgjigje pozitive se kemi marrë, edhe nga ish drejtori Zehadin Shemsidini. Edhe për Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Kanë vazhdua

disa vija mi bo rrugës, po mendoj shenjëzimin e rrugës me vija të bardha. Kanë shkua diku nga 350 metra prej Perllonkës, në shtëpitë e fundit është ndal, athua pse? Unë për herë të parë kam pa që një projekt që është fillua prej qytetit edhe mu ndal, në dalje të qytetit. Edhe drejtori s'qenka këtu. Është mirë që ai projekt mu vazhdua, në rast se e ka fitua tenderin. Ose në rast se ju ka harxhua ngjyra, është mirë m'ja sigurua ngjyrën. Apo tenderi është deri aty. Mos na ndani prej qytetit, po vijat le të vazhdojnë, e të shkojnë deri në pikat më të fundit nëpër fshat.

**Kryesuesi:** Tani fjalën ia japim drejtorëve të cilët donë me marrë fjalën.

**Skender Susuri, drejtor i Drejtorisë së Arsimit:** Sa i përket pyetjes së Shukri Qunit në lidhje me Bustin e Xhevat Berishës, është e përfunduar dhe vendoset kësaj vere. E dyta, kërkoj falje shumë prej kuvendarit Alush Shala, sepse është hera e parë që nuk ju kam përgjigj një kuvendari me shkrim. Por nuk kam pas kohë beso në këtë rrëmujë që e kam pas këto ditë. Pikërisht sot më 28 qershor hapet oferta edhe për shkollën e muzikës dhe për çerdhen, do më thënë është procesi. Sa i përket pyetjes së Xhavitit për shkollën “Dy Dëshmorët”, është shqetësim edhe i joni. Nga 12 vend punime që janë duke u punua, në tri ka telashe. Njëra prej telasheve është Velezha, Zhuri dhe Pirana. Sipas informatave që unë i marr nga zyrtarët e buxhetit, paratë janë. Mirëpo, firma operatori ekonomik, po më vjen keq më thënë, po nuk është i përgjegjshëm. Po ja që ka probleme. Dhe ai e ka marrë një vërejtje me shkrim. Ti je vet njëri i biznesit. Zyrtarët tonë po ja përgatitin vërejtjen e dytë. Do të thotë paratë janë, po është neglizhencë e operatorit ekonomik, pse nuk i vazhdon punimet. Sa i përket pyetjes së kuvendarit në gjuhen boshnjake. Aty nuk qëndrojnë të gjitha çfarë ia ka thënë dhe dua ta arsyetoi. E para, nuk janë ndarë 9 bursa për komunitetin turk, mirëpo janë ndarë vetëm 5 bursa për komunitetin turk. Po ashtu kanë qenë pesë bursa për komunitetin boshnjak. Në mesin e pesëve një është përvjel që s'ka qenë boshnjak e kemi përmirësua. Dhe ne për me përmirësua këtë lëshim ta quaj kuptimisht. Kemi kërkuar edhe një konkluzion të ri prej kryetarit mi shtua edhe dy bursa për komunitetin boshnjak. Do më thënë janë shtatë bursa që i ka aprovua kryetari. Mirëpo, mos të pretendojmë me marrë bursa me nota 6 ose 6.5. Duhet me plotësua koeficientin 8, pa marrë parasysht, a është boshnjak, a është shqiptar a çka është. Do më thënë minimumi është 8. Dhe të gjithë që i kanë plotësua 8 të jesh i sigurt se kanë mi marrë. Nga komuniteti boshnjak janë shtatë. Nga komuniteti turk janë pesë. Sa i përket konkursit për drejtorët, unë e kam bërë një informatë. Pavarësisht se çka shkruajnë portalet. Unë kërkoj nga kryesuesi mos me tërheq nga rendi i ditës. Sepse jam mundua me respektua atë çfarë keni kërkuar në KPF. Dhe jam këtu për me mbështet plotësisht punën e komisionit, i cili ka punuar në baza ligjore. Vetëm një shkelje nëse ekziston aty, jam unë këtu për mu përgjigj, vetëm një shkelje në procedurë. Edhe kur bisedoni kuvendarët,

bisedoni për procedurat, jo për individët. Nuk është e drejta e kuvendarit me bisedua për individin për kandidatin. Ja u kam pru edhe CV-në po ua tregoj pika kur të vjen. Sa i përket komunitetit boshnjak, nuk ka pas kandidat të tjerë. Dhe ne nuk hymë në lojëra politike të dy partive. Ata kandidatë që i kanë plotësuar kushtet janë thirrë në intervistë. Kandidatët që nuk i kanë plotësuar kushtet, nuk e kanë pas dokumentin, certifikimin për drejtor, nuk janë thirr, as nuk do të thirrën, derisa Skender Susuri është drejtori i Drejtorisë Komunale për Arsim. Unë përgjigjem për procedurë. Marrëveshje dhe pazare politike dhe presione, me ato nuk merrem. Po ju tregoj në pikën e institucionet ku diskutojnë për konkurs.

**Osman Hajdari, drejtor i Drejtorisë për Administratë:** Sa i përket festave të qershorit ku çështjen e ngriti shefi i grupit parlamentar të PDK-së. Drejtorja e Administratës e ka pas një pjesë të organizimit. Ka asistua Drejtorinë e kulturës, ka pas një këshillë. Festat e qershorit kanë qenë të organizuara edhe nënë pantronatin e Kryeministrit. Që konsideroj që shumë shkelje ka pas prej Qeverisë, edhe është përzije pak agjenda edhe me nivelin lokal. Veç po të informoj për pjesën çka më takon mua. Projekt kapital i buxhetit të kaluar, Simir ka qenë. Ka qenë prej grandit 40.000 €. Edhe detyrimisht as drejtori i Kulturës, as kryetari i Komunës nuk kanë mund me ndal këtë. Ka shkua në procedurë tenderuese, që është krejt gabim. Kjo është një praktikë që është përdorë gjatë dy- tre vite të fundit. Po konsideroj që është viti i fundit që ka me qenë festat e qershorit dhe çdo festë e organizuar përmes tenderit. Aq më keq si investim kapital, i cili është keq klasifikim edhe raportet e auditorit e kanë lejuar. Ky projekt nëse s' ishte realizuar kishin shkua suficit prej grandit. Drejtori e ka zgjidh këtë procedurën. Kompania që është përzgjedh, ka qenë procedurë tenderuese. Po konsideroj në bazë të informatave që i kam është një kompani që shumë ka punua në këto dhjetë vitet e fundit. Në krejt gati organizimet i ka bërë. Mirë është ndoshta me analizua qysh e ka bo. Në këtë pjesën artistike është këshilli edhe Drejtori i Kulturës, besoj kur të kthehet do të jep përgjigje. Përndryshe në aspektin ligjor nuk kanë mund me i ik tenderit, për shkak të pozicionit që e kanë kategorizua si grand. Z. Shala ka ngrit një çështje për punëtorët, mu duk që e përmendi administratën. Administrata i ka gjashtë sektor z. Shala, të siguroj. Nuk ka asnjë punëtor pa vendim, nuk ka asnjë punëtor pa kontratë. Po foli për Drejtorinë e Administratës me shumë kompetencë. Nëse eventualisht ke ndonjë informacion për ndonjë individ të caktuar. Të inkurajoj thjeshtë edhe tash edhe kur do me ma dhënë. Po të siguroj që në sektor të administratës nuk ka asnjë punëtor pa vendim. Ka lëvizje të brendshme po janë mbulua me vendime me transfere të brendshme, për shkak të funksionalizimit të Drejtorisë sa më mirë. Kam telashe shumë në aspektin e protokollit, ndoshta ju kanë ra disa figura të reja mi pa aty për shkak se aty një pjesë e punëtorëve ka shkua në pension. Një pjesë i shfrytëzojnë këto pushimet e gjata, që janë në bazë të ligjit 45 e 50 ditë. Kështu që është dashtë mi bo disa

transfre të brendshme. Po kryesisht janë punëtorë me kontrata. Për Drejtorinë e Administratës me shumë kompetencë foli. Për drejtoritë tjera, besoj drejtorët do të përgjigjen. Behar Begaj ngriti çështjen e këshillit lokal. Është shumë e vërtetë për disa çështje që i ke ngritë. Është një rregullore që asambleja e kaluar e ka bërë. Mbi bazën e asaj rregulloreje faktikisht janë bërë zgjedhjet e këshillave lokal. Në konsultim me kryesuesin, ndoshta në seancën e ardhshme do të jetë formimi i komisionit për me vazhdua procedurat. Janë disa lokalitete të cilët nuk kanë kryetar të këshillit lokal. Kam provua gjatë kësaj periudhe me zgjidhë çështjen e pagesave. Po bindu që ajo rregullore e cila ka kalua prej asamblesë, nga ish menaxhmenti, ish-drejtori i Administratës. Faktikisht nuk është parapa qysh të bëhet pagesa. Është paraqit njëfarë shume. Mirëpo, mu ekzekutua është problem. Jemi konsultua me drejtorin e Ekonomisë qysh me bo zgjidhjen e pagesë, se është në rregullore. Edhe kam provua me bo zgjidhjen e vulave. Dy herë Ministria e ka anulua vendimin. Edhe pse konsideroj që është vendim shumë i diskutueshëm. Ndoshta më shumë në aspektin politik, ose se kanë analizua mirë. Përndryshe bashkësitë lokale, këshillat lokal janë pjesë e pushtetit, ku administrata komunale, Kuvendi komunal ka dhënë disa kompetenca disa përgjegjësi tek bashkësitë lokale. Sa i përket zyrave nuk ka asnjë planifikim buxhetor, nuk ka pas as nuk ka absolut se qysh kanë me funksionalizuar. Disa kryetar të zyrave lokale, rrinë nëpër zyra të gjendjes civile, që është në kundërshtim me ligjin mbi gjendjen civile. Kërkoet siguri se ka material të ndjeshëm. Kam disa raporte, vërejtje, pse disa kryetar të bashkësive lokale, rrinë dhe i shfrytëzojnë hapësirat e zyrës së gjendjes civile. Po planifikojmë të bëjmë një zgjidhje. Thjesht mi shfrytëzua këto bashkësi. Po me qenë aspekti ligjor, pas një përgjigje që marrim prej Ministrisë të Punëve të Brendshme. Edhe një përgjigje, ndoshta më shumë në aspektin politik. Z. Baldedaj e ngriti çështjen e Drejtorit të Kulturës, të një kolegut tim. Që vallahi kur e tha Iliri, nisa me dyshua a po e njoh mirë Ehatin, sa i fuqishëm ishte. Iljaz Iljazi është zgjedh përmes një kuvendi me 27 vota, pa asnjë votë kundër, pa asnjë votë abstenim. Të krejt partive kanë qenë. Ata shoferet janë staf mbështetës, nuk janë ofiqarë baca Lush, kryejnë do pagesa. Më mirë kryejnë pagesa se sa me ndej qaty rreth zyrave. E inkurajoj drejtorin Baldedaj, për çdo padrejtësi, paqartësi, shkelje, çfarëdo kontrate. Edhe në Drejtorinë e Kulturës, edhe ku do, me inkurajua edhe me qua në Prokurori ku donë. Po mirë është edhe mu kujdes edhe për veprat e veta edhe për shkeljet e veta. Mirë është mu kujdes. Iljazi është një qytetar i ndershëm Ilir, ish futbollist.

**Baldedaj:** Së pari mos fol për Drejtorinë e Kulturës, se s'je Drejtor i Kulturës...

**Hajdari:** Unë kam të drejtë me fol, jam drejtor politik, përfaqësoj parti politike. Unë jam pjesë e pushtetit, mundem mu përgjigj kujt do, nuk është

problem. Kryesuesi le ta vlerëson. Kështu që po mendoj është mirë mu kujdes për disa vepra tua.

**Baldedaj:** Po mos u merr ti me mua, mos u merr me mua.

**Hajdari:** Mos ndërhy. Të merresh me ato veprat e tua. Qoj veprat në Prokurori ku të duash. Ti e ke edhe një vendim gjyqësor o burrë, i dënuar je. Unë i kuptoj disa njerëz të përgjegjshëm me kërkua përgjegjësi.

**Kryesuesi:** Ju lutëm vetëm me përgjigjet. Mos të kalojmë me tema tjera.

**Hajdari:** Kështu që Ilir të inkurajoj edhe për drejtorin. Jo, jo i ke pesë, gjashtë vepra i ke.

**Kryesuesi:** A ka ndonjë drejtor tjetër që dëshiron të kthej përgjigje? Nëse nuk ka, atëherë i falënderoj drejtorët për përgjigjet, i falënderoj anëtarët e Kuvendit për pyetjet që i keni bërë. Për pjesën tjetër do ti merrni me shkrim, sipas afatit të përcaktuar me Statutin e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, për 30 ditë kohë, në mbledhjen e ardhshme.

**Ilir Baldedaj:** Tu kisha lut si kryesues, drejtorët le të japin llogaridhënie vetëm për atë emërim që e kanë. Nëse Osmani e ka autorizimin e Drejtorit të Kulturës, është çështje e tij. Unë nuk i bëra pyetje Drejtorit të Administratës dhe as emrin nuk ia përmenda. Nëse ky ka çështje me mua, kur donë munden mi zgjidhë.

**Osman Hajdari:** Ilir, unë jam drejtor politik, edhe vij prej një subjekti politik, për çdo çështje kjo është debat, asamble është. Edhe ti po ngreh çështje nga më të ndryshme si kuvendarë. Këtu jemi krejt struktura politike, s'ka shërbyes civil. Edhe përgjigjen me ta dhënë nuk është problem, kolegë jemi, ekzekutiv është. Mundem me dhënë përgjigje edhe në emër të kryetarit të komunës. Ne i kemi autorizimet, ti vetë ke qenë drejtor politik. Ke dhënë përgjigje për shumë tema tjera. Edhe unë jap përgjigje për secila tema ku e shoh që ka informacion. Sa kam informacion mundem me dhënë përgjigje. Unë jam post politik tash, nuk jam shërbyes civil. Kurrë nuk kam fol si shërbyes civil. Unë jam pjesë e qeverisë, s'ka lidhje për dikasterin. Unë po të jap përgjigje, nëse nuk je i interesuar të japim edhe me shkrim. Mos merr këtë që unë jam drejtor politik, edhe duhet me u kufizua veç në shërbim të administratës. Ne kemi edhe qëndrime politike. Edhe si subjekt politik mundem me mbajt një qëndrim. Unë edhe i kryetarit Haskuka, edhe i VV-së, edhe i LDK-së, edhe i Nismës, nuk ka rëndësi kjo, edhe i koalicionit edhe i minoriteteve. Mendimin politik s'mundem me ma ndal kurrkush, a po kupton. Jam i gatshëm edhe në emision edhe ku doni debatojmë. Ku do debatojmë edhe kjo është foltore në

asamble. Edhe ashtu rrallë po shihemi kështu që po e shfrytëzoj. Nëse është e ndaluar me ligj ose me rregullore që drejtori politik mos me fol për çështje të kulturës, unë kërkoj falje. Gjeje në rregullore ku është unë e tërheq fjalën nëse jeni i ofenduar.

**Pika e katërt:**

**Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2019 – 2021.**

**Kryesuesi:** Materialet i keni marrë me kohë, keni pas rast që ta shikoni këtë Draft Kornizë, e cila siç e dini, besoj anëtarët e Kuvendit e dinë, po edhe anëtarët e ri. Është vetëm një udhëzues që i paraprinë hartimit të buxhetit të komunës së Prizrenit. Pra, nuk është buxhet i komunës së Prizrenit. Sepse patëm disa takime me anëtarët pse s'është përfshi ky projekt, pse s'është përfshi ai projekt. Po vetëm të jemi të qartë, është obligim ligjor që të miratohet ky draft si orientim. Pastaj në radhë është qarkorja e dytë e Ministrisë së Financave që vjen e modelon. Dhe buxheti hartohet në shqyrtim publik, në debate publike, në KPF, dhe për fund e miraton ose e modelon përfundimisht ky Kuvend me votën e juaj. Pra, është nisma e parë që shkon drejtë buxhetit. Janë vetëm përcaktim i tavaneve. Për me tepër këtu ftoj përfaqësuesin e Drejtorisë së Financave z. Zenelin që të na bëjë një prezantim të këtij drafti.

**Zenel Ahmetaj, përfaqësues i Drejtorisë për Financa:** Në pika të shkurta edhe kryesuesi e elaboroj në lidhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore. Do të thotë është si pikënisje, si kufizim, apo limitim i buxhetit të cilin e kemi marrë nga Qeveria. Një njoftim të shkurtë në lidhje me buxhetin të cilin komuna e Prizrenit parashikon ta ketë në vitin 2019 dhe në vitet 2020 dhe 2021. Në bazë të qarkores së parë të datës 15 maj, Komuna e Prizrenit do ti ketë në dispozicion për vitin 2019, 47.388.815 €. Nga kjo shumë si burime të këtij buxhetit janë grandet e përgjithshme, grandet specifike për arsim dhe shëndetësi. Pastaj kemi një huamarrje për shëndetësi, arsim dhe nga burimi tjetër i dytë nga të hyrat vetanake. Nga kjo shumë në përqindje buxheti nga grandet do të jetë 81.6% dhe hyrat vetanake 18.4% . Për vitin 2020, komuna e Prizrenit do ti ketë në dispozicion rreth 49.120.191 €. Ndërsa në vitin 2021, do ti ketë 50.996.946 €. Mirë është me përkujtua që këtë vit që jemi, komuna e Prizrenit ka një në dispozicion një shumë prej rreth 5.000.000 €, më shumë se viti 2018. Kemi një rritje të hyrave në vlerë prej rreth 2.600.000 €, do më thënë parashikim që do të kemi, si inkasim. Po gjithashtu do të kemi edhe një rritje të grandit në shumë prej 2.934.653 € apo në përqindje rreth 8%. Në krahasim për vitin 2018, komuna e Prizrenit do të ketë më tepër në përqindje rreth 13%, apo 5.549.000 €. Ky buxhet planifikohet të shpenzohet për vitin 2019, 2020 dhe 2021, në pesë kategori ekonomike. Besoj pjesa dërmuese i dinë në lidhje me këto kategoritë ekonomike. Kategoria e parë është paga dhe mëditje për të gjithë të punësuarit

në arsim, shëndetësi dhe stafin civil në komunën e Prizrenit. Pastaj për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Shërbimet komunale, Subvencionet dhe kategoria e fundit, investimet kapitale. Komuna e Prizrenit tani ka planifikua si kornizë jo të detalizuar, që për kategorinë e pagave do të shpenzoj rreth 20.555.000 €. Do të thotë në krahasim me këtë vit është një planifikim në rritje të shpenzimit për rreth 600.000 €. Për kategorinë e mallrave në një vlerë prej 5.778.796 €. Të gjithashtu është një rritje një krahasim me këtë vit. Për shërbime komunale rreth 1.091.191 €. Në kategorinë e subvencioneve komuna e Prizrenit ka planifikuar të shpenzoj në vlerë prej 973.725 €. Dhe sa për njoftim në krahasim me këtë vit është rreth 100% më shumë se që ka në vitin 2018. Gjithashtu edhe në investimet kapitale komuna e Prizrenit planifikon të shpenzoj rreth 18.990.367 €, apo në përqindje rreth 40% të buxhetit të tërësishëm. Detalet i keni në material, edhe limitet apo kufizimet. Është si kornizë afatmesme buxhetor për tri vitet e ardhshme. I keni të specifikuar edhe investimet kapitale. Unë e vërejtja se disa kuvendarë dhanë vërejtje, se, pse ky projekt në disa rajone të caktuara. Unë besoj se nga Ministria nga muaji korrik nga ministria e financave do ta pranojmë qarkoren e dytë buxhetore, në të cilën do të jetë i specifikuar i gjithë buxheti. Do më thënë rreth 47.300.000 €, do të jetë i përcaktuar apo i kufizuar nëpër kategori ekonomike. Prandaj fillon ajo faza tjetër e planifikimit të buxhetit. Që besoj edhe kryesuesi e tha që do të fillojnë edhe dëgjimet publike. Nëpër rajone, në asamble, në mes të anëtarëve të KPF-së dhe kategorive tjera. Prandaj është faza tjetër që do të filloj duke marrë kërkesat nga rajonet e ndryshme. Dhe të gjitha ato kërkesa do të jenë si prioritet i gjithë atyre projekteve që parashohin se do të prioritet për vitin 2019, 2020 dhe 2021. Në përgjithësi kjo ishte rreth kornizës afatmesme buxhetore.

**Sencar Karamuço, zëvendëskryesues i Kuvendit:** Tash po shkojmë me qëndrimet e grupeve parlamentare.

**Simir Krasniqi:** Grupi i PDK-së nuk e mbështet Kornizën Afatmesme, sepse shumë ndryshime janë bërë.

**Adem Shabanaj (LVV):** Sigurisht që do ta mbështesim, sepse nuk është kornizë që është e përfunduar. Është kornizë orientuese, e cila në shtator do të orientohen investimet kapitale tjera. Nuk e di pse nuk duhet votuar kjo pikë e rendit të ditës.

**Haziz Hodaj:** Ç 'është e vërteta unë edhe pikën pyetje përgjigje u deklarova se nuk do ta votoj. Mirëpo, në konsultim edhe me zyrtarin për Financa edhe me grupin tim. Duke marrë parasysh që kjo Kornizë Afatmesme duhet të ndryshohet dhe patjetër duhet të ndryshohet në pozicione të caktuara me kërkesat tona. Ne kësaj radhe do ta kalojmë. Mirëpo i kisha sugjerua edhe zyrtarit për Financa edhe juve, që mos të punohet me forma, veç bartje e kopjes

dhe pozicione buxhetore sa për të qenë. Unë kam kërkuar edhe në mandatin e kaluar nga Kuvendi i kaluar, që të futen në kornizë buxhetor, vetëm ato projekte që mund të realizohen brenda vitit. Sigurisht që të gjitha s'mund të realizohen, sepse nuk ka mundësi kohore edhe teknike. Por bile shumica prej tyre të realizohen brenda vitit kalendarik. Jo të kemi një kornizë buxhetore ja një projekt buxhetor, ku pozicione buxhetore veç për të plotësuar dëshirën apo kërkesën e shumë qytetarëve e shumë anëtarëve të Kuvendit. Dhe për realizim mandej shohim e bëjmë. Kështu që kësaj radhe do ta kalojmë Kornizën Afatmesme Buxhetore. Por duhet të keni kujdes që të konsultoheni me anëtarët e Kuvendit, me KPF- në. Dhe kur të vijë drafti final, pastaj të jetë kërkesa shtesë e qytetarëve. Sepse tek e fundit ka qenë edhe premtim elektoral edhe i kandidatëve për kryetar dhe kryetarit që është tani.

**Pranverim Berisha (Nisma Socialdemokrate):** Nisma Socialdemokrate nuk e përkrahë këtë Kornizë Afatmesme Buxhetore, për shkak që ka mungesë dhe mos përfshirje të disa projekteve që ne i konsiderojmë të rëndësishme. Andaj ne nuk do ta votojmë.

**Ilir Baldedaj:** Që i ndërron Hazizi fjalët, hiq pik dyshimi s'kam pas. Ne nuk e mbështesim këtë kornizë e cila vërtetë... Sepse në një emision bashkë kur ka qenë kryesuesi, Hazizit zëri ju ka pas shqye duke thënë projekte të papërfunduara, ka pesë vjet. Merre kornizën Haziz lexoje dhe e sheh çfarë projekte ke. Ne nuk e mbështesim.

**Haziz Hodaj:** Nuk e di se si Iliri do të gjendej po të mos isha anëtar i Kuvendit, edhe po të mos reagoja unë. Ku do të gjente mandej motivin për me fol. Unë thash më duket, kjo është nisja e kësaj kornize afatmesme buxhetore edhe na do ta kalojmë formalisht. Nuk ka "birë nene" që ka me shti grupin parlamentar të LDK-së të votoj një buxhet të perealizueshëm sikurse viteve tjera. Edhe njëherë po të them. Mbaje mend mirë këtu në Kuvend, nuk ka forcë që ka me shti LDK-në me votua një buxhet që nuk ka mu realizua, pikë.

**Ilir Baldedaj:** Po që unë s'kam mbërri shumë lart me pas ndonjë idol në politik la Haziz. Kështu që të kam idol ty.

### **Cenet Sajadi: 01.27.06**

**Memnuna Ajdini:** Dakle kao forma koja je data za srednjoročni okvir budžeta opštine za ovaj period, svakako je pozitivna. Međutim očekujemo da će u tom periodu biti u hodu i nekih izmena. I svakako da ćemo podržati.

**Azem Durmiši:** Glasačemo, ali kako vidićemo kasnije.

**Dafina Billaca (PDK):** Në njëren nga seancat e mbajtura kam kërkuar të ndërtohet një sallë e edukatës fizike në shkollën “Ibrahim Fehmiu”. Sepse nxënësit e kësaj shkolle të qytetit, nuk kanë si të zhvillojnë aktivitete të lëndës së edukatës fizike. Nga drejtori i Arsimit kam marrë miratimin që kjo sallë e edukatës fizike do të ndërtohet dhe ky projekt do të realizohet. Këtë e ka thënë publikisht i nderuari Drejtor, shumë herë. Por në listën e projekteve kapitale për komunën e Prizrenit për vitin 2019-2021 nuk e shoh që mjetet janë të ndara për këtë sallë. Pyetja ime është çdo të ndodh me këtë premtim, si do të realizohet, me çfarë mjete dhe kur? Gjithashtu drejtor unë vërejtja se në Lubizhdë, në Lubinjen e Epërme do të ndërtohen salla të reja të edukatës fizike. Pastaj renovim të sallave do të ketë disa shkolla tjera. Pastaj në Planë do të bëhet rregullimi i oborrit të shkollës. Të gjitha këto janë projekte të mirëseardhura, por duhet të jenë në kohën e duhur. Për shembull këto renovime dhe rregullimi i oborrit nuk janë esenciale dhe të domosdoshme për mendimin tim. Përderisa shkolla e mesme teknike “11 Marsi” me mbi 1500 nxënës vazhdon të anashkalohet dhe të jetë një shkollë pa sallë të edukatës fizike, nuk më duket e drejtë që të investohet në oborre dhe në renovime. Po kishte me qenë e drejtë të jepet mundësia aty ku vërtetë ka nevojë. Gjithashtu kam vërejtur në listën e projekteve kapitale në komunën e Prizrenit, që në disa fshatra apo lagje është ndarë një shumë koga e madhe. Ndërsa në disa lagje nuk është ndarë një shumë, apo është ndarë një shumë, shumë simbolike. Për shembull gjithmonë e kam cek Arbanën dhe po vazhdoj ta cek. Arbana ka ndarë një shumë 100.000 €. Gjithashtu Jeni Mahall, Tabakhane, Kurilla. Ku dihet numri i banorëve dhe dihen kërkesat e tyre. Mendoj që duhet ta marrim pak më seriozisht këtë çështje dhe të ndahet një shumë pak më e madhe për ta rregulluar jetesën e këtyre qytetarëve. Sidomos në lagjen Arbanë, vazhdoj të bëjë apel te drejtori që të vij, apo edhe të kryetari, sepse ai s’ka punë tjera pos me buzëqesh, edhe me i krye do punë lidhje e palidhje. Kështu që, le të vinë, le ta shohin pak çështjen edhe problemin në këto lagje. Në kornizën afatmesme buxhetore komunale, zyra e kryetarit në vitin 2018 ka të ndarë shumë prej 128.000 €. Në vitin 2019-2021, është e planifikuar për zyrën e kryetarit 275.000 €. Kjo do të thotë që 130.000 €, dëmtohen qytetarët e Prizrenit duke ju shtuar zyrës së Kryetarit. Kryetari i cili pat premtuar që do të jetë kryetar në favor të qytetarëve. Unë nuk shohë këtu çfarë favor i ndaj qytetarëve. Kjo është vjedhje apo mund ta quaj manipulim me qytetarët e Prizrenit.

**Fatmir Kastrati:** Ne si AAK-së do të jemi kundër këtij propozimi. Unë e di se baza është kjo, se është bukur vështirë mandej projekte të reja me shti. E kemi nga përvoja në të kaluar. Po, po më duket siç thoshe Hazizi vazhdimisht në seancat e kaluar, është fontanë dëshirash. Po sot nuk e tha ndoshta ka harrua. Edhe kjo është fontanë dëshirash. Lagjja “2 Korriku” në këtë projekt nuk ishte paraparë asnjë cent të investohet në këtë lagje. Lagjja pak më poshtë “11 Marsi” 500.000 €, nuk e di cili është dallimi. E dyta, nga z. Alush Shala është kërkuar

më herët që kemi kërkuar edhe ne që të ndërtohet një shkollë. A do të jetë shkollë e pavarur, apo pjesë e shkollës “Lek Dukagjini”, për të dy lagjet. Lagjja “2 Korriku” dhe lagjja “11 Marsi”, nuk është në kuadër të këtij projektbuxheti. Janë do investime të cilat kanë mundësi të presin. E do investime që janë aktuale që patjetër duhet të bëhen, janë heq prej buxhetit. Unë nuk e kam të qartë edhe njëherë për lagjen “2 Korriku”, a do të rregullohet ujë i pijes apo nuk do të rregullohet? Kur e kryej unë seancën, kjo pyetje kur shkoj në lagje më bëhet vazhdimisht. Në qoftë se kryhet sivjet ta di. Në qoftë se nuk kryhet, pse janë heq mjetet të cilat kanë qenë të parapara edhe në 2019, 2020. Është paraparë rruga të rregullohet nga Zymi në Lubizhdë. Nuk e pash që është futur në projekt. Është premtuar që sa kohë. Edhe deri në gjysmë është krye, gjysma tjetër ka mbet. Ose kush i bon këto propozime, kush po i fut këto projekte këtu, kush po pyetet. Unë e shoh që këtu janë bërë do propozime, por kush i ka bërë nuk e di. Edhe në bazë të ç’ kafit, cilat janë kriteret. Në çdo pozicion ka do kriteret se si bëhet ajo punë.

**Alush Shala:** Pjesën e shkollës e përmendi Fatmir Kastrati, që nuk është kërkesë vetëm për qeverinë tuaj aktuale. Ka qenë kërkesë edhe e qeverive të kaluara. Edhe gjithmonë ka pas premtime. Dhe në fakt gjithmonë është ndarë një vijë buxhetore. Arsyetimet kanë qenë më të ndryshme dhe asnjëherë nuk kanë qenë korrekte. Tani është eliminua fare kjo. Kjo është eliminua, nuk e kam pa. Po unë bisedën do ta orientoj më shumë te lista e projekteve kapitale. Tani për tani kisha dashtë të di vetëm për shkollë çka po bëhet.

**Shukri Quni:** Unë këtu përpara i kam këto të dy këto kornizat edhe ne që i kemi aprovua më herët po edhe kjo e tanishmja. Unë këtu vetëm shoh ndryshim që janë heq projektet. Nuk është shtuar asgjë. Po flas edhe unë nga ajo anë kah vij për shembull. Është heq ndërtimi i rrugëve lokale me kod është 40603. Vazhdimi i projektit, është fjala për fshatin Nashec, edhe rrugët lokale, kanalizimi, që janë të pakryera duhet me vazhdua. Janë ndarë, 70.000 €, plus 70.000 € plus 70.000 €. Do më thënë tri vjet. Tani për katër vjet s’keni paraparë për këto pjesë asnjë investim veç keni heq. Është heq qendra për kulturë, sport dhe rini në Nashec, në drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Është heqë prej Drejtorisë së Turizmit parku turistik i Nashecit, që kemi ndarë mjete këtu, kjo është heq fare. Bile unë po habitëm kryesues, ku kryetari veç e ka premtua Nashcin me shpallë edhe fshat turistik. A katër vjet asnjë projekt nuk e ka paraparë për me investua anë këtë fshat. Pastaj ndërtimi i trotuarit në fshatin Nashec, që është bërë kërkesë edhe prej kuvendarit të VV-së, që Nasheci është pa trotuar, edhe ky fare nuk është në këtë kornizë. Po ashtu edhe ndriçimi publik i fshatit, që nuk kemi ndriçim. Edhe kjo është premtuar për mu realizua, nuk është fare në projekt. Të rruga “Besim Shala” që shkon rruga për në Nashec edhe aty një pjesë që duhet të rregullohet kanalizimi. Sepse komplet ajo lagje i derdh në fushë edhe për skaj rrugës për Nashec. Aty kundërmon erë në këmbë

s'mundesh me ec fare. Plus aty duhet të jetë, e ka bo edhe Alush Shala një kërkesë më herët, për një trotuar që duhet mu vazhdua, prej rrugës "Besim Shala" deri në Nashec. Sepse dalin aty qytetarët edhe ecin në mbrëmje, po edhe një shteg për biçikleta nuk ka qenë keq për atë pjesë. Pastaj ndërtimi i impiantit në Nashec, ku derdhën më së 60% të ujërave të zeza. Këtë e dini, edhe kuvendari më i vjetër veterani i këtij Kuvendi z. Haziz Hodaj. Që nga viti 2004 mos gabofsha këto ujëra të zeza derdhën në Nashec. Duke filluar prej Jaglenicës atje – Dardanisë, Bazhdarhane, Jeta e Re, Arbana, e kështu më radhë. Këtu duhet të bëhet një investim jashtëzakonisht i madh. Ato ujëra nuk guxojnë mu derdh në Nashec, sse aty po derdhën thash edhe në fushë. Është shkatërrua edhe fusha. Është i njoftuar edhe drejtori besoj për Bujqësi, me ato ankesa që i ka bërë popullata. Edhe ata kërkojnë me ju pagua dëmshpërblimi. Unë besoj që këto duhet me hy edhe nuk bënë mu heq. Për impiantin kërkojmë ndihmë edhe nga deputetet që e përfaqësojnë Prizrenin, pa marrë parasysh a janë të PDK-së, apo të LDK-së, apo të AAK-së, apo të partisë turke apo boshnjake. Kërkoj pastaj vazhdimin e projektit. Dëgjo çka po të them, kur ka ardhur kryetari për mua që e konsideroj shumë të respektuar Eqrem Kryeziu me pre shiritin rrugës Nashec-Prizren unë e kam prit me mish e me pite, mos harro. Ndoshta ka qenë ai pozitë unë opozitë. Po unë e kam prit qysh është më mirë, sepse është rregullua rruga. Qaj që punon edhe dhe investon, unë atë hero e shpalli. Ai që heq projektet edhe i largon ai për mua s'di çka mi thënë. E dinë Shkodrani çka po dua me thënë. Vazhdimi i projektit rruga Planej-Pashtrik, ku janë të rënë 36 dëshmorë Artan, atë e dinë edhe komandanti i juaj Rexhep Selimi. Se Mujë Krasniqi është i rënë aty me 36 dëshmorë. Ne kemi arrit me bo trasenë edhe rrugën. Juve tash po ua lëmë që asfaltin me shtrua aty. Mos mu heq projektit kjo. Pastaj ndërtimi i rrugëve lokale në fshatin Romajë, ja keni heq Gzmit krejt çka ka pas. Boll ka qenë në zor me do drejtorë tonë, tash edhe me ju. Bile me dhunë i kemi shti, mos kujto që i kemi shti me fjalë këto projekte këtu. Sa herë na ka dal prej mbledhjes, kur kemi pas mbledhje me kuvendarë, s'ka të numëruara, i lëshojshin, dalshin jashtë drejtorët. Pastaj është hekë prej projektit, ka qenë në projekt edhe një ambulancë në fshatin Romajë. Kemi kërkuar mu ndërtua një rezervuar tek gurra e Mazrrekut, dhe mu bo hulumtim aty për ujë, sepse ekziston gurra. Duhet me hy kjo në projekt. Po ashtu mu ndërtua rezervuari në Trumq të Planesë, sepse edhe aty ekziston burimi edhe mu bo hulumtimet edhe më tej për zbulim të ujit, megjithëse ka. Pastaj ndërtimi i infrastrukturës në fshatin Kobaj ka qenë, është heq. Edhe këtu duhet me vazhdua projektin, se janë do lagje që ne si PDK i kemi lënë anash ka pak, e ju bile mos i lini. Pastaj kur po flas për Nashec kogja do fjalë të forta i keni dhënë. Veçse e lini Nashec in pa asnjë projekt, unë jam duke u habit. Edhe keni premtuar që shumë do të investoni. Edhe do të shpallet ky, fshat turistik. Inshallah s'jet veç në letër se edhe ne kemi premtuar para jush. Bile ka qenë RTK-ja ja tri katër herë ka marrë intervistë. Tash ju kishit qua edhe TV Dukagjinin, unë s'dhashë intervistë fare, boll thash se po më duken të kota. Na

RTK-në e kemi pas nja tri katër herë se kush e bike nuk e di. Edhe nja dy herë s'kam dhënë fare. Në intervistën e tretë thash kjo është veç rren dhe pallavra. Kështu që mos të mbesin projektet në letër. Edhe ato që i keni hekë me i shti. Unë nuk jam për mos mu votua korniza. Unë nuk jam sikur ju që asnjëherë se keni votua asnjë kornizë, asnjë projekt, asgjë. Ju gjithnjë keni thënë zi, kurrë bardhë s'keni thënë. Tash po më vjen mirë që po thoni, se ato projekte qenkan krejt qysh i ka paraparë PDK-ja më herët, këto tash janë. Por që i paskit heq, nuk keni bërë mirë. Është mirë këto mi shti, që i shtini këto, unë jam për. Që nuk i shtini... Se kjo, është... Hazizi u deklarua për krejt grupin e vetë. Kjo vajza afër meje tha në Planejë. Që harrova me cek në Planejë. Në Planejë është shkolla, aneks drejtor duhet me pas, se aty shumë e ngushtë është. Është ndërtuar në kohën e luftës. Jo oborri kolege-kuvendare me kupëza. Po me mund edhe me kallaj nga pak i qes përmbi, që mos mu prish kurrë. Se ne gjithnjë jemi mësua me ec shtigjeve, kurrë rrugëve jo. Artan ke pas kritikuar njëherë që po i ndërtojmë rrugët edhe nëpër male. Ke pas thënë që ka qenë duke të shkel një kerr një golf dysh në atë vakt, e kam këqyrë aty. Nuk janë të shtruara të gjitha, sinqerisht e kam nuk janë të shtruara të gjitha. Aty ku është një projekt për shtrimin e rrugëve me zhavorr hiqni krejt atë. Sipas juve ajo duhet mu heq krejt, se këto rrugë janë shtruar. Na keni kritikua që jemi qeveri e asfaltit e betonit e kupëzave e kështu më radhë. Prapë keni vazhdua me atë, vazhdoni s'është problem, veç projektet duhet me i pa këtu. Është një projekt diçka te porta e komunës. S'është drejtori këtu se i kisha thënë hiqe automatikisht. Po erdh tash, drejtor hiqe atë projektin që e ke këtu para portës 40.000 € ishte, hiqe atë. Mos investo aty, s'ka nevojë. Edhe muri rrethues me ato pare hiqet, sepse keni premtua që kur të vini keni me heq murin rrethues të komunës. Këto premtime që i keni dhënë duhet me i realizua. Këto që i ceka më lartë duhet me hy në kornizë. Jo vetëm në letër po me realizua, spse është në të mirën e qytetarit. Unë nuk bëjë politika të mëdha sikur disa. Por këto çka janë për mua janë boll. Do të jam këmbëngulës që këto mu realizua. Drejtoresha për Turizëm e ke një projekt që është i bërë. Projekt prej ekspertëve qysh e di unë. Bile edhe Shkodrani kogja u përzije në të. Ai duhet me dal këtu, me pa kuvendarët, çka është punuar edhe çka duhet të punohet. Apo vetëm do ta bëjmë sa për kohën e fushatave. Unë në kohë të fushatave, edhe diçka Artan! E kom lënë Nashecin pa ndriçim. Që tash jam kah vuaj shumë për atë. Pse, pikërisht kanë ardhur në kohën e fushatës me e vendos nëpër fshatë ndriçimin. Edhe i kam kthye, i thash a tash e keni gjet a? Kurrë më ajo firmë s'është lajmërua. Edhe kështu që mos i ktheni projektet mbrapa, kryeni. Sepse dikur është vonë, sikur për mua tash që jam fajtor numër një, që s'ka fshati ndriçim. E këtë shpresoj që ju keni me bo.

**Behar Begaj:** Unë në këtë draft kornizë, nuk po i shoh disa projekte të Zhurit që janë fut këtu për investime kapitale. Kemi të bëjmë me shtëpinë e kulturës. Ku e dini shumë mirë se është bërë histori kjo punë e sajë. Sikur të kishte qenë një investim i tërë Kosovës, e jo vetëm i Prizrenit. Po nuk e di pse

nuk po përfundohet me këtë çështje. Kryesues, ju e dini shumë mirë se është kërkuar të bëhet një ekspertizë. Edhe po e shoh që këtu nuk është interesi i kryetarit ta them, që të bëhet një gjë e tillë. Po më habit pse nuk është fut në këtë kornizë, një buxhet për shtëpinë e kulturës. Kërkoj që kjo të hynë në këtë kornizë, përndryshe jem i pakënaqur me këtë kornizë që është hartua nga njerëzit tanë. E dyta, në pjesën e Zhurit, jeni të gjithë të njoftuar, që tri vite e ngrejë këtë shqetësim, për kanalizim të pjesës së Zhurit të ri. Më të vërtetë nuk mund të them se është një lagje shumë e vogël, mund të them se është më i madh se disa fshatra që i kemi përreth. Dhe ata vuajnë edhe këto ditë për një kanalizim. Një projekt e di se është bërë më herët nga Kuvendi komunal dhe nuk është marrë parasysh asnjëherë. Mandej kemi të bëjmë edhe me një rrugë malore e cila është bërë para katër viteve aty te na. Vetëm është hap, është punua punë fizike me bager. Dhe është mbet në atë gjendje katastrofale. Ajo rrugë është shumë e rrezikshme. Kisha kërkuar që ajo rrugë të hy në projekt dhe të shtrohet qoftë me kupëza, qoftë me asfalt.

**Sadije Osaj (LDK):** Ajo që desha unë të them është tek lista e projekteve, nuk e shoh kërkesën time, që e kam bërë në seancën e mëparshme. Dhe dua të pyes se ku mbeti kërkesa, ku juve ju kam dorëzuar nënshkrimet e mbi 200 familjeve të lagjes Ali Pash Tepelena. Këtu shoh që flitet për ndërtim dhe për rregullim të rrugëve. Ndërsa në atë lagje është mbyllja e rrugëve. Ankesat i dimë të gjithë, i kemi parashtruar jo vetëm unë, por edhe kandidatë tjerë. Kërkoj që të futet edhe tek lista e projekteve.

**Shukri Quni:** Veç e kam fjalën që ishte heq prej projektit edhe kulmi i shkollës “Remzi Ademaj”. Jo nuk ishte në projekt. Aty është një projekt më i madh. Është pllaka, dyer, dritare, kulmi të gjitha. Inshallah, atëherë urime pra.

**Skender Susuri:** Aty do të fillojnë punimet, kemi bisedua me drejtorin dhe është në pozicionin e 2018-ës. Në rregull është ajo. Po kjo është në 2019-ën. Për shkollën në Planëje nuk kam shumë informacione, dua të jem shumë korrekt. Edhe s’kam arrite me vizitua deri më tash. Vetëm e di që duke i falënderuar drejtorit të Shërbimeve Publike. Ne kemi reaguar në oborr, s’ka pas kupëza më duket atje. Janë duke u shtruar do rrugë, edhe e kemi shtruar edhe oborrin. E shënova këtu edhe e trajtojmë me prioritet. Salla e edukatës fizike dhe poligoni sportiv. Po, ne kemi bisedua me drejtorin aktual, dhe ja kemi marrë 20.000 € Krajkut, për të bërë një intervenim momental atje. Mirëpo problemi e dinë Zeneli rishikimin e buxhetit ndoshta nuk e di qysh ka me qenë telashja. Përndryshe ja kemi marrë Rrem Qoqës edhe Rremës ia kemi shtua në 201,9 aty i ka 100.000 €. Poligoni sportiv do të bëhet këtë vit. Por problemi është të rishikimi i buxhetit. A ka me mund me na ndikua këtu a jo. Parat janë të marrura prej Krajkut të qitura në Arbanë. A për atë sallën e edukatës fizike, ajo është një sallë shumë e madhe. Dhe ajo ka kosto të madhe, do më thënë aty nuk

mundemi kurrjë me thënë. Sa i përket shkollës në lagjen e las Lush edhe profesor Fatmiri, ajo nuk ndodhët këtu la Lush, po ajo në vitin 2019. Do më thënë fillojnë punimet me buxhetin e Ministrisë në 2019-ën. Në atë projekt kemi marrë kalueshmëri, na ka informua komisioni përkatës prej Ministrisë. E dinë drejtori ia kam dërgua një kërkesë, ma ka sigurua një lokacion. Mirëpo, na jemi në kërkim të lokacionit më të përshtatshëm. Ku ka mu vendos ajo shkollë e bashkëbisedojmë bashkë me ju. Ne dokumentacionin e kemi qua në Ministri. Ministria na ka dhënë dritën e gjelbër. Shkolla i ka 20 dhoma mësimi. Ajo nuk është paralele e “Lek Dukagjinit”, është shkollë amë. Po lokacioni i saktë, se i kemi dy tre lokacione. Njërin që ma kanë pru shërbimet e drejtorit, nuk më ka konvenuar mua, se është shumë larg, gati atje të rruga ku dalësh dhe neve na intereson një lokacion mundësisht kah mesi. Sepse më të vërtetë aty ka shkallë të lartë të rrezikshmërisë të fëmijëve që aktualisht udhëtojnë. Do më thënë ajo është me financim të Ministrisë. Njësojë që e dha edhe kuvendari Haziz Hodaj, jarani jem. Se edhe në Gjonaj ne duhet me intervenua sepse vërtetë ata fëmijë janë të rrezikuar.

**Ertan Simitçi, drejtor i Drejtorisë për Financa:** Zyrtari jonë, zyrtari kryesor, z. Ahmetaj i dha sqarimet se çka është qëllimi i kornizës afatmesme buxhetore, i cili në bazë të kornizës afatmesme të shpenzimeve që e përpilon Qeveria e Kosovës, i cakton të gjitha organet publike, që të caktojnë apo të planifikojnë një buxhet për vitet e ardhshme, apo një program Qeverisës për vitet e ardhshme. Me këtë qarkore caktohet buxheti total dhe në bazë të kërkesave nevojave të komunave apo të organeve publike caktohet programi i qeverisjes. Ne si Drejtori e Financave, bashkë me OSBE-në kemi pas një takim në muajin maj (muajin e ramazanit), disa përfaqësues të Kuvendit kanë qenë aty prezent. Edhe i kemi njoftuar që sivjet do ta bëjmë një ndryshim të procesit të planifikimit të buxhetit. Çka është ajo!- që marrë edhe shumë vërejtje nga auditorët. Kemi pasur problem të zbatimi i buxhetit në komunë, apo në terren, për shkak se kemi pasur shumë kërkesa që kanë ardhur të votave, apo politikave janë futur në listën e kapitaleve. Edhe drejtorja përkatëse nuk ka pasur projekte, të analizuar të hartua edhe koston nuk e kemi përcaktua mirë. Edhe tani kemi pasur telashe në zbatimin e projekteve në terren. Si shembull mundem me thënë haptas ka qenë, e dinë edhe ish-drejtoresha, shpenzimi për qytetarët për varrime. Që e kemi fut në investimet kapitale, në fakt menjëherë auditori na ka dhënë vërejtje. Kjo ka qenë diçka që kemi pasur urgjent politike, edhe kemi marrë vërejtje. E dyta mundem me thënë projekti Faherin Hoti. Planifikimi 15.000€. Projekti po del 500.000 €. Do më thënë kemi pasur shumë gabime, që janë bërë, për shkak se nuk kemi mundur ti analizojmë mirë projektet. Me nxjerrë koston sa duhet, sa është e saktë apo afërsisht. Apo mu konsultuar me zyrtarët e drejtorive përkatëse me inxhinier me arkitekt, që me ata bashkë. Për këtë arsye unë edhe kryetarin por edhe me kryesuesin e kam bo një bisedë, edhe e kam dhënë një propozim. Që, pas KAB-it, kemi edhe dy muaj kohë deri në

fund të gushtit të bëjmë dëgjime publike. I kam propozua kryetarit që të bëjmë minimum tre apo katër dëgjime publike. KPF-ja njëjtë, tre apo katër. Të gjithë përfaqësuesit e kuvendit, ju që jeni jeni përfaqësues të qytetarëve, të mbani edhe vetë dëgjimet publike me qytetarët. Edhe të kemi kohë tani me i analizuar mirë projektet, me hulumtua mirë. Edhe me i bo kërkesat te drejtoritë përkatëse. Që në atë mënyrë drejtori nëse e merr përsipër, e sheh prioritet apo të arsyeshme, apo është e nevojshme për komunën, që të fut në listën e shërbimeve kapitale, apo në mallra dhe shërbime, apo në subvencion. Vitin e ardhshëm do ta kemi propozimin që të jetë mbi 900.000 € buxheti i subvencioneve. Në vitin 2018, sivjet kemi pas afër 500.000 €. Ne kemi qenë ata që kemi kërkuar nga Ministria që të na rrit buxhetin për shkak se kërkesat dhe nevojat janë shumë. Kemi shumë projekte që janë në vazhdimësi, që duhet ti përfundoj qeveria përkatëse. Po ashtu janë disa projekte që janë me prioritet që duhet të kryhen. Ndoshta kanë qenë me prioritet me u krye edhe për sivjet, por për shkak se ende nuk kemi informatë zyrtare për rishikimin e buxhetit. Ne si ekzekutiv kemi mendua që disa projekte ti rregullojmë me rishikimi e buxhetit në vitin 2018. Po nuk kemi mundur për shkak se ende nuk është zyrtare. Kemi biseduar edhe me kryesuesin që të shfrytëzojmë atë mundësin që 25% me bo ndryshimin brenda buxhetit të komunës së Prizrenit për vitin 2018. Dhe besoj se deri më 15 maksimum deri më 20 korriku, ato kërkesa që do të vinë edhe nga ju për me i realizuar sivjet, do ti fusim në këtë 25%, që janë urgjent edhe me prioritet me u krye sivjet. Janë shumë kërkesa, edhe vitin e kaluar kemi pasur shumë kërkesa nga qytetarët për ujë të pijshëm. Nëse nuk gaboj në seancën e kaluar këtu ka qenë edhe përfaqësuesi i Hidroregjionit. Edhe ai atë ditë mirë tha. Çka keni kërkesa apo propozime në lidhur me ujin e pijes apo kanalizim, ejani të bisedojmë, ta bëjmë bashkë një hulumtim dhe ti menaxhojmë bashkë me drejtorinë përkatëse të Shërbimeve Publike projektet. Projekti i Bazhdarhanës që është për ujë, është në vazhdimësi. Besoj që nëse nuk ndodhet diçka e keqe, deri në fund të vitit duhet të kryhet. Ai personi vetë këtu tha. Tash nuk ka nevojë atë projektin parape me fut ne në buxhetin e vitit 2019, kur është në projekt apo në dinamikë që të përfundohet sivjet. Por, nëse kemi kërkesa për ujë, që po kërkojmë nëpër fshatra, nëpër rajone të ndryshme. Prapë kisha më thënë, mirë kishte me qenë, të konsultojmë Hidroregjionon, tani të kërkojmë të futet në listën kapitale. Për shkak se tani edhe Hidroregjioni e ka projektin e njëjtë edhe ne, edhe po na mbetin paratë, apo po kthehen në suficit. Unë si drejtor i Financave lidhur me procesin e planifikimi të buxhetit për vitin 2019-2021, me vullnet të plotë, po ju them kështu. KAB-i është një proces, nuk është përfundimtarë as diçka, kryetari vetë mundet me marrë vendim edhe ia dërgon Ministrisë së Financave KAB-in. Tani fillon procesi i dëgjimeve publike. Atëherë bashkë edhe Kuvendi edhe ekzekutivi duhet të bashkëpunojnë për projekte. Nëse janë prioritet edhe nëse janë të nevojshme për me realizua për interesin e qytetarëve për interesin e komunës së Prizrenit. Unë vetë po them si drejtor i Drejtorisë së Financave dhe besoj edhe të gjithë drejtorët, jem i

gatshëm ti mbajmë këto takime. Të gjithë drejtorët kanë obligime me mbajt takime me komunitete të ndryshme apo me grupe të fituesve. Zyrat përkatëse kanë obligim me mbajt takime, qoftë me personat me nevoja të veçanta apo me këto shoqëritë kulturore apo me tjerë. Edhe ju si përfaqësues të Kuvendit keni përgjegjësi ndoshta edhe me i mbajt këto takime. Mirë kishte me qenë ta analizojmë mirë këtë KAB-in. Edhe mos të drejtohem vetëm, pse nuk është ky projekt. KAB-i që është propozua me të gjithë drejtorët kanë bërë hulumtim me sektorët e vetë dhe shumica janë propozimet e drejtorëve. Për shkak se ata e dinë në terren çfarë problem kanë, ata e dinë cilët janë prioritetet, se ata janë në ekzekutiv dhe ata i shohin problemet. Tani për të bërë ndryshim, për të bërë plotësim, apo me tërheq projektet, ju jeni kompetent, ju e keni atë përgjegjësinë, ju e miratoni në fund të shtatorit buxhetin. Për atë arsye mirë kishte me qenë ta analizojmë edhe njëherë, pasi që është një proces, edhe nuk është mirë që komuna e Prizrenit me dal që nuk e ka aprovua apo nuk e ka votua KAB-in. Për arsye të ndryshme, për shkak se kemi kohë edhe gati tre muaj me përmirësua këtë çështje. 25% baca Alush, 25% e kam fjalën për vitin 2018. Nëse donë e ndryshon krejt. Po tani qysh kemi me zbatua.

**Kryesuesi:** Siç u tha nga drejtori i Drejtorisë së Financave edhe nga drejtorët, ky dokument është vetëm dokument orientues. Pra, nuk është buxhet i komunës së Prizrenit. Natyrisht shumë çështje këtu nuk janë të përfshira. I dëgjova me vëmendje edhe me kujdes propozimet e anëtarëve të Kuvendit, të cilat unë mendoj duhet të jenë pjesë e buxhetit të komunës, kur të bihet në miratim në shtator. Pra, e gjithë kjo procedurë do të kalojë nëpërmes shqyrtimeve publike. Dhe se unë i inkurajoj të gjithë anëtarët e Kuvendit. Jo vetëm të jenë deklarativisht kështu pjesëmarrës në debatin e buxhetit, po të jenë pjesëmarrës aktiv. Me propozime konkrete, takoni drejtorët, paraqiteni kërkesat e komunitetit të cilat janë të rëndësishme. Se mund të ketë lloj, lloj kërkesa. Por kur flasim për një politikë buxhetor, për buxhetin e komunës së Prizrenit le të jenë ato të përgatitura pak më mirë më herët të planifikuara, që të mos ketë problem pastaj në realizim. Përndryshe këto propozimet që u thanë këtu duhet të përfshihen sepse janë çështje të interesit jetik të qytetarëve edhe juve që i përfaqësoni ata qytetarë në Kuvend. Por si dokument orientues kërkohet që të marrim vendim, që në këtë rrugë të nisim hartimin e procesit të buxhetit. Siç e tha edhe drejtori ky nuk është buxhet. Mund të ndryshoj edhe 100%. Por se duhet të vije me propozim në Kuvend. Atëherë kalojmë në procesin e votimit 33 anëtarë jemi prezent sallë, e hedh në votim këtë Draft Kornizë Afatmesme Buxhetore komunale 2019-2021, kush është për?

Për? – 16.

Kundër? – 9.

Abstenim? – 8.

Atëherë konstatoj se me 16 vota për, 9 kundër dhe abstenim miratohet Draft Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2019 – 2021.

### **Pika e pestë:**

#### **Informatë rreth nivelit të zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal;**

**Kryesuesi:** E ftoj drejtorin e Urbanizmit që ta bëjë një prezantim të planit zhvillimor, si dhe procesin e zbatimit të deritanishëm të këtij plani.

**Fatmir Memaj, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm:** Drejtoria e Urbanizëm kohë më parë e ka formuar një Komision nga të gjithë sektorët dhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm, për të analizuar dhe parë se sa është zbatuar plani zhvillimor komunal, i cili ka qenë i miratuar në vitin 2013, ma afat validiteti nderi në vitin 2025. Më këtë aktivitet ka hartuar këtë vlerësim, pra, në bashkëpunim me anëtarët e grupit punues të drejtorive tjera të Komunës së Prizrenit dhe ekspert profesional të jashtëm, të cilët janë përfshirë në hartimin e raportit dhe që janë anëtarë të Grupit punues me të cilin janë formuar me aktvendimin e drejtorit të DUPH-se.

Në bazë të Ligjit nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor (Ligjit), autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor është përgjegjës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës (HZK). Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) është plan me karakter strategjik multisektoral i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe hapësinor të komunës dhe përfshin periudhën së paku 8 vjeçare. Komuna e Prizrenit këtë plan e ka PZHK-në të miratuar, dhe i njëjti mbetet në fuqi deri në harmonizim me Ligjin e ri nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor.

Gjithashtu, sipas Ligjit, obligim i Komunës është të përgatitë Raportin e monitorimit të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të deklaruara në PZHK, (nenin 10, paragrafi 3 i LPH-se si dhe neni 4, paragrafi 4.4 i UA nr.05/2014 për Përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor).

Komuna është në proces të hartimit të HZK- së. Gjatë analizave për përgatitje të HZK- së, është konstatuar se një pjesë e madhe e projekteve është zbatuar, ndërsa një pjesë tjetër është në zbatim e sipër.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është të jap një pasqyrë për shkallën e zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal për periudhën kohore pesë vjeçare (2013-2018) dhe të ofrojë rekomandimet e duhura të cilat janë të nevojshme gjatë procesit të hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit.

Raporti, do të japë reflektim lidhur me zhvillimin e komunës pas realizimit të aktiviteteve të planifikuara, gjendjen aktuale në hapësirë si dhe të efekteteve të arritura. Analiza e bërë së bashku me rezultatet/ rekomandimet e dhëna në raport janë pikënisje për hartimit të HZK.

Domosdoshmëria e hartimit të raportit të këtillë vjen si kërkesë ligjore, Neni 10, paragrafi 3 i LPH-se si dhe Neni 4, paragrafi 4.4 i UA nr.05/2014 për Përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor.

Është me rëndësi të potencohet se Kuvendi Komunal i Prizrenit ka marrë vendim për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit dhe ky vendim është miratuar nga institucionet kompetente të nivelit qendror. Bazuar në këtë vendim, Komuna e Prizrenit pasi ka kontraktuar një kompani përmes konkursit të projektimit (ashtu siç e parasheh edhe Ligji për Planifikim Hapësinor) ka vazhduar procedurat për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit, në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal të Prizrenit.

Raporti është hartuar nga ekipi punues në përbërje nga stafi i drejtorive sektoriale të komunës dhe eksperteve të jashtëm nga lëmi të ndryshme. Mjetet e zhvilluara gjatë këtij procesi janë bazuar në llojin dhe strukturën e PZHK se Prizrenit, dhe përfshijnë:

- -kornizën për vlerësimin e zbatimit të aktiviteteve të propozuara me plan; dhe
- -vlerësimin e efekteve që kanë rezultuar nga zbatimi i atyre projekteve.

Metodat e aplikuara në përpilimin e Raportit monitorues i zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të deklaruara në Planin Zhvillimor Komunal, janë të llojllojshme duke përfshirë punë individuale, punë grupore, takime konsultimi me akterë relevant nga të cilët janë siguruar informacione të rëndësishme mbi zbatimin e planit etj.

Në PZHK e Prizrenit janë përfshirë një sërë strategji dhe veprime për arritjen e synimeve dhe objektivave për çdo fushë tematike. Veprimet dhe programet janë të definuar në aspektin e kohëzgjatjes kohore,

Vlerësimi i zbatimit të planit është bërë duke analizuar realizimin e aktiviteteve të parapara me plan dhe efekteve të arritura nga zbatimi i tyre në raport me arritjen e synimeve të planit.

Analiza për vlerësimin e zhvillimeve dhe efekteve është bërë për të gjitha zona funksionale të identifikuara me PZHK.

Vizioni sipas PZHK në fuqi është:

“Të zhvillohet Prizreni si një qendër e qëndrueshme kulturore në Kosovë dhe Ballkan, duke promovuar potencialin e tij sa i përket asetëve historike, resurset natyrore dhe ambientale, diversitet social dhe vitalitet ekonomik ”.

## **ANALIZAT E REZULTATET E VLERËSIMIT TË ZBATIMIT TË PLANIT PËR VITET 2013-2018**

Vlerësimi i zbatimit të planit është bërë duke analizuar realizimin e aktiviteteve të parapara me plan dhe efekteve të arritura nga zbatimi i tyre në raport me arritjen e synimeve të planit. Analiza për vlerësimin e zhvillimeve dhe efekteve është bërë për shtatë zona funksionale të identifikuara me PZHK.

Vizioni është pasuruar me një përfshirje të synimeve që kanë një radhitje sipas fushave tematike të: zhvillimit social dhe infrastrukturës sociale, zhvillimit ekonomik, infrastrukturës fizike, transportit dhe shërbimeve publike, shfrytëzimit të tokës, vendbanimeve dhe banimit, mjedisit dhe resurseve natyrore, trashëgimisë kulturore si dhe aspektin e ngritjes së kapaciteteve në planifikim hapësinore. Në kuadër të fushave tematike janë të përfshira një sërë objektivash dhe më këtë raport është vlerësuar zbatueshmëria e objektivave.

Në bazë të vlerësimit të bërë të zbatimit të veprimeve të planit dhe arritjes së synimeve të lartpërmendura, konstatimi i përgjithshëm është se gjatë periudhës 2013-2018 veprimet e PZHK dhe synimet janë zbatuar deri në masë të caktuar dhe ende kemi veprime që janë në zbatim e sipër. Duke u mbështetur në faktin që zhvillimet në Prizren janë bërë në bazë të PZHK, dhe mund të konstatojmë që Komuna e Prizrenit nuk ka nevojë të revidojë PZHK por mund të vazhdojë me hartimin e Hartës Zonale, duke përfshirë rekomandimet nga ky vlerësim. Në vijim është përshkrimi i vlerësimit sipas fushave tematike:

### **A: Ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore**

Të gjitha aktivitetet të cilat janë marr nga MMPH, MKRS, Komuna e Prizrenit, NGO etj. për mbrojtjen, trajtimin dhe intervenimet ne objektet me vlera, hapësirat me vlera të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, te merren masa për intervenimin dhe parandalimin e dëmtimit apo rrënimit të objekteve me vlera, hapësirave ne Qendrën Historike te Prizrenit.

### **B: Qëndrueshmëria ambientale**

Edhe pse janë realizuar disa veprime në zonën e Prevallës (Malet e Sharrit) ende kemi një seri aktivitete për të realizuar. Prandaj mbrojtja e parkut nacional bëhet me ruajtjen e zonës së parkut në pajtim me planin

për Parkun Nacional të Sharrit si dhe me promovimin e turizmit dimëror, skijimit dhe aktiviteteve të ngjitjes në male. Por vlen të theksohet veprimet mbeten nën kompetenca të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Është me rëndësi të theksohet se komuna e Prizrenit brenda këtyre viteve ka realizuar projekte të ndryshme që ndërlidhen me fushën e mjedisit dhe mbrojtjen e saj, por ende ka hapësire për të arritur shkallën e kënaqshme. Përkrahja e projekteve të mjedisit, ngritja e vetëdijes së popullatës, dukuritë që konsiderohen me rrezik mjedisor (termetet, rrëshqitja e dheut, zjarret, prerja e pakontrolluar e drunjëve etj) ende janë sfidë për komunë. Mos zbatimi i këtyre veprimeve ka efekt negativ dhe shpeshherë mund të rezultojë me dëme që kanë rezultate katastrofale.

### **C: Inkuadrimi social, barazia sociale dhe cilësia e lartë jetësore**

Sipas analizave të veprimeve të parapara dhe atyre të realizuara në PZHK, është vërejtur se papunësia ende është sfidë në komunën e Prizrenit.

### **D: Vitaliteti ekonomik**

Zhvillimi ekonomik i Prizrenit bazohet në strategjinë e qendrës së fortë të qytetit duke mbrojtur zonat rurale. Vitaliteti ekonomik dhe zhvillimi i balancuar rural janë dy synimet e PZHK së Prizrenit. Sipas zhvillimit ekonomik vendbanimi qendror është pikë qendrore duke përfshirë turizmin, rekreacionin dhe tregtinë e vendbanimeve rurale. Konstatim i përgjithshëm është që brenda këtyre viteve për të cilën bëhet vlerësimi i PZHK nuk ka pasur ndonjë shpërthim në zhvillimin ekonomik, mirëpo është shpresëdhënëse që ende ka veprime për të zbatuar si, vetëdijesimi i popullatës për kultivimin e tokës bujqësore që do të ndikonte pozitivisht në zhvillim ekonomik por njëkohësisht edhe në ruajtje të tokës bujqësore. Moszbatimi i veprimeve të parashikuara në plan ka ndikim direkt në ngecje të zhvillimit ekonomik që rezulton edhe me shpërngulje të papunësisë.

### **E: Integriteti hapësinor**

Infrastruktura – transporti komunal, trafiku.

Vizioni i Planit Zhvillimor të Komunës së Prizrenit parasheh realizimin e linjave të fuqishme transportuese me pjesët tjera të Kosovës dhe shtetet rrethuese gjë që është e realizuar me autostradën “Ibrahim Rugova”.

Kurse rrugët të cilat lidhin qytetin me fshatrat të gjitha janë të rregulluara sipas planit afatshkurtër dhe afatmesëm të PZHK-së.

Uji, mbeturinat, energjia dhe shërbimet e Telekomunikacionit.

Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit ofron unifikimin dhe kompletimin e sistemit infrastrukturor në shpërndarje të balancuar për tërë Komunën dhe zonat e thella të saja, gjë që është e arritur mjaft e madhe e Komunës. Zona e shërbimit është zgjeruar për të përfshirë të gjitha fshatra.

Popullata, vendbanimet, çështjet sociale, trashëgimia kulturore.

Zhvillimi i vendbanimeve të reja në fshatra qendrore që është paraparë po ashtu me qëllim të arritjes së ambientit të balancuar urban dhe rural në tërë Komunën e Prizrenit.

## V. KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Numri i përgjithshëm i projekteve të përfshira në PZHK e Prizrenit (2013-2018) është 63 në total. Gjate viteve 2013-2018 janë realizuar 90% të këtyre projekteve. Duhet të theksohet që Komuna ka filluar të zbatojë projekte dhe aktivitete të dala nga PZHK Prizren. Por është inkurajuese se një pjesë e projekteve që është në zbatim pas finalizimit do të kenë efektet e tyre.

Pasi që papunësia është sfidë në Komunën e Prizrenit krahas përparësive që popullsia është e re dhe e aftë për punë rekomandim i tjetër i rëndësishëm është përfshirja/zbatimi i veprimeve të ndryshme, që do të ndikojnë në zhvillimin social si edhe implementimi i programit për punësim social. Duhet të jepet prioritet më i madh veprimeve që përshijnë përmirësimin e hapësirave/objekteve publike ku zhvillohen aktivitetet sociale.

Qendra Historike e Qytetit të Prizrenit ka vlerat e trashëgimisë kulturore dhe janë mundësi e mirë për zhvillimin e ardhshëm ekonomik, të bazuar kryesisht në turizëm kulturor. Për këtë arsye gjatë hartimit të hartës zonale apo planeve tjera të përfshihen më tepër veprime, që do të stimulojnë bizneset e vogla. Këto veprime janë katalizatorë që do të stimulojnë zhvillimin ekonomik në këtë zonë. Rekomandim tjetër është: Në bazë të PZHK dhe në përputhje me zonat e zhvillimeve të ardhshme të vendbanimeve, industrisë, agroturizmit, etj. (sinteze e zonave për zhvillim të ardhshëm), duhet marr parasysh kufirin e zonës urbane të PZHU-se, kufirit ndërtimor ekzistues të vendbanimeve në zonën urbane dhe rurale si dhe Planet Rregulluese Urbane dhe të Hollësishme, analizat e gjendjes ekzistuese dhe harmonizimi me Nenin 26 të Ligjit; Rekomandojmë që këto zona të trajtohen me destinime përkatëse, në përputhje me zhvillimin e përcaktuar sipas PZHKP si dhe gjendjes faktike në terren. Rekomandim gjeneral për këtë fushë tematike është që projektet që janë pjesërisht të zbatuara të finalizohen. Konkludim tjetër i rëndësishëm është se brenda këtyre viteve edhe pse janë realizuar një sërë projekte, mund të vërehet se në zonën urbane pak janë trajtuar hapësirat publike apo imazhi dhe pejsazhi i qytetit të Prizrenit. Rekomandohet që të hartohen plane detale, apo vegla tjera që do të kontrollojnë ndërtimet dhe të pengojnë ndërtimet e pakontrolluara. Sa për informimin tuaj këtë raport të vlerësimi të zbatimit edhe normalisht që jemi të obliguar edhe në

Ministrinë e Planifikimit dhe Ambientit dhe natyrisht që është obligim i yni. Po është informatë edhe për ata. Në mënyrë që të kemi një dakordancë edhe me Ministrinë e Planifikimit, që mund të vazhdojmë me hartat zonale. Edhe eventualisht mangësitë ti plotësojmë, mangësitë e planit zhvillimor.

### **Pika e gjashtë:**

#### **Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Planit të punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**

Edhe kjo pikë e rendit të ditës vije si rezultat i obligimit ligjor që rrjedhë nga Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ku kërkohet nga kuvendet komunale që të votohet plani i punës për këtë Këshill. Për më konkretisht tani ftoj nënkryetarin e komunës z. Eshref Memaj që ta prezantoj planin para Kuvendit.

**Eshref Memaj, nënkryetar i Kuvendit:** Në bazë të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë të Punëve të Brendshme nr. 27/2012, si dhe Udhëzimit Administrativ nr. 03/2012, të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal, thuhet që Drejtoria për Emergjencë, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, duhet ta ketë planin e vetë, i cili plan duhet të kaloj përmes Asamblesë komunale. Ky plan është i bazuar në nëntë pika me objektivat, aktivitetet, bartësit e aktivitetëve, rezultatet e pritura, afati kohor për kryerjen e aktivitetëve, në fund e kemi edhe koston buxhetore. Në fakt të gjitha pikat që janë nuk kanë ndonjë kosto buxhetore, i kryejnë institucionet tona të komunës së Prizrenit. Unë në rast se më lejoni do ti kisha lexua të gjitha pikat një nga një. Sigurisht se edhe materialin e keni, nëse nuk e keni materialin do të angazhohet t'ua siguroj materialin. Si objektiva janë, si pikë e parë bashkërendimi i iniciativave të përbashkëta të mekanizmave institucional për zgjedhjen e problemeve të sigurisë në çdo bashkësi. Si aktivitet është hartimi i planit të punës në KKSB, për vitin 2018. Bartësit e aktivitetit janë anëtarët e KKSB-së. Rezultatet e pritura janë të ndermirin rezultate për të zgjidhjen e problemeve për siguri në bashkësi. Periudha është janar-qershor 2018. Nuk ka ndonjë implikim buxhetor, d.m.th. nuk ka kosto.

**Kryesuesi:** A ka pyetje, sa i përket kësaj?

**Alush Shala:** I nderuar nënkryetar, ju jeni me një komision, apo me një bord shumë të veçantë, siç është Këshilli për Siguri në Bashkësi. Për një komunë çfarë është Prizreni me mbi 180.000 banorë, kërkohet më të vërtetë një siguri dhe kërkohet një aktivitet i jashtëzakonshëm nga Ju. Në kuadër të këtij sigurimit, ne kemi diskutua në muajin e kaluar për rastin e vdekjes së dy studentëve, nxënëseve të shkollës së mjekësisë. Realisht kemi pa nëpër portale

gjithçka. Kemi dëgjua e kemi lexua. Po ato janë biseda të portaleve. Ju kisha lut juve, nëse ju keni informata, që nuk prish procesin gjyqësor, e kam fjalën nëse nuk prish hetimet. Mundësisht me na informua deri ku ka shkua dhe a ka diçka të çartë. Kërkoj falje nëse është pyetje jo me vend.

**Eshref Memaj:** KKSB-në e udhëheqë kryetari i komunës. Në mungesë të kryetarit të komunës e udhëheqë nënkryetari. Në mbledhjen e kaluar, policia ka raportua për rastin e këtyre dy nxënësve, që bënë vetëvrasje dhe janë në fazën përfundimtare të hetimeve. Nuk kemi dashtë me hy në hollësi. Janë në bashkëpunim me DKA-në dhe më të gjithë sektorët me të cilat ndërlidhën. Edhe ne nuk kemi insistua më tepër. Vetëm si informacion se thuhet se janë duke punuar dhe janë në fazën e fundit të hetimeve. Sido që të jetë, para policisë ose para prokurorisë ne nuk mund të dalim me informacione. Për arsye të konfencialitetit, prishjes së rrugëve të hetimeve e kështu me radhë.

**Kryesuesi:** Shkojmë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

**Simir Krasniqi:** Grupi parlamentar i PDK-së e mbështet.

**Adem Shabanaj:** Edhe grupi jonë e përshëndet dhe e mbështet Planin e Punës të KKSB-së.

**Haziz Hodaj:** Edhe ne e mbështesim.

**Ilir Baldedaj:** Pata dëshirë me dëgjua nënkryetarin, po partia e vetë se la me fol. Ne e mbështesim.

**Pranverim Berisha:** E mbështet edhe Nisma Socialdemokrate.

**Sencar Karamuço:** Edhe ne e mbështesim.

**Memnuna Ajdini:** Takode koalicioni Vakati podržava.

**Azem Durmiši:** Takode NDS će podržati.

**Kryesuesi:** Atëherë 33 anëtarë jemi prezentë në sallë, dhe herë këtë Draft Plan të punës në votim, kush është për?

Atëherë konstatoj se unanimitisht me 33 vota për, aprovohet Draft Plan i Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

**Pika shtatë:**

**Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave ne Komunën e Prizrenit.**

Për këtë qëllim ftoj ndonjë përfaqësues të Drejtorisë të Shërbimeve Publike, apo të ndonjë kompanie. S'qenka askush. Sido që të jetë Kuvendi kur të thirr mbledhje, kërkon mu raportua, këtu vihet edhe raportohet. Jo, nuk diskutohet kjo, në qoftë se nuk është, vazhdojmë me pikën tjetër.

#### **Pika e tetë:**

**Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale.**

Për këtë qëllim ftoj drejtorin e Financave që ta bënë prezantimin e këtij drafti, i cili ka ardhur si rezultat i shumë takimeve publike. Edhe nga komisioni që është formuar paraprakisht për këtë rregullore.

**Ertan Simitçi, drejtor i Drejtorisë për Financa:** Në bazë të Ligjit për Financa të pushtetit lokal, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa ka kërkuar nga kryetari, që ta merr vendim që të formohet një komision, lidhur me shqyrtimin dhe plotësimin e ndryshimit të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale, i cili është në fuqi. Komisioni është formuar nga të gjithë anëtarët e drejtorive përkatëse dhe është punuar rreth tre muaj për një përkushtim të plot. Draft Rregullorja është publikuar në ueb faqen më 23 maj 2018. Dhe ka qenë mundësia që të gjithë akterët që të shqyrtojnë dhe ta analizojnë rregulloren. Komisioni deri më tani ka mbajtur dy takime apo dy dëgjime publike. Një me përfaqësuesit e OJQ-ve të biznesit dhe një me qytetarët. Kryesia e komisionit ka pasur disa takime direkte edhe me disa përfaqësues të OJQ-ve lidhur me interesat e tyre. Prandaj komisioni i ka përcjellë edhe dy procesverbale bashkë me rregulloren në Kuvend. Në këtë Draft Rregullore ka ndryshime të reja, ka përmirësime, apo harmonizime juridike sipas ligjeve që janë në fuqi. Në disa kapituj janë bërë ndryshime më Rregulloren e cila është në fuqi. Dhe besoj që kjo Draft Rregullore do të jetë edhe më e zbatueshme edhe më e kuptueshme nga të gjithë aktarët. Për shkak se e kemi pas një rregullore më herë që ka pasur edhe probleme edhe të kuptimi edhe të sqarimit apo edhe të zbatimi. Ndryshimet e reja të cilat i keni ju në material, janë të paraqitura me ngjyrë të gjelbër. Ndërsa me të kuqe janë tërhequr plotësisht. Në këtë Draft Rregullore janë paraqitur taksat apo tarifatat të reja, si janë në vijim: Në kapitullin 4 është taksa për reklama për biznese neni 12. Është licenca për auto taksi neni 16. Dhënia e pëlqimit për auto parkingje neni 19. Taksa për bllokimin e rrugës neni 26. Tarifatat dhe ngarkesat për sektorin e energjetikës dhe telekomunikimit, apo për antenat është neni 27. Në kapitullin 9, është taksa për biznese dhe veprimtari afariste, neni 43, 44, 45. Dhe është në tarifatat sipas nenit 62, janë harmonizua me nene të ndryshme sipas kësaj rregullore. Në kapitullin 11, është caktuar tarifa për shfrytëzimin e hapësirave sipas kërkesave që i kam njoftuar edhe disa anëtarë të komitetit që është një

kapitull i cili i paraqet taksat për shfrytëzimin e hapësirave arsimore, apo objektet shkollore. Kjo Draft Rregullore është hapi i parë e cila do të krijoj një mjedis të shëndosh për zhvillimin ekonomik në komunën e Prizrenit. E cila siguron heqjen e barrierave në sektorin e biznesit. Përfshirja e bizneseve në dëgjime publike dhe në vendimmarrje. Përmirësimin e transparencës dhe informimin e biznesit për çdo proces lidhur me përgatitjen e Draft Rregullores. Heqja apo lirimi i taksave për ushtrimin e veprimtarisë, është e dobishme sidomos për rritjen e konkurrencës dhe produktiviteti në sektorin e biznesit. Veçanërisht për biznese të vogla dhe të mesme. Përpos kësaj do të mbetën vetëm dy kategori, ku do të përfshihen biznese të mëdha me tarifa të caktuara ditura, është në kapitullin nëntë. Inkasimi i të hyrave nga taksat, për ushtrimin e veprimtarisë do të mbetet vetëm në dy kategori. Të hyrat të cilat do inkasohen dhe menjëherë për vitin e ardhshëm do të rikthehen projekte direkte për vitet në vijim të cilët janë në përputhshmëri mbi zhvillimin ekonomik të komunës. Pas miratimit të rregullores të gjithë drejtorët dhe sektorët kanë obligim që të verifikojnë gjendjen faktike në terren dhe të bëjnë rregullimi në qasjet e tyre për të zbatuar këtë rregullore. Drejtoria e Financave ka për qëllim që të përmirësoj çështjen e borxheve të mbetura ndaj komunës, nga vitet paraprake të kategorive të ndryshme. Në kohë shumë të shkurtër do të bëhet shqyrtimi dhe verifikimi i borxheve ndaj komunës dhe do të dalim me një rekomandim në favor të dy palëve. Do më thënë edhe në favor të komunës por edhe qytetarëve. Lidhur mbi zbatimin e kësaj rregulloreje do të kërkojmë nga kryetari që të formoj komisionin për shqyrtimi e pesë rregulloreve të tjera. Të cilat do të harmonizohen me këtë rregullore të cilat janë: Rregullorja mbi tatimin në pronë, e cila është në proces në hartim; Rregullore për orarin e punës të bizneseve; Rregullore për Reklama; Rregullore për auto parkingje dhe Rregullore për atu taksi. Synimi i Drejtorisë së Financave për këtë vit është që të përmirësohet infrastruktura juridike që në vitet e ardhshme komuna e Prizrenit do të ketë një menaxhim të rregullt për të hyrat vetanake të komunës. Për këtë arsye me vullnet të plot ju kërkoj mbështetje nga të gjithë përfaqësuesit e Kuvendit që ta aprovoni këtë rregullore. Që të hapet rruga për rritjen e performancës të të hyrave vetanake, që komuna e Prizrenit të ketë një buxhet të vazhdueshëm për vitet e ardhshëm.

**Kryesuesi:** Shkojmë me shefat e grupeve pastaj kalojmë tek anëtarët e Kuvendit.

**Simir Krasniqi:** Grupi parlamentar i PDK-së nuk do ta mbështet këtë Draft Rregullore të pagesave për taksa, sepse edhe në KPF i dhamë disa vërejtje. Do të thotë ky do të jetë qëndrimi jonë.

**Adem Shabanaj:** Unë personalisht kam qenë vetë anëtarë i komisionit për rregullimin e kësaj Draft Rregullore. Dhe se kërkesa të cilën e kam bërë unë

për miratim, për ekspozimin e panove reklamuese të qytetit edhe kategorizimin e tyre prej zonës së parë, të dytë të qytetit. Më sa po e shoh unë e paska marrë parasysh drejtori. Tjetër çka dua me cek është tek kategoria a) shumat që janë për 1.000 €. Tek bankat të rritet të bëhet shuma 5.000 €. Dhe te llotaritë, të kazinot të bëhet një shumë prej 5.000 €. Nga se e dimë se si i fitojnë dhe si i keqpërdorin qytetarët e Kosovës dhe veçanërisht të Prizrenit. Pastaj janë disa kategori, p.sh. veturat e konfiskuara të cilat mbahen në parkingje të policisë. Ka shumë raste kur veturat u konfiskohen, mirëpo dalin të pafajshëm para ligjit. Pastaj ata duhet vetë ti paguajnë ato taksa të parkingut. A ka ndonjë mënyrë se si ti lirojmë ata të pafajshmit të cilët u konfiskohet makina dhe paguajnë gjokat vetë. A ka ndonjë arsyetim për të pagua policia ose komuna e Prizrenit këtë gjë. Megjithatë do ta mbështesim këtë Draft Rregullore.

**Petrit Hoxhaj:** Ne para vetës e kemi një Draft Rregullore ku përcaktohen disa tarifa, taksa dhe gjoba tjera administrative që paguhen për komunën tonë. Ne e kemi analizua këtë edhe me subjektin tonë të LDK-së dhe me grupe tjera të interesit, të cilat ndërlidhën drejtpërdrejt me këtë Draft Rregullore. Mirëpo, do të ishte shumë e favorshme me bizneset nëse do të ishte edhe pakoja e faljeve të borxheve. Kështu që është premtuar, jo veç nga kryetari Haskuka, po nga të gjithë kandidatët tjetër që kanë qenë kandidat për kryetar që do të hiqen të gjitha taksa për bizneset. Po ashtu është premtuar që do të jetë edhe si pako kjo për faljen e borxheve, po nuk e di pse nuk është bërë. Kjo është vërejtje që ne si LDK e parashtrijmë. Mirëpo, janë edhe disa pika tjera. Pika 16, 32, 43 dhe 44. Në pikën 16 është çështja për licencat për taksist. Ne kemi vërejtje që leja për me marrë një taksist është paguar 60 €, ndërsa tash është rritë në 250 €, që i bije 76% rritje këtu. Po ashtu vazhdimi i lejes ka qenë 20 € është bërë 70 €. Edhe për operatorët e autobusëve që e kanë pas 120 € është bërë 500 €. Këto janë disa taksa që sidomos për taksistët që ka ditë ose javë që nuk fitojnë asnjë 20-30 €, dhe të ngarkohen me këto pjesë tjera. Ndërsa tek neni 32 në pikën 6 dhe 7, është kërkesa për lëshimin e certifikatës së pranimit teknik të objektit dhe neni 7. Unë kërkoj që të anulohet këto të dyja, sepse është në kundërshtim me ligjin dhe jo në kompetencë me Drejtorinë e Urbanizmit. Ndërsa tek pika 43 dhe 44 këtu janë bërë dy kategori. Ne si LDK kërkojmë që të behet edhe një kategori tjetër. Sepse vet ligji është që të jetë a,b,c. Kështu që të jetë edhe një pjesë tjetër. Në kategorinë a) është paraparë bankat dhe lotaritë e fatit që mos të jenë nga 1.000 €, po të jenë mbi 5.000 €. Pse! Nëse ne e analizojmë çështjen e bankave, dita, ditës bankat janë duke e shfrytëzuar këtë, dhe janë duke u mbyllë filialet e mëdha. Mirëpo po e shfrytëzojnë rasti dhe po qesin shumë bankomate. Unë kërkoj që 50% ta paguajnë edhe për çdo bankomat, të cilët e venë nëpër qoshet e qytetit. Tjetra është që të bëhet edhe kategoria c) dhe të zbresin këto pjesë për pjesë. Në kategorinë a) këto janë bankat dhe llogaritë e fatit dhe të ngjashme. Do të thotë të gjitha këto që merren me këto dy pika. Ndërsa në kategorinë b) të zbresin gurthyesit, sallonet e dasmave. Mirëpo tek sallonet e dasmave që mos të

paguhet 1.000 € për çdo sallë. Por për një sallë të paguhet varësisht qysh e parashihni 800 €. Mirëpo për sallat e tjera të paguhet 30% i vlerës. Jo për çdo sallë nga 800 €, ose sa është paraparë. Ndërsa në kategorinë c) kisha kërkuar që të jetë vlera 400 €. Mirëpo pika nr. 71 është participimi i nxënësve për regjistrimin para universitar. Ka qenë në 2 € është bërë në 5 €. Dhe tjetra është participimi për sigurimin fizik të nxënësve të vendoset nga këshilli i shkollave. Sepse kjo varët nga numri i nxënësve në çdo shkollë. Pse nxënësit tonë me pagua sigurimin fizik për vetveten, ku Drejtoria e Arsimit është kompetente për me krijua kushte të sigurisë për këta nxënës. Ne si LDK, i kemi paraparë këto kategorizime, që duhet të jetë së bashku me këto edhe falja e borxheve. Nëse nuk do të jetë edhe falja e borxheve, atëherë ne do ta lëmë në vullnetin e lirë që çdokush le ta vendos se çka të votoj.

**Illir Baldedaj:** Ne si grup i AAK-së nuk do ta votojmë këtë kornizë, sepse taksistët janë rast social. Duke marrë parasysh që janë rast social, ju po vazhdoni ti shtypni akoma. Nëse ju duket që keni shumë taksistë, e keni një rregullore është aprovua në këtë asamble komunale, që e cakton saktë numrin, sa taksistë mund të jenë në komunë të Prizrenit. Ndërsa ti qesësh 250 € një kosto që bënë vaki ai në vit nuk i qarkullon 250 €. Kjo është një qeverisje skandaloze e cila është thirr në mbështetje të bizneseve. Po fatkeqësisht aspak nuk ka të bëjë me mbështetje, por është duke i dëmtuar çdo ditë e më shumë. Po i marrim sallonet e dasmave 1.000 €. Kur një dasme sot mesatarisht ne e dimë që po në ato sallone më së paku kushton 4.000 – 5.000 € dhe e lini shumën 1.000 €. Po e merrni p.sh. një ndërmarrje që merret me vlera të ulëta 800 €. Hajde tash e analizoje se në cilin nivel ka ra kjo qeverisje. Besoni që edhe ai që i ka shkrua duhet ti vije turp, se si e trajton biznesin e rëndësishëm siç janë hotelet. Se ne e dimë për këta tre muaj, miliona qarkullojnë. Dhe merremi me një veprimtari të komunikimit të postës dhe telefonisë me 800 €. Andaj, ne jo që nuk do ta mbështesim, po ftoj edhe të gjithë kuvendarët pa dallim të partive politike, mos ta mbështesin, sepse ne jemi për tu shërbyer atyre që na kanë votua, të cilit do subjekt politik. Dhe ne sot secili prej nesh mund ta ketë ndonjë veprimtari të tillë. Dhe besoni që nuk ka me na bo as neve nder.

**Lirije Bytyqi (Nisma Socialdemokrate):** Ne si Nisma Socialdemokrate e mbështesim Draft Rregulloren për tarifa, taksa, ngarkesa dhe gjoba nga shërbimet dhe veprimtarit komunale, sepse është një dokument shumë i rëndësishëm për komunën tonë. Dhe si i tillë duhet të zbatohet drejtë për të gjithë qytetarët të komunës së Prizrenit. E thash drejtë sepse në qeverisjen e kaluar, persona të afërt me pushtetin, i kanë shkelur parimet e rregulloreve duke mos iu përgjigjur pagesave, tarifave dhe ngarkesave ndaj komunës, të parapara me rregullore. Duke i mbetur borxhe të konsiderueshme të komunës, e të cilat borxhe kërkon që sot të ju falen. Gjë që nuk duhet të lejohet kjo. Nisma

Socialdemokrate uron që kjo rregullore të zbatohet në mënyrë më të mirë të mundshme.

**Sencar Karamuço:** Ne do të përkrahim rregulloren, pasi e kemi vlerësuar se është në favor të veprimtarive. Disa kategori janë të shlyera. Të gjithë ne si parti politike nëpër fushata i kemi premtuar që do të hiqen taksat. Kjo është një shans, ndoshta është nisja e parë. Edhe do të kërkojmë edhe prej juve edhe ne do ta votojmë këtë rregullore.

**Memnuna Ajdini:** Koalicija Vakat obzirom da je u interesu građana, smatramo da je u interesu građana. Mi ćemo podržati ovaj nacrt predloga.

**Azem Durmiši:** NDS će podržati, uz naznaku da ako naši zahtevi i naše pravo se ne poštoje za sledeći put ne očekujete naše glasaove. A sada ćemo podržati predlog što je u interesu građana.

**Dafina Billaca:** Sa i përket kësaj Draft Rregullore në faqen 39 vëreja, bizneset të cilët janë të regjistruara në emër të gjinisë për femërore për veprimtari, paguajnë 50% nga tarifat më pak nga tarifat e caktuara me këtë rregullore. Për mendimin tim 50% është tarifë shumë e lartë. Mendoj që grave, nënave, motrave tona duhet tu jepen një mundësi, të paguajnë të 20-30%. Sepse jemi përbuzë nga ju meshkujt. Kërkojmë që njëherë e përgjithmonë femrave tu jepet një përparësi të paktën nëpër biznese. Nuk është përparësi 50%. Një femër që dëshiron ta filloj një biznes të ketë 50%, është e pamjaftueshme. Kërkoj të jetë diku 20-30% për femrat. Në faqen 39 shkruan 50% më pak nga tarifat e caktuar në këtë Rregullore. Ndoshta se kam dëgjua. A super, këtu diçka të mirë paskit bërë. Po folët shumë edhe për atë s'ju kam dëgjua.

**Karanfil Haxhillari (LVV):** Unë desha vetëm të përqendrohem në këtë Draft Rregullore për tarifat të cilat janë hequr plotësisht. Mbi 90% të bizneseve të vogla dhe të mesme lirohen nga tatimet dhe taksat komunale. Kjo është politikë të cilën e kemi premtuar në fushatë, bashkë me kryetarin Mytaher Haskuka. Janë politika të kësaj qeverisje dhe e prek mbi 70% qytetarin e Prizrenit. Pra, lirohen nga taksat komunale dhe tarifat komunale. Dhe këtu të kapemi neve për një sallon dasmash, interesa personale të dikujt. Apo për një pompë benzine, po ashtu interesa personale të dikujt. Dhe të vuajnë 100% tjetër i qytetarit, nga këto taksa komunale, më të vërtetë është e padrejtë ndaj qytetarit. U fol dhe u përfol edhe për taksitë. Vetëm një send ta kemi parasysht. Në Prizren në bazë të rregullores, e rregulluar me ligj, që leje dhe licenca të kenë në bazë të numrit të popullsisë së Prizrenit, maksimum 200 taksi. A dini bre që mbi 700 taksi sot operojnë në Prizren. Dhe në qoftë se ne nuk marrim masa edhe përmes këtyre tarifave. Si do ti ndalim ata. Është shkel me katër këmbë nga qeverisjet e kaluara, rregullorja. Rregullorja a e dini prej kur është prej vitit 2006. Me

nënshkrim të Hanefi Muharremit. Kam hy e kam hulumtua, e kam gjetë, qysh në kohën e kryetarit të atëhershëm. Nuk është ndryshua dhe nuk është përmirësua. Dhe sot dalim kur është interesi i qytetarit, që hiqen 90% të bizneseve të vogla. Dhe në vend se ky Kuvend t'ia zgjatim dorën qytetarit ti ndihmojmë qytetarit në këtë rast, neve bëjmë inate për një apo dy biznese të caktuara, që lidhën me interes tonin. Më të vërtetë është e padrejtë. Prandaj ju lus si kuvendarë të jemi sot me qytetarët, ta mbështesim këtë Draft Rregullore dhe të vazhdojmë më tutje.

**Alush Shala:** Së pari fillimisht protestoj, se kolegja ime Dafina Bllaca po donë me na i shkel të drejtat me ato katër këmbët e atij kolegut tjetër që sa po foli. Pastaj nuk është mirë kolegu paraprakisht na shet përralla këtu, e na mbanë ders. Ose le të shkon me një xhami më mirë, a me ndonjë shoqatë humanitare. Sepse nëse janë 700 taksistë në Prizren. Nuk kanë shkua ata se kanë qejf, po se s'kanë ku me shkua. Dhe ne si organ kompetent dhe të zgjedhurit e popullit, duhet tu krijojmë kushte të punojnë dhe mos ti lejojmë në të zezën, po të punojnë me dokumente. Ta dinë organet kompetente, inspektorati e kush merret me to, ti dinë këndë dhe sa i ka taksistë dhe si quhen. Jam për atë të behën rregulla rigoroze, që mos tu jepet licenca gjithfarë banditit, apo drogagjiu, ose pijanecit. Përndryshe unë nuk jam për me kufizua numrin sepse vetë situata, gjendja ekonomike e Kosovës në tërësi, edhe e Prizrenit në veçanti nuk ka mundësi të punësohen. Prandaj të kemi kujdes dhe nga ajo 500 € që e kanë caktua, duhet të lirohen ata. Aty ku është 20 € vazhdimi ju e keni bo 70 € apo? Do më thënë nuk është rritë 100% po është rritë 500%. Andaj, është mirë të rishikohet. Pastaj është problemi i parkingjeve kolektive. Unë nuk e di qysh është, së paku nuk na kanë sqarua qysh donë me praktikua. Kur dihet se nëse është i lirë, nëse se ka ai numrin e vetë, atëherë unë shkojë ditën e pazarit e parkoj në sabah edhe kur të shkoj në mbrëmje kur ta kryej punën. Do më thënë duhet me pas kujdes. Ata duhet të ngarkohen vetëm për mirëmbajtje. Një komision apo një drejtori përkatëse mundet me u marrë me ta. Çka është edhe diçka tjetër interesant. Ndërprerja e rrugës është bo me 100 € me 50 €, e ku ta di unë. Unë po them sinqerisht nuk kam shumë para, për 100 € ndonjëherë veç për dhunë me bllokua gjysmën e qytetit e paguaj një shumë. Është mirë të merret drejtorja përkatëse, për arsyet e mundshme. Do me ble një traktor dru, e del ta zënë aty rrugën pesë orë. Atëherë nuk ka nevojë me ble një traktor, le të blen më pak edhe le ta shtinë brenda. Do më thënë duhet me pas shumë kujdese. Se për 100 €, se ke biznesmen, apo ke njerëz të pandërgjegjshëm ti quaj ata, që ti jep 100 € edhe ta bllokun rrugën tërë ditën. Nuk është mirë. Duhet me pas arsye pse me zënë rrugën. Kemi edhe këtu te antenat kryesues, edhe kemi bisedua edhe në KPF. Prona publike është 2.000 €, pronë private është 1.000 €. Që do të thotë i detyrojmë ne mi qua te privatët ata operatorë. Unë mendoj që duhet ti ndalojmë aty ku dëmtohet shëndeti i qytetarëve të komunës tonë. Për këtë jemi edhe të zgjedhur. E për çmim le jetë i njëjtit nivel, sepse e njëjta antenë është. Ose po e

lemën pronën private le të vepron ai çfarë donë. E përmendi edhe kolegu nga LDK-ja. I bie mi barazua bizneset, bankat, kazinotë, këto duhet të kenë dallim jo të vogël, po të madh. Andaj, duke e dëgjua edhe njërin nga këshilltarët ligjor të shërbimeve të Drejtorisë të Urbanizmit në KPF, që ai tha ka shkelje dhe njerëz të padijshëm në komisionin që kanë marr pjesë dhe kanë draftua këtë Draft Rregullore. Andaj mirë që drejtori i Financave, që në komision të zgjidhen njerëz profesionist që e njohin edhe ligjin. Edhe muajin tjetër nëse i përmirësoni këto që i keni bo. Besoj që edhe pse shefi i grupit parlamentar i PDK-së, dha një mendim. Mendoj që nëse i boni këto përmirësime, PDK-ja dega në Prizren dhe këshilltarët e sajë këtu në asamble, nuk janë asnjë herë kundër që del diçka mirë për komunitetin e komunës sonë.

**Sinan Alijaj (Nisma Socialdemokrate):** Z. Kryesues unë desha vetëm një pyetje më qenë se Drejtori për Infrastrukturë dhe Urbanizëm nuk është këtu. Se kur pata diçka me shtua faktikisht ke pauza prej gjysmë ore. Nuk e di a më lejohet diçka me shtua në kontest të temës së kaluar, apo me lënë për herën tjetër.

**Kryesuesi:** Jo është për këtë pikë të rendit të ditës, vetëm për rregulloren.

**Alijaj:** Oke më falë, mirë.

**Shukri Quni:** Te neni 22, taksa për gjurmimin e rrugës, ose prerjen e asfaltit. Kjo është pak 20 €, kjo duhet me qenë më shumë. Sidomos Drejtorja e Inspektoratit, këtë duhet me tepër në konsideratë. Sepse rrugët prehen pa kurrfarë plani kështu ta them. E prej në krye në veti secili që e shfrytëzon atë, për kanalizim a për ujë. Kështu që këtu kish kërkua një taks 500 €, sepse kurrë nuk e kthejnë në atë gjendje qysh ka qenë, rruga. P.sh. po flas për rrugën kah unë vij andej. Është gjynah i madh kur pritet asfalti 12-13 cm sa është 14 cm, dhe nuk e kthen në gjendjen e mëparshme si ka qenë. Këtë taksë me rritë sa më tepër, që e kthen nëse ka komuna, qysh ka qenë, ose ai vetë e kthen. E jo me pre edhe me lënë ashtu si të ia merr mendja atij. Edhe këto antenat private dhe publike, s'po mundem mi kuptua. Çka është kjo prona publike, kush i merr ato pare në pronën publike p.sh. I merr komuna apo kush i merr ato? Privat po e di që i marr ai që e në oborr, apo diku! Po kjo publike. Janë disa antena nëpër male, nuk janë ato në prona private. A i kanë kthye ndoshta. A i merr pylltaria nuk e di, është mirë këtë me ditë. E kemi në kodër në Nashec e kemi një antenë, a është e Ipkos, a e kujt është nuk e di. Një është andej kah Hazizi, në katund të Hazizit. Me ditë kush pi merr këto , a pi merr Hazizi, a unë a!

**Kryesuesi:** Fillimisht e përshëndes Drejtorin e Financave dhe Komisionin që është marrë me hartimin e kësaj Rregullore. Edhe sikurse shumë anëtarë të Kuvendit edhe unë i ndaj shumë mendime të njëjta për këto

propozime që janë bërë. Këto kanë qenë sfida edhe gjatë mandatit të kaluar që kemi pas. Së bashku edhe në atë kohë, edhe me kryesuesin e kaluar. Jemi munduar që me bo një barazim sa i përket ngarkesës së drejtë të këtyre bizneseve. Për atë kohë ka qenë mendoj vendim më i mirë. Kurse tashmë kemi një periudhë kohore që gjërat kanë ndryshuar dhe natyrisht Rregullorja për taksat, tarifat duhet ti adaptohet rrethanave të reja. Po filloj me disa propozime, në qoftë se është e mundshme drejtori me më përcjellë këtu. Po pse jo edhe shërbimi i Kuvendit. Kërkesa që bankat, agjencitë financiare dhe shoqëritë aksionare një. Dhe dy, lotaritë kazinot dhe lojërat e fatit, të jenë në një kategori me kompani të tjera, është kërkesë e drejtë. Edhe unë po pajtohem që ky çmimi për 1.000 € është pak për këto kategori. Propozoj që të bëhet një kategori në qoftë se nuk e prish strukturën e rregullores, të bëhet një kategori e veçantë. Pra, për bankat dhe për lotaritë të jetë një kategori e veçantë. Dhe shuma mos të jetë 1.000 €. 1.000 € është shumë pak. 1.000 € këto vjetore, këto i nxjerrin brenda orës. E mos të flasim për pasojat këto institucione që i kanë këtu në shoqëri. Tash ne si qytetarë të këtij vendi kur vjen puna kërkohet përpikëri nga bankat për mi pagua ratat apo kreditë. Edhe ndërkohë që edhe me pas një tolerancë të tillë, a i paguajnë a si paguajnë do kur vjen puna e ngarkesave. Gjithashtu për lotaritë pak është. Mendoj që lotaritë të jenë në një kategori me veprimtarit, qendrat tregtare, ose spitalet private, nuk është në rregull. Pra, i propozoj Kuvendit, ashtu siç thanë edhe parafolësit, që të bëhet një kategori e re ku bankat, financat dhe lotaritë të ngarkohen me çmimin 2.500 €, në fund të fundit. Nëse 5.000 € është shumë, propozoj për 2.500 €. Pastaj çështja tjetër, po dua mundal te bankat këtu. Bankomatët që e ngriti kolegu nga LDK-ja. Banka tashmë ka avancuar në sistemin e kryerjes së shërbimeve. Vendosja e bankomatëve nënkupton mbylljen e vendeve të punës. Pra, e kanë rritë efikasitetin e inkasimit e fitimit. Kurse këndej kanë shtua numrin e papunësisë. E qysh tash ai bankomat, duke e ditë se çfarë pasoja ka në ekonomin lokale të Prizrenit, e ne mos me ngarkua banokomatin. Prandaj lus drejtorin, që në qoftë se është e mundshme, të përfshihet në ndonjë kategori edhe bankomati. Sa çmimi, mund ta bësh fund të fundit propozimin këtu, je më i njoftuar për këtë. Po bankomatët mendoj që duhet të përfshihen. Pastaj çështja e antenave e cila është ngritë prej përfaqësuesve të PDK-së, pra antenat e telekomunikacionit. Qëndron, edhe unë pajtohem plotësisht. Pra, pse për vendet publike ku vendoset antena është taksa prej 2.000 €, që në këtë rast po ia kalon edhe bankave. Bankat është 1.000 €. Për antenat është 2.000 €. Kurse në ato hapësira publike është 1.000 €. Pra, propozoj të nivelizohet kjo të bëhet 1.000 € - 1.000 €. Nëse pajtohet edhe Kuvendit. Mirë atëherë po e vendosim pra po bëjmë 2.000 – 2.000 € ose 1.000 – 1.000 €. Unë mendoj që duhet të ketë nivelizim kjo. Dakord 2.000 €. A po i shënoni këto propozime. Po ashtu propozimi në faqen 22 neni 40 pika 15 kërkesa për certifikatë për pranimin teknik të objektit. Kjo është ngritë në KPF nga zyrtari ligjor i Drejtorisë së Urbanizmit, ku thotë se kjo kërkesë nuk është në përputhshmëri me ligjin. Po mirë ka bërë komisioni që e ka shti në kllapa ka

thënë që të diskutohet edhe njëherë. Më qenë se tashmë e vërtetuar edhe me drejtorin e Financave, që kjo taks nuk është në rregull. Propozoj që të hiqet menjëherë nga ky draft. Çështja e taksës së prerjes së rrugës, po pajtohem plotësisht me z. Qunin. 20 € është tepër pak. Propozoj që kjo të ngritet ose 40 € të bëhet dyfishi, ose 50 € ta lëmë shumën fikse. Ke ti shkatërrim total të infrastrukturës rrugës, si rezultat i kërkesave banale. Ka rrugë të reja që shtrohen, e që janë shtrua edhe më herët. Edhe që menjëherë pas tre dite, ti ke pas asfalt të prerë aty. Tash ne nuk jemi kundër ndërhyrjeve, kemi nevoja të qytetarëve primare. Por sidoqoftë mbrojtja e infrastrukturës publike është detyrë e këtij institucioni në minimum. Atëherë në se pajtoheni propozimi im që kjo taks të jetë 50 €. Sido që të jetë, ky Kuvend e ka të drejtën me modelua. Unë po mundohem këtu me i modifikua qëndrimet e grupeve. Ideja e krejt kësaj është që të rritet ai çmim. Edhe me mbrojt infrastrukturën e Kuvendit. Pastaj mundesh me ardhur këtu edhe me na dhënë se a jemi në rregull me këto propozime dhe kalojmë në votim. Kjo çështja e ngarkesës, nëse mundet pastaj drejtori i Arsimit që u parashtrua, që shkollat të paguajnë çështjen e sigurimit. Mirë, atëherë në qoftë se është e mundur kjo me u heq. Kjo shkakton telashe në mbarëvajtjen e sigurisë. Atëherë më qëllim për me kurse një pjesë të caktuar të hollave. E këndeje me vu në pikëpyetje rrezikun në shkolla. Duke pasur parasysh problemet të përditshme që janë. E kjo është e evidente, është problem shoqëror. Më të vërtetë nuk ia vlen. Atëherë me arsyetimin e drejtorit në qoftë se pajtoheni. Në qoftë se është e rëndësishme që për çështje të sigurisë të lejmë këtë. Atëherë po e lejmë. Në qoftë se jo, ka forma të tjera. Atëherë mund të na propozoj edhe drejtori. Këto ishin propozimet e mia.

**Sinan Slijaj:** Para se me vendos pjesën e gjobës. Sa kohë tash i duhet qytetarit me pritë për me bo intervenim, për mos me prek aty pjesën e infrastrukturës shoqërore. Sa kohë i duhet, apo ku duhet mu drejtua që me mund thjesht ai me gjet zgjidhjen për kyçje ujit ose çka do qoftë ajo.

**Kryesuesi:** Po varët është te Shërbimet Publike. Po nëse është brenda qendrës historike. Nëse nevojitet leja e Këshillit për trashëgimi kulturore, Qendrës rajonale për trashëgimi kulturore. Tash varët prej zonës. Po kjo është çështje e drejtorit të ekzekutivit pastaj këta lëshojnë leje pëlqim. Neve na takon këtu, tash të marrim vendim për këto ngarkesa që i bëjmë, sa i përket taksave edhe gjobave eventualisht.

**Sultan Badallaj:** Mendoj se lidhur me tarifën për metër gjatësi është gabim. Mundesh me pas metër gjatësi, po pesë metër gjerë. Shumë mirë ka qenë për metër kaltërorë ajo. Edhe dihet sqarimet shkruajnë në atë Draft Rregulloren të tarifave që punëkryesi ka për obligim deri në shtresën e zhavorrit. Me punën e asfaltit merret vetë institucioni, komuna. Po duhet të jetë, është mirë për metër katrorë jo për metër gjatësi. Sa dëmtohet aq edhe të paguhet edhe të riparohet.

**Ilir Baldedaj:** Vallahi koka mirë me të dëgjua kur je kaq konstruktiv. Se sa herë ke dal në këtë foltore veç ke shajt. Sot ke qenë në nivel të duhur. Unë e kisha një propozim për të gjithë grupet parlamentare. Përderisa kërkohen gjitha këto ndryshime. Të shtyhet për seancën e radhës, të bëhen plotësim-ndryshimet dhe të vij edhe njëherë në votim. Këto prej të gjitha grupeve që u kërkuan. Pastaj shohim në seancën e radhës. Do të thotë është e pamundur edhe për shërbimin edhe për drejtorin të gjitha këto mi kanalizua në një dokument që është i kryer.

**Kryesuesi:** Unë besoj që këto propozime prekën vetëm katër pesë kode të caktuara. Tash folëm vetëm për çmimet. Është e drejta e Kuvendit këtu me vendos në fund të fundit propozimet. Po duke pas parasysh që edhe përvojën e juaj, takimet që i keni edhe me qytetarë edhe me biznese. Unë po mendoj se fjalën e fundit duhet me dhënë Kuvendi. Dhe se nuk besoj që e komplikua punën aq shumë. Përpos që dy kategori të caktuara, i ngritëm. E nvelizuam punën e antenave, e hoqëm atë taksën që bije në kundërshtim me ligjin. Propozimin e Urbanizmit, sqarime na jep tash Drejtoria për punën e taksës në shkolla. Shënimet i mori drejtori, krejt çka është që diskutimin që e bëmë, nëse pajtoheni me votua, së bashku me këto propozimet edhe në fund me marrë vendimin.

**Adem Shabanaj:** Për antenat drejtor. Tash nëse antena vendoset në pronë të komunës, ajo e ka taksën 2.000 €, është krejt në rregull. Po nëse barazohen ato me ato në pronë private, aty 2.000 €. Po mirë ai aty a ke me pagua edhe qira. Edhe propozimi i Sulltanit ke i arsyeshëm, për prerjen e asfaltit. Sepse metër gjatësi ka me shkua gjerësi sa të donë ai pesë metër me një metër. Atëherë duhet me pagua për një metër gjatësi, sepse po ceket për metër gjatësi. E nëse ceket për metër kaltërorë atëherë bëhet gjashtë metër katrorë. Edhe kjo duhet qëndrua.

**Haziz Hodaj:** Ju thatë që u dhanë tri katër vërejtje, po ato vërejtjet e juaja veç që i përmendet. Vërejtjet që u dhanë prej anëtarëve tjerë të Kuvendit, nuk di a hynë në aprovim të këtyre kërkesave. Kështu që unë po dua me u pajtua kësaj radhe me Ilirin Baldedajn. Që sinqerisht me rishikua edhe njëherë këtë rregullore dhe me kompletua. Tek e fundit pse jo, se u tha këtu prej Karanfilit 90% e bizneseve të vogla edhe të mesme kanë përfitua. Po le të fitojnë 100% e bizneseve të vogla edhe të mesme, se për atë punë ne jemi këtu. Jo mi diskriminua, tash as 10%, as 1% sepse për atë punë jemi këtu mi rregullua, që të gjithë me përfitua prej kësaj rregullore të re. Kështu që të rishikohet edhe njëherë. Le të hynë në këtë rregullore edhe falje e borxheve për kategori të caktuara. Sepse këto janë premtime elektorale. Këto janë edhe rregullore që janë aprovua, janë model edhe në komuna tjera kanë ndodh. Kështu që le të futet

edhe falja e borxheve. Dhe mandej e kompletojmë një draft tamam që do ta ketë pëlqimin apo aprovimin e gjithë grupeve.

**Ertan Simitçi:** Sqaroi se procedura për faljen e borxheve është procedurë tjetër, që duhet me marrë një vendim tjetër Kuvendi, jo me këtë rregullore. Caktohen kushtet, caktohen kriteret për faljen e borxheve. Apo për menaxhimin për faljen e borxheve çka me bo. Kjo është taksa, kjo është tarifa, rregullore, ky është ligji për të hyrat e komunës. Nëse jeni për me pas Komuna e Prizrenit një menaxhim më të mirë për të hyrat vetanake. Siç e kanë aprovua edhe komunat tjera. Edhe tash kanë menaxhim më të mirë se komuna e Prizrenit. Hajdeni urdhëroni, e jo me akuzua drejtorin e Financave ose komisionin për një çështje tjetër. Nuk është mirë, nuk është korrekte, nuk është etike. Procedura e faljeve të borxheve është diçka tjetër. Edhe ju thash në fillim, s'po di pse a s'po ju kujtohet apo jo. Ju thash që do të kërkoj prej kryetarit që ti marrim masat lidhur me menaxhimin e borxheve. Drejtorja e Financave ka për qëllim që të përmirësoj çështjen e borxheve, të mbetura ndaj komunës nga vitet paraprake të kategorive të ndryshme.

**Kryesuesi:** Pika e rendit të ditës është rregullorja për taksa, tarifa dhe ngarkesa. Kjo çështja e faljes borxheve është komplet procedurë tjetër, është komplet vendim tjetër. Mos ti ngarkojmë këto gjëra. Natyrisht edhe kjo do të bëhet kur ti vije koha.

**Ertan Simitçi:** Le të merren një rekomandim prej Kuvendit, që ti jepet përgjegjësia kryetarit dhe ekzekutivit, që menjëherë ti fillojnë procedurat për faljen e borxheve. Për auto taksi që ishte pyetja, është e vërtetë që i kemi rritur taksat. Arsyeja është që numri i taksistëve është shumë i madhe. Rregullorja është prej vitit 2006. Taksat që janë të reja, nuk do të fillojmë me zbatua derisa të bëjmë rregulloren e re. Ata që janë në zbatim që kanë infrastrukturën juridike, që mundet drejtorja përkatëse me zbatua, ato zbatohen. Po ato që janë të reja, po kjo është baza, kjo është kushtetuta. Po tani i bëjmë ato ligje, ato rregullore tjera që për me zbatua edhe me pas inkasim të mirë. Për antenat që ishte pyetja jam dakord, sepse edhe në komisionin kemi qenë dakord që 2.000 € të jetë për të gjitha antenat, qoftë në pronën private, qoftë në pronën publike. Pastaj Drejtorja e Shërbimeve Publike, na ka pru një propozim tjetër që të ndahet. Po nëse Kuvendi e aprovon që të jetë 2.000 €, nuk ka problem. Z. Petrit pat një propozim për taksat komunale për të bërë kategorizimin për ushtrimin e veprimtarisë. Ju kam thënë edhe nëpër dëgjime publike. Ne e propozojmë, por ju jeni ata që e caktoni. Por unë ju thash që zbatimi i kësaj takse, nëse janë shumë kategori, besoni se kemi shumë problem tani në terren. Edhe me verifikua edhe për me zbatua. Nëse vendoset që të jenë tre kategori, unë si drejtor i Financave e aprovoj, nuk ka problem. E bëjmë përmirësimin edhe aprovojme siç propozoni ju. Për bankomantet nuk kemi të drejtë me rritë këtë

taks, për shkak se ligji i financave i pushtetit lokal e ka caktua taksën. Është vetëm për veprimtari. A për bankomatet kur të vije rregullorja për tatimin mbi pronë në proces, në muajin gusht apo në shtator, aty tani e lëmë si kategori që me rrit atë. Do më thënë me këtë rregullore nuk kemi të drejtë, sepse nuk është veprimtari. Ose nëse janë bankomatet në pronën publike, apo komunale, drejtoria përkatëse Urbanizmi, ka obligim, apo është kompetent, me shkua edhe me bo marrëveshje me bankën edhe me fut në sistem që ata të paguajnë të hyrat, apo si shfrytëzim i pronave. Falja e borxheve Petrit, ju thash që është në procedurë. Edhe në dëgjime publike e dinë të gjithë, ata që kanë marrë pjesë. Ju kam thënë është procedurë tjetër ligjore. Edhe me kryetarin jemi dakord që të formohet një komision edhe prej ekzekutivit po edhe prej Kuvendit, që ta shqyrtojnë. Qysh me pru unë procedurën për faljen e borxheve kur s'kemi asnjë analizë. Ende nuk i kemi verifikua problemet në terren. Taksat komunale për biznese po dojmë mi lirua kënde, në anën tjetër hajde po falim. Po çka me bo kur se kam unë ende analizën të rregullt. Unë po them si drejtor i Financave, deri në fund të vitit e kam obligim edhe përgjegjësi politike, me pru në kuvend një propozim për faljen e borxheve. Edhe do të vije në kohë sa më të shpejtë. Për nenin 21 dhe 22 për metër katror dhe metër gjatësi. Drejtoria për Shërbime Publike e ka propozua vetë, edhe e ka vetë ndryshimin. Arsyetimin unë vetë nuk po e di. Nëse dakordohemi që të jetë shuma më e madhe, le të merr Kuvendi si propozim. Tani ne me Shërbimet Publike vetëm e rregullojmë a është me metër katrorë, a është me metër gjatësi. Shumën ju e caktoni, 10, 20 apo 30 €. Ajo për dy minuta rregullohet. Nuk është mirë ne për një metër katror me shty seancën. Prapë në seancën tjetër do ta kemi të njëjtën temë. Për auto parkingjet do të jetë rregullore e re. Pranimi teknik, kemi biseduar edhe me juristin e Urbanizmit, që me ligj qenka në kompetencën e Urbanizmit. Që tha një kuvendarë për me shty rendin e ditës. Komisioni i ka mbajt dy dëgjime publike. Edhe të gjithë jeni njoftuar edhe përmes mediave edhe përmes emailave. Draft Rregullorja ka qenë prej 23 maj deri më sot në ueb sajt. Mirë kishte me qenë që të ishte analizuar, një muaj kemi pas kohë. Edhe me i dërguar komisionit, apo kryesuesit apo Drejtorisë së Financave, shqetësimet për këto ndryshime të vogla. Disa kuvendar kanë marrë pjesë, edhe e kanë pa vetë ata qysh ka shkua procedura e dëgjimeve publike. Lidhur me sigurimin e nxënësve, besoj që drejtori e jep një sqarim më konkret, se nuk kam unë informatë. Për sallonin e dasmave. Ndoshta është bërë një gabim i vogël. Për shkak se kemi pasur prej OJQ-ve të ndryshme ankesa. Në propozimin e parë ka qenë 1.000 €. Tani ne e kemi ndërrua në draftin e dytë e kemi qit në kategorinë e dytë 800 €. Po sigurisht ndoshta mos ka qenë ndonjë gabim teknik te ju. Se te unë në draftin e fundit është 800 € salloni i dasmave. Që tha Petriti për me bo për një sallë. Oke nëse vendosni ju ne e pranojmë atë s'është problem. Prapë po them për qetë Draft Rregullore gati katër muaj kemi punua komisioni. Është në interesin e komunës së Prizrenit dhe besoni që shumë komuna qetë procedurë e kanë kalua. Edhe besoj që duhet të aprovohet pasi që është në interesin e komunës.

**Skender Susuri:** Ti e tha atë që pata me thënë. Propozimi është që mu fshi ajo tarifë 5 €. Sepse ajo bije ndesh edhe me legjislacione, janë shkolla të detyrueshme. Dhe shtrohet pyetja ai që si ka. Plus kemi një premtim ne që sigurimin do të gjejmë mënyra me pagua nga mjetet e komunës. Kjo është politikë edhe e partive politike edhe e kryetarit. Kështu që është mirë me heq, s’ di kush e ka shti këtë. Kjo është llapsus, nuk bënë kjo me ndodh. Unë kesh duke i lypur përkrahje politike kryetarit të partisë atje, juve, kryetarit tonë. Ama kjo duhet mu heq. Komuna e dinë qysh i gjënë. Po para, fëmijëve absolut jo.

**Shukri Quni:** Unë nuk punoj në shkollë të mesme. Mirëpo në shkolla nuk kemi sigurim. Në shkollë të mesme ku gjashtë fëmijë të mi e kanë krye, një euro në vit ka qenë me dhënë. Kurr gjë s’ më ka gjet. Vetëm ta keni me dije që sigurimi drejtor, në shkollë të mesme nevojitet. Ne nuk i kemi ende do ligje që mundemi me qit një rebel jashtë. Profesorët kanë shkuar rrotull me lloj, lloj rrugaçi me qit prej oborrit të shkollës. Unë kisha thënë që pasi kam pagua për gjashtë fëmijë të mi. Ka tolerime aty në klasë, ata që si kanë kushtet i tolerojnë. Unë thash nuk punoj në asnjë shkollë. S’kam kurrfarë interesi. Veç sigurimin nuk e kisha heq. Po s’ mund e paguani ju, vetëm kot jeni ka flitni. Se s’ bëhet nami.

**Ilir Baldedaj:** Nëse nuk shkon në rishqyrtim ky Draft i Rregullores AAK-ja nuk e mbështetë këtë pikë.

**Alush Shala:** Unë edhe njëherë po kërkoj, se sot të gjitha subjektet politike ishin korrekte. Dhe kërkesat e tyre më janë dukur shumë normale, përjashto të Dafinës dhe të këtij koleges tjetër. Kjo me na i shkel të drejtat ai me na shit pallavra. E kisha lut drejtorin, pasi që është kompetencë dhe përgjegjësi e tij për me bo draft rregullore ashtu qysh i ka hije këtij Kuvendi komunal, çfarë është edhe Prizreni. Le të merret me njerëz specialist. Që po e pranon drejtori i Arsimit që ka qenë diku një përfaqësues i tij, që s’ka pas lidhje me atë temë. E ka pas Drejtoria e Urbanizmit e ka qua inxhinier, jo njërin që i dinë ligje. Prandaj merru me njerëz profesionist. Dhe ne jemi këtu, ne jemi për të mirën e qytetarit.

**Karanfil Haxhillari:** Alush në qoftë se ty të duken pallavra. Kjo është një gjest i ulët qysh je përfaqësues i popullit. Edhe mua më ka zgjedh dikush këtu Alush. E në qoftë se ty të duken pallavra, atëherë është problem i yt. Edhe të lutëm tjera here të jesh më i kujdesshëm në qasje ndaj kolegëve kuvendarë.

**Alush Shala:** Unë nëse thash pallavra, pak po e përmirësoj. Me atë që e kanë shkrua deri tash 90% të bizneseve të mirëfilltë, janë shantazhua. Ju ka dhënë mundësia e 30% apo bizneseve jo korrekt e matrapazëve, të këtë mundësi

ata. Andaj, ne nëse jemi përfaqësues të zgjedhur, ne duhet të punojmë. Kur është në pyetje biznesi, ta mbrojmë edhe biznesin. Kur është në pyetje biznesi jo i rregullte, ne s'kemi nevojë mi mbrojt ata. Edhe kolegu im e dinë që unë as nuk e fyej askënd, po realisht s' duhet me na mbajte këtu përralla.

**Kryesuesi:** Edhe njëherë një rekapitullim të shkurtë. Është kjo draft rregullore që ju ka ardhur me kohë materiali. Kemi pasur rastin ta dëgjojmë. Pastaj vërejtjet e anëtarëve që u dhanë këtu, po i përfshi, më konkretisht ajo i bije që: Bankat dhe lojërat e fatit të taksohen me 2.500 €. Nënë dy, taksa për rrugë të bëhet për metër katrorë, çmimi 50 €. Edhe ajo kategoria ku është 10 € të bëhet 20 €. Nënë tre, sigurimi privat kur është paraparë taksa që të ngarkohen, të hiqet. Nën katër, në nenin 33 pika 6 puna e inspektoratit taksa që u dha vërejtje nga drejtorja, po, urdhëro!

**Islam Thaçi, drejtor i Drejtorisë për Inspektorate:** Për këtë rregullore ka qenë edhe dëgjimi publik. A mundet drejtori me na thënë sa ka pas të pranishëm në dëgjimin publik? Me sa di unë asnjë prej kuvendarëve aty s'ka qenë, përveç kuvendarëve që janë të përfshirë si anëtarë të komisionit. E dyta për mos me hedh poshtë, janë shërbyesit civil, që ne i kemi emërua nëpër drejtori. Që rasti konkret në fjalë, unë e kam emëruar juristin. Edhe këtu kur po i adresoni këto çështje me gjithë respektin. Ka gabime të vogla p.sh. te rasti i z. Alush Shala për taksë, është shërbim i drejtorit të Shërbimeve Publike. Inspektorati është përgjegjës veç për gjobat, pak sqarim. Prej ngutisë që çdo njëri prej neve me reagua po bënë gabime. Po megjithatë unë se kisha qua në rivotim. A ekziston mundësia tjetër që në këtë formë mund të kalon. Me gjithë këto vërejtje që unë po i quaj, shumë të vogla janë. Pse të shtyhet kur asnjë asamblist nuk ka marr pjesë në debate publike.

**Simir Krasniqi:** Në emër të grupit të PDK-së kërkoi nga drejtori, që në seancën e radhës të sillet drafti me ndryshime, me të gjitha ato propozimet që ishin këtu dhe ne do ta mbështesim. Tash mos të diskutojmë se gjithçka po del prej binarëve.

**Alush Shala:** Realisht, z. drejtor i Inspektoratit, kam pas respekt edhe vazhdoj ta ruaj, fal veprimtarisë tuaj. Nuk po të jap as kompliment as kurrjë. Bile mua më vjen mirë që ne në KPF, jem mundua pak a shumë mi shtjellua disa probleme në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës. Në asnjë rast nuk keni qenë në kontest as ju as drejtorja e juaj. Po ju them çka është diskutua në KPF. Po realisht Drejtorja e Urbanizmit e ka qua një person që s'ka qenë jurist dhe që s'ka marrë vesh fare në punën e vetë. Edhe ne nëse i pranojmë dokumentet, e pranoj edhe Drejtori i Arsimit. Nëse merremi dhe i votojmë dokumentet nga ata që nuk i dinë, jo pse janë të mira. Se dinë, po i kanë caktua si shok, si mik. Mendoj që nuk i shërben komunës. Ti mirë ke bo që ke qua jurist. Shkurt hesapi

qiti në letër drejtor këto vërejtjet tona, të gjithë kuvendarëve dhe unë besoj që do të kalon ndoshta si asnjëherë më me shumë vota.

**Kryesuesi:** Mirë atëherë po e përfundojmë debatin. Çështja është kështu, ju e keni dhënë propozimin veç mi qit në letër. Po flasim për një muaj ditë, me shty për çështjet për tre sekonda që mundemi mi lexua. Edhe një muaj ditë është aprovimi pastaj. Vetëm çka po e komplikojmë një proces pa nevojë. Unë po propozoj që ta hedhim në votim dhe ta lexojmë edhe njëherë përmbledhjet këtu, ku po ndërhyjnë Kuvendi me këto propozime që i kemi nga të gjitha grupet. Edhe pastaj ato në procesverbal të përfshihen, drejtori është duke marrë shënime. Përgatitet drafti shkon në vlerësim të ligjshmërisë në MAPL. Dhe MAPL-ja presim të kthen përgjigje edhe vazhdojmë tutje. Po besoj që qaty po jemi, nuk ka ndonjë devijim të madh sa që ne me shty këtë punë. Prandaj edhe njëherë propozimi i parë ishte që: Bankat dhe këto institucionet financiare tjera së bashku me lojërat e fatit nga 1.000 të rritet në 2.500 €. Nën dy, taksa për prerjen e rrugës të bëhet me metër katrorë, jo siç u tha në gjatësi apo gjëra të tjera dhe të vendoset 50 €. Kurse për pjesën e dytë 20 €. Nën tre, sigurimi privat që ishte kërkesë edhe e drejtorisë edhe e anëtarëve të Kuvendit, ku është vendos taksa, kjo të hiqet. Nën katër, neni 32 pika 6 çështja e Inspektoratit që ke taksa, me vërejtjen e zyrtarit ligjor, kjo të hiqet. Të mbetet te urbanizmi. Dhe nën pesë, të bëhet nivelizimi i çmimit të antenave, 2.000 € edhe ato në pronë publike edhe ato në pronë private. Kaq është, i përmenda të gjitha.

**Illir Baldedaj:** Unë e propozova çështjen e taksistëve, ti se përmende, çfarë ndryshimi. Bjereni të plotësuar, nëse ka nevojë drejtor ke të drejtën e thirr seancë të jashtëzakonshme kryetari i komunës, veç për këtë pikë të rendit të ditës. Dhe vimë në seancë me dokument. Nuk votohet ad hok. Po taksistet janë rast social drejtor ja ke qitë 250 €.

**Ertan Simitçi:** Ju tregova po ndoshta s'keni dëgjua. Për taksistet leja ka 60 €, e kemi bërë 250 €. Vazhdimi i lejes, licencën e kemi rritë e kemi bo një taks fikse. Leja ka qenë 20 € është bërë 70 €. Arsytimi është kështu, që çdo person, kemi edhe zyrtarë të komunës, kemi edhe arsimtarë, që nuk e kanë punë primare, po e kanë punë sekondare. Edhe i bëjnë konkurrent jo të mirë atyre taksistëve që e kanë punë primare, që kanë firma që kanë obligime. Tash kemi bo takime edhe me taksistë në dëgjime publike. Edhe kemi marrë vendim që ta bëjmë rregulloren. Me rregullore do të caktohen kushtet, menaxhimi i taksistëve, zonat kriteret krejt. Ju thash deri në fund të vitit këto katër rregullore do të jenë këtu, tani do të diskutojmë për ato çështje. Për 20 € me marr një leje është shumë kollaj. Ai person që nuk e ka këtë punë, e ka kerrin i paguan 20 € e merr lejen edhe del pas dite punon. Edhe e vendos kerrin ku të donë. Për atë i kemi rrit edhe pëlqimin Drejtoria e Shërbimeve Publike ka me dhënë sipas rregulloreve në fuqi që do të jenë. Rregullore me kushte të reja. Taksistet duhet

të jenë me automjete më të mira, sigurimin, xhipiesin, kamerat të gjitha. Edhe kushtet e punës. Tash nëse dojmë këto me bo politik, bëjmë. Anë ndryshoje çmimin, propozojë një çmim tjetër.

**Irir Baldedaj:** Nëse një Rregullore është në fuqi dhe nuk ka rregullore tjetër, derisa të vjen dhe të aprovohet në Asamblenë komunale, kjo rregullore vlen drejtor. Ti po donë mi qit taksa taksistëve, po thua deri sa të vije rregullorja e re. E ke shumë gabim qasjen. Kjo rregullore është e vitit 2016, është në fuqi deri sa të vije rregullorja e re dhe të aprovohet në Asamblenë komunale. Në momentin kur ajo aprovohet, kjo shfuqizohet. Dhe ti po flet për rregulloren që ka me ardhur pas tre katër muajve. Po thua ke me vendos taksa. Unë s' di po e zgjatni kaq shumë. Kryesues unë e propozova, edhe z. Hodaj ke dakord për me shty. Nëse ka nevojë vijnë në seancë të jashtëzakonshme veç për këtë rregullore. Nuk është shumë telashe. Po është mirë një dokument kur ta aprovon Asambleja komunale me qenë e shkrua. Jo me qenë vetëm në procesverbal me ndryshime e me gjëra të tilla. Ky është një dokument shumë i rëndësishëm dhe është mirë i përgatitur. Ka nevojë për disa plotësime ndryshime dhe është shumë normale. Se edhe kushtetutat edhe kanunet janë ndryshua, edhe bibla edhe kurani le më një rregullore.

**Kryesuesi:** Po e përmbyllim këtë debat. Çështja e taksive siç u tha do të shkoj me një rregullore tjetër, se si do ta rregulloj këtë punë. E dini sidomos ju që keni qenë më herët në pushtet lokal, se edhe pas miratimit të rregullores, mund të iniciativa mu ndryshua çdo gjë. Në fund të fund këtë punë e kemi, nuk kemi punë tjetër ne me diskutua në Kuvend. Sa herë mendojmë që një taksim një kategori ka një çmim më të lartë ose më të ulët, çdo anëtarë i Kuvendit ose grupi parlamentar, sidomos grupi parlamentare, kanë të drejtë me iniciua procedurën edhe e bëjmë këtë punë. Se në fund të fund është interesi publik, e para. E dyta mos të harrojmë një gjë, rekomandimi i KPF-së është për me u miratua rregullorja e vjetër. Po e hapëm ne diskutimin edhe në Kuvend, që këtë proces ta bëjmë në pajtim edhe me kërkesat e Kuvendit. Prandaj, janë këtu krejt pesë propozime që u bënë, që lexuan tashmë po i dimë të gjithë. Nëse ka një edhe njëherë po i lexojmë po jemi duke humbur kohë. Është procesverbali, është audio incizimi, është transmetimi i mbledhjes. Kanë marrë drejtorët shënime. Gjithçka është në rregull shkon në MAPL edhe kurrfarë komplikimi nuk ka këtu. Veç po komplikohet kot.

**Haziz Hodaj:** Vendimet për taksat komunale për vitin 2018 janë shpërndarë në fillim të vitit. Kështu që nuk bëhet fjalë për vitin 2018. Edhe nëse vonohemi një muaj edhe e marrim një vendim të drejt, një rregullore të pranueshme prej të gjitha grupeve, nuk bëhet vonë, se flitet për vitin 2019. Do më thënë me kohën nuk kemi problem absolutisht. Se vendimet janë shpërndarë. Tash bëhet fjalë për vitin 2019. Kështu që nuk na prish punë.

**Ertan Simitçi:** Vendimet për faturat e taksave komunale të vitit 2018, nuk janë shpërndarë baca Haziz. Unë e kam marrë atë përgjegjësinë, edhe nuk i kemi shpërndarë, e para. E dyta, e ceka që rregullorja për menaxhimin e taksave, ne e kemi rritë vetëm tarifën, asgjë tjetër. Jemi konsultuar me të gjithë zyrtarët ligjor, janë dakord dhe është në fuqi. Herën tjetër do të marrim edhe raportin e auditorit, do të shohim që është edhe vërejtja e auditorit që Komuna e Prizrenit, kryetari i Prizrenit duhet të shqyrtoj rregulloren për ndryshim plotësim në kohë sa më të shpejt. Ju thash nëse e shtymë për tetor këtë që e marrim aprovimin prej Ministrisë të Administratës të Pushtetit Lokal, tani qysh kemi me zhvillua procedurën për faljen e borxheve. Tani ju vendosni, jo Drejtoria e Financave.

**Kryesuesi:** Sido që të jetë është përcaktua një rend dite, kemi rekomandimin. U dëgjuan të gjitha grupet parlamentare, u dëgjuan me kujdes të gjitha propozimet. Është bërë një këtu një harmonizim rreth secilit propozim. Andaj, 32 anëtarë jemi prezentë në sallë, e hedh në votim këtë Draft Rregullore, me propozimet për ndryshime, kush është për?

Për? – 15.

Kundër? – 8.

Abstenim? – 6.

Atëherë me 15 vota për, 8 kundër dhe 6 abstenime miratohet Draft Rregullorj për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale, më ndryshimet e propozuara.

**Pika e nëntë:**

**Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimvendimit për lejimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm “Parku i Inovacionit dhe Trajnimit“ për qytetin e Prizrenit (ish zona e KFOR - it Gjerman)**

**Kryesuesi:** Ftoj përfaqësuesen e Drejtorisë së Urbanizmit që të bëjë propozimin e këtij propozim-vendimin para kuvendit.

**Shpresa Osmanolli, përfaqësuese e Drejtorisë për Urbanizëm:** Në pika të shkurta do ta shpjegoj vetëm hapësirën. Sepse ky propozim-vendim është vetëm për lejimin e hartimit të planit rregullues të hollësishëm “Parku i Inovacionit dhe Trajnimit”. Zona ku është planifikuar të bëhet hartimi i planit, është zona ku tash ekziston KFOR-i gjerman. Është në periudhën e hartimit të hartës zonale, ku deri më tani kemi një fazë të hartimit të këtij dokumenti. Është hartuar gjendja faktike, mbledhja e të dhënave të gjendjes faktike. Destinimi i zonave sipas PZHK-së, analizat e të tjera. Në kuadër të hartës zonale, gjatë

detalizimit, është paraparë edhe ky lloj i hapësirës. Hapësira, baza ushtarake e KFOR-it gjerman, e cila zonë do të ridestinohet. Kryesisht do të shfrytëzohet si zonë sociale dhe zonë për infrastrukturë teknike. Me procesin e përfundimit të shërbimeve ushtarake të KFOR-it, kjo zonë ushtarake do të rigjenerohet si sipas përdorimit të përshtatshëm të tokës si zonë për zhvillim të ri. Në këtë zonë në PZHK është paraparë zona e kampit universitar. Prandaj është shumë e nevojshme që kjo zonë të trajtohet. Duke pasur parasysh pozitën e zonës dhe karakteristikat urbane të zonës, është më rëndësi të ceket se si të krijojmë bazën për hartimin e planeve dhe investimeve, gjithmonë duke pasur parasysh destinimin. Dhe duke krijuar qytetin e Prizrenit bazë për investime nga e cila do të krijohen vende të reja të punës dhe do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin socio ekonomik. Është hap shumë i rëndësishëm për qytetin e Prizrenit. Dhe si qytet i dytë nga madhësia në Kosovë, duke pas parasysh pozitën edhe qytetet e tjera përreth, gjithashtu edhe shtetet fqinjë. Andaj, duke u bazuar në nenin 17 pika 1 e planifikimit hapësinor dhe duke u bazuar në kërkesat e pronarëve. Marrëveshjet e arritura në mes të pronarëve apo edhe kërkesat e investitorëve dhe duke parë edhe interesin e komunës së Prizrenit, për realizimin e planeve rregulluese urbane. Komuna e sheh të nevojshme dhe të arsyeshme për fillimin e hartimit të planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane zona e KFOR-it gjerman. Ky plan siç e ceka më herët që komuna është në hartimin e hartës zonale. Ky plan do të inkorporohet në hartën zonale, ose gjatë procedurës do të bashkëveprojnë të dy hartat. Zona për të cilën do hartohet plani i hollësishëm është zonë e përcaktuar me planin zhvillimor komunal. Plan ky i cili është miratuar me vendimin 01/31, tash më siguri se e keni edhe këtë informatë. Pra, hapësira e këtij plani që do të hartohet, përfshinë një sipërfaqe prej 39.25 hektar. Dhe ky plan do të përcaktoj normativat për zhvillim, normativat për ndërtim. Do të kaloj në të gjitha fazat apo procedurat të cilat kërkojnë një plan rregullues urban. Plani është tetëvjeçar, dhe sipas ligjit në fuqi mund të bëhen edhe ndryshim- plotësime. Duke pasur parasysh që udhëzimi administrativ që elementet dhe kërkesat themelore për hartim, zbatim dhe monitorimin e projekteve rregulluese të hollësishme, është në prag të nënshkrimit nga ministria përkatëse. Pas nënshkrimit do të inkorporohen dispozitat gjatë hartimit të planit rregullues të hollësishëm. E keni pas edhe hartën se ku është zona e KFOR-it.

**Kryesuesi:** Po vazhdojmë me deklaratat e shefave të grupeve. Siç e dini për aq sa jam unë i njoftuar, me largimin e KFOR-it gjerman nga kjo zonë është hap atëherë diskutimi se kujt duhet ti takoj kjo pronë. Dhe së fundmi në pika të shkurta është bërë një dakordancë në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes Kryeministrit, KFOR-it gjerman, Ambasadës Gjermane si dhe GIZ-it së

bashku me komunës e Prizrenit, që kjo zonë të shndërrohet në një qendër të trajnimit dhe inovacionit, e cila do të menaxhohet dhe përkujdeset nga GIZ. Si komunë nuk është që kemi autorizime rreth këtij kampi. Por ne duhet ti kryejmë këtë pjesën ligjore që është pjesa e planeve rregullative. Eventualisht vendimet të tilla që kanë të bëjnë me planifikim hapësinor.

**Adem Shabanaj:** E përkrahim këtë iniciativë.

**LDK:** E përkrahim edhe ne si subjekt këtë iniciativë.

**Ilir Balldedaj:** Ne do ta mbështesim, sepse është marrë kjo iniciativë nga ish qeverisja e kaluar. Pjesë e kësaj që është edhe në pozitën e drejtorit të Administratës. Dhe natyrisht që vendimi i Kryeministrit Haradinaj është një vendim i duhur për Prizrenin dhe për qytetarët e Prizrenit. Dhe do ta mbështesim.

**Pranverim Berisha:** Edhe Nisma Socialdemokrate e mbështet.

**Sencar Karamuço:** Edhe ne si KDTP do të mbështesim.

**Memnuna Ajdini:** Takode i Vakati podržava.

Nga NDS-i s'qenka askush.

**Alush Shala:** Unë prita mos po vjen shefi i grupit. Po megjithatë ne e kemi diskutuar këtë çështje edhe në KPF, ku realisht e kemi mbështet. Po jemi marrë vesh edhe në KPF, që duhet të pajisemi me dokumente përkatëse, sepse s'po dimë çka po bëjmë dhe si ka me shkua. Andaj, veç mungesa e dokumentacionit nuk është mirë pse ka ndodh. Përndryshe edhe ne si grup parlamentar do ta mbështesim një punë që edhe vetë kemi dhënë kontribut.

**Kryesuesi:** Edhe pse ky është vetëm vendim për me lejua hartimin. Kur të vjen plani i hartua, si plan prapë ka me ardhur në Kuvend. E pastaj kemi çka diskutojmë edhe me materiale edhe me harta. Po tash si Kuvend neve ligji na obligon që me marr vendim për mu hartua. Por para se ta hedh në votim, veç një përmirësim me bo nga Shërbimi i Kuvendit në kuorumin e pikës së kaluar nuk ishin 32 anëtar po ishin 31. Dhe se votat për atë rregullore kanë qenë: Për 15, kundër 8, abstenim 8, veç sa për sqarim. 24 anëtarë janë prezentë në sallë, e hedh në votim këtë propozim-vendim. Kush është për?

Për? – Të gjithë.

Kundër? – S'ka.

Abstenim? – S'ka.

Atëherë konstatoj se me 24 vota për aprovohet propozimvendimi për lejimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm “Parku i Inovacionit dhe Trajnimit“ për qytetin e Prizrenit (ish zona e KFOR - it Gjerman).

**Pika e dhjetë:**

**Informatë mbi raportin e Komisionit të përzgjedhjes së drejtorëve në Shkollën në Komunën e Prizrenit.**

**Kryesuesi:** Ne po hapim diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës

**Pranverim Berisha:** Ne, Nisma Socialdemokrate qëndrojmë përkrah, apo mbështesim njeriun e autorizuar nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate që është drejtori i Arsimit, në këtë rast Skender Susuri. Prandaj ai çfarë të deklaroj ne jemi pro kësaj. Një pyetje e kam për juve, për subjektin politik LVV-je. Çfarë qëndrimi ju keni në lidhje me anulimin e konkursit nga vendimi që e ka marr kryetari i komunës Mytaher Haskuka, një vendim adoleshent?

**Kryesuesi:** Sa i përket pyetjes LVV-je si subjekt politik, vendimet i merr pas mbledhjeve të kryesisë. Ne ende nuk e kemi mbajtur mbledhjen që me dal me qëndrim. Ky proces ende nuk ka përfunduar. Rrjedhimisht ne nuk kemi qëndrim, sepse sot s'po u njoftuam me këto zhvillimet e fundit. Në momentin e parë natyrisht që do ta keni publike edhe qëndrimin e LVV-je.

**Ilir Baldedaj:** Me gjithë respektin për drejtorin e arsimit. Po unë kisha thënë të hiqet prej rendit të ditës, sepse është anulua, me një vendim që e ka marrë kryetari i komunës. Dhe s'ka pse duhet të diskutojmë një çështje që ka përfunduar. Sepse organi kompetent që është më i lartë kryetari i Komunës, zyrtari administrativ e ka anulua një konkurs. Unë kam pas reagimin tim edhe si subjekt politik edhe si Ilir. Dhe unë besoj që është e kotë të merremi më këtë çështje për derisa është anulua.

**Antigona Bytyqi:** Pas publikimit të listës për drejtorët dhe zëvendës drejtor të përzgjedhur, është shumë e vërtetë që jemi zhgënjyer të gjithë qytetarët e komunës së Prizrenit. Drejtorja e Arsimit e udhëhequr nga Nisma, pati premtuar depolitizim të shkollave. Drejtori z. Susuri këtu në Kuvend, në media e kudo tjetër pati premtuar se drejtorët e suksesshëm dhe ata më poentuarit do të përzgjidhen pa marrë parasysh se cilit subjekt politik i takojnë. Dhe si për çudi vetëm drejtorët e tyre politik paskan qenë të suksesshëm, për të marrë mandatin e radhës. Dhe vetëm kandidatët e tyre kanë marrë më shumë pikë. Në këtë proces zgjedhor të procesuar aspak profesionalisht, pa dyshim se rol kanë luajtur edhe disa anëtarë të komisionit me përvojë zero në menaxhim. Dhe sigurisht shumë të dëgjueshëm dhe të

sjellshëm ndaj udhëheqësve të Nismës. Duke lënë kështu jashtë listës, kandidat që e kanë dëshmuar vetën në menaxhim të shkollës. Pastaj i kanë plotësuar kriteret e konkursit, por janë lënë jashtë listës, sepse i takojnë partisë që sot është në opozitë. Keni bërë marrëveshje të natyrave të ndryshme me kandidatët tuaj të dëgjueshëm duke aplikuar në shkollat e caktuara. Pastaj duke kërkuar nga ata tërheqjen e tyre nga ajo shkollë për t'ia liruar vendin kandidatit tjetër. Dhe që këtyre t'ju sigurohet mandati nëpër shkolla tjera. Siç është rasti i shkollës të mesme të mjekësisë dhe shkollës fillore "Abdyl Frashërti". Postimet e shkrimet e ndryshme nëpër rrjetet sociale kanë bërë të ditur se subjektet politike që bërë koalicion me Nismën Socialdemokrate, nuk kishin qenë të qarta se me çfarë parti do të qeverisin. Pastaj keni cekur se këtu ka pasur pazare ditore. Jo të nderuar koleg kuvendarë, jo të nderuar qytetarë. Këto nuk janë marrëveshje ditore apo mujore, por këto janë marrëveshje edhe vjetore. Këtë që po them jam e sigurt sepse Nisma në shkëmbim të librezës partiake qysh para tre, katër vjetësh kanë premtuar poste të drejtorëve, kur tu vij dita. Dhe që fatkeqësisht ju erdhi kjo ditë dhe po ndodh një gjë e tillë. Ju do të thoni si! Para tetë vjetësh kur janë zgjedh drejtorët e shkollave dhe të cilëve pastaj nuk u është besuar mandati i dytë për një arsye. E vetmja arsye ka qenë mossauesi i tyre, udhëheqja jo e mirë nëpër shkolla. Dhe çfarë bëjnë këta ish-drejtor, për inate të tyre personale dhe nga dëshira e flaktë për të qenë përsëri herë do kur do drejtor. Shkojnë në arsimin, sepse siç po duket qysh atëherë Nisma e ka pas synim këtë Drejtorin. Ku ata marrin postin e drejtorit bashkë me librezën e tyre. Do më thënë shumë drejtor i kemi të zgjedhur para tre, katër vjetësh, ende pa pasur nevojë të vlerësohen nga komisioni në intervistat konkurruese. Arsimi në komunën tonë do të menaxhohet nga drejtorë të zgjedhur në këtë mënyrë, të cilët do të udhëheqin nëpër shkollat tona jo më pak se katër vjet. Tani presim listën e radhës e cila do të jetë pak më specifike se e para. Sepse aty përveç baxhanakëve do të kemi edhe motra të drejtoreshave të listës së parë.

**Haziz Hodaj:** Ç'është e vërteta për të dytën, a të tretën herë do të isha pajtuar me Ilirin sot, që të hiqet nga rendi i ditës kjo pikë. Meqë kërkesa e jonë ka qenë për ta fut në rend të ditës. Dhe qëllimi ynë final ka qenë anulimi i këtij konkursi. Pasi që kryetari ka bërë një veprim të drejtë dhe e ka anuluar konkursin. Do ta falënderoj këtu nga kjo foltore në emër të gjithë grupit parlamentar të LDK-së. Po tani arsyeja që jam këtu, sigurisht që do ti them arsyet. Do ti them pse LDK-ja ka kërkuar që të futet në rend dite edhe të debatohet edhe të raportohet rreth konkursit për drejtorë të shkollave. Singerisht po them e ruaj ende qëndrimin edhe besimin për Skender Susuri si drejtor i Arsimit në Prizren, e kam thënë publikisht e them prapë. Por me atë çka ndodh kohën e fundit rreth procesit të konkursit, vërtetë ka qenë jo e pranueshme, jo parimore, jo kolegjiale, jo arsimore, jo profesionale. Fushata që është zhvilluar edhe para hapjes së konkursit, eja në partinë time se të bëjë drejtor. Kjo ka ndodh drejtor edhe nuk mund ta mohoni në asnjë rast, sepse kemi argumente.

Do më thënë njerëz të caktuar kanë ardhur në partinë Nisma vetëm për tu bërë drejtor. Dhe natyrisht kanë pas premtimin që të bëhen dhe i keni bërë. Kështu që duke e parë fillimisht këtë hap jo të drejtë, pastaj edhe procesin e konkursit, ka ndodh një jo transparencë edhe sipas raportit të organizatave joqeveritare. Nuk kemi pas transparencë sepse nuk ka qenë asnjë anëtarë i kuvendit në monitorimin e intervistimit të asnjë kandidati. Nuk ka pas transparencë as në caktimin intervistuesve. Rezultatet që janë dhënë vërtetë janë fye kandidatët. Për ko incidencë do ta përmendi një rast. Një kandidate që ka qenë drejtoreshë dhe ka qenë kandidate për drejtoreshë tani, ka pas një plan zhvillimor të shkëlqyeshëm, model për avancimin e shkollës ku ka punua. Dhe po ju them në momentin që kanë ardhur prej Prishtinës me ia marrë planin zhvillimor si model në atë moment e merr mesazhin nga Drejtoria e Arsimit që nuk e ka plotësuar numrin e poenëve për të qenë drejtor në mandatin e ardhshëm. Nuk ka qenë e LDK-së, të jeni të sigurt, të jeni të bindur. Dhe nuk ka qenë i LDK-së as kandidati që unë e kam preferua për në Gjonaj, që kanë thënë e kam sebeb. As nuk e kam sebeb, as nuk është i partisë sime. Por kam qenë i interesuar që në Gjonaj, njëherë e mirë të zgjidhet çështja e menaxhimit të shkollës, sepse ajo vuan për një menaxher të mirë. Është e vërtetë që në kohën e partisë demokratike ka qenë i kapur arsimit. Këtë nuk mund ta mohoj as militanti i PDK-së. Dhe i kam thënë edhe kryetarit Haskuka, është shumë problem të depolitizohet arsimit. Mirëpo çka duhet tu ofrojmë në shkollave. Çka duhet tu ofrojmë qytetarëve të Prizrenit. Njerëz me integritet, njerëz profesionist, njerëz menaxher të mirë që e drejtojnë institucionin ashtu si duhet. Dhe a është bo kjo, jo. Andaj për këtë ne kemi kërkuar që të debatohet në Kuvend dhe nga Kuvendi ti rekomandohet dhe ti kërkohet kryetarit të komunës që ta anuloj konkursin. Unë paraprakisht e falënderoj edhe njëherë që ka marrë një hap të mirë. S'keni nevojë ju Nisma mu hidhërua. Po është mirë që të rishikohet ky proces, e mos të përsëritën gabime në procese tjera të konkursit. Përndryshe drejtor ti je burrë edhe i odave edhe i zyrave dhe e dinë se si duhet të veprosin në momentin që të anulohet konkursi.

**Fatmir Kastrati:** Në radhë të parë unë falënderoj drejtorin Susuri, që na ka ofruar një raport, sepse pa e pas ne këtë raport, ne kishim fol ndoshta përmendsh. E mandej shtrohen çështjet e ndryshme e pikëpyetje të ndryshme që kanë të bëjnë lidhur me përzgjedhjen e drejtorëve. Kam pas fatin që menjëherë pas lufte të jem në Drejtorinë e Arsimit për një kohë, edhe i kam përcjellë zhvillimet në arsim prej fillimit. Kemi pas vazhdua me drejtorët të cilët kanë qenë edhe para lufte. Edhe kjo formë, ose kjo metodë e ndërrimit të drejtorëve dhe vendosjen e drejtorëve ka filluar të themi të drejtën e LDK-në, për disa vite më radhë. E ka vazhduar ndoshta në mënyrën edhe më drastike edhe nga PDK-ja. Ku një pjesë të fajit e ka edhe AAK-ja aty. Po ajo që është befasuese për neve, është mënyra se si e ka vazhdua VV-ja këtë punë. VV-ja ka ardhur në pushtet pikërisht duke kritikuar në mënyrën më të rreptë të mundshme qeveritë

e kaluar. Por si dukët më së shumti e ka shkelë këtë procedurë, pikërisht VV-ja, së bashku me aleatet e sajë. Mua më vjen keq z. Susuri që jeni ballafaqua me probleme, që jam i sigurt që s'je pajtua as ti me këtë përzgjedhje të drejtorëve. Unë të falënderoj që na i ke dhënë CV-it e drejtorëve që janë zgjedh. Edhe që janë menduar që janë më të mirë, që është diskutabile. Por nuk e kemi CV-në e atyre që nuk janë përzgjedh. Ku e dimë që ata kanë qenë më të dobët se ata që janë përzgjedh. Prandaj ka shumë pikëpyetja këtu. Edhe kisha shtruar pyetjen a je konsultuar me kryetarin Haskuka? A të ka raportua kryetari Haskuka që po e anulon konkursin? Apo a është i vërtetë ky anulim, sepse nëpër portale po shkruan. Në qoftë se është e vërtetë, atëherë drejtor unë vërtetë nuk e di cili është roli dhe kompetenca e jote. Edhe cili është roli dhe kompetenca e partive të cilët veç jeni duke e menaxhua qytetin e Prizrenit në më të keqe të mundshme këta gjashtë, shtatë muajt të fundit. Edhe jam i sigurt se edhe brenda VV-së ka probleme në mënyrën se si janë vendos drejtorët. Nuk dua ta luaj rolin tash as të gjykatësit as të prokurorit këtu. Mua thjesht po më intereson si profesionist i arsimit, që jam ballafaquar me arsimin që tridhjetë vite me radhë. Që kemi shpresua që me këtë pushtet të ri do të filloj në një farë mënyre depolitizimi, apo depolitizimi i shkollave tona. Po që fatkeqësisht nuk ka ndodh një gjë e tillë. Se kur do të ndodh, tanimë jam në një dilemë shumë të madhe. Tek fillimi është 12 apo 13 shkolla janë. Po si të vazhdohet apo si do të procedohet më tutje, ku brenda koalicionit keni kesi mosmarrëveshje. të cilat kanë të bëjë me pozitat menaxheriale, të cilat në këtë rast janë shkollat. Nuk e di si do të vazhdoni në tri vitet e ardhshme se një vit veç shkoi. Vazhdimisht do të ballafaqoheni pse nuk e ke zgjedh drejtorin tim, ose pse e ke zgjedh drejtorin tim. Pra, nuk po shikohet ana profesionale, ana menaxheriale, sepse të jeni të sigurt se në shkollë në qoftë se menaxheri është i dobët, edhe shkolla ka me qenë e dobët, e kam provua. Kam punua edhe në shkolla publike dhe jam duke punuar edhe në shkolla private, e di çka do më thënë menaxhimi. Edhe në qeveritë e kaluara kur kemi bisedua, kur kemi diskutua në asamblenë komunale, vazhdimisht të gjithë janë pajtua se nuk po zgjedhin menaxheret e mirë, po i zgjedhin drejtorët partiak. E në qoftë se vazhdojmë kështu, atëherë mos pritni se ka përmirësim të cilësisë së arsimit nëpër shkolla. Përkundrazi, gjendja ka me qenë edhe më e keqe. Nuk është më rëndësi i cilës parti politike, sepse i njohim njerëzit, një pjesë të tyre i kemi miq e shok. Nuk po hy në aspektin personal të tyre, po, po hy në mënyrat, forma dhe procedurat me të cilat i keni përzgjedhur. Unë e lexova raportin, dhe aty thuhet se në mënyrën më të mirë të mundshme. Ndoshta edhe është qashtu. Mirëpo, edhe njëherë po e shprehi dilemën! Ata tjerët që kanë konkurrue, a vërtetë qenkan më të keqit, apo më të mirët qenkan të VV-së dhe të Nismës. Nuk mundet me ma heq kurrkush këtë ves. Nuk mundem me besua është një gjë e tillë. Sepse e di kush ka konkurrue, edhe çfarë cilësish kanë pas edhe ata që kanë konkurrue më herët, edhe tash që jemi në këtë pozitë që jemi. Pra, ky konflikt në mes të drejtorit të arsimit edhe kryetarit Haskuka ka me vazhdua edhe më tutje. Edhe drejtor edhe njëherë po ta parashtroj pyetjen. A i ka

nënshkruar kryetari Haskuka në fillim këto emëtime të drejtorëve, apo ende nuk i ka nënshkrua. Apo kur i kanë shkua në tavolinë, më siguri i ka pa se kush koka drejtor, edhe atëherë e ka anuluar konkursin. Nuk po më intereson mënyra e menaxhimit të Kuvendi si do ta bënë, po më intereson çështja e arsimit, çështja e shkollave. Sepse vazhdimisht po thirremi në atë se kërkojmë cilësi, po asnjëherë nuk po shihet kjo. Nuk e di deri kur ka me vazhdua kështu. A vërtetë qenka patjetër që duhet shokët tanë, miqtë tanë mi stabilizua nëpër drejtori atje, mi bo drejtorë. Apo është çështja diku tjetër. Ky largohet, ky tjetri bëhet, ky është i partisë teme. Pas katër vite do të ndryshohet gjendja, edhe prapë do të vazhdohet me të njëjtën metodë. Unë kam pritë, edhe njëherë po e përsërisë, kam prit që do ta jepni një shembull të mirë, bile në arsim. Po fatkeqësisht jeni edhe më keq se ata që kanë qenë.

**Cenet Sajadi:** Egitim Müdüründen bir talebim olacak. İş başvuruları açıldığında Komisyonlara Türk vatandaşların da azınlık olarak alınmasını talep ediyorum. Çünkü mülakatlarda bu konuda vatandaşlarımız sorun yaşıyor . Bu konuda bir çalışma yapmanızı talep ediyorum.

Kam një kërkesë nga drejtorja e arsimit. Kur hapen konkurset për vendet e punës kërkojë të merren edhe komuniteti turk si pakicë, pasi që gjatë intervistave qytetarët tanë kanë probleme në këtë drejtim. Kërkojë që të bëni diçka lidhur me këtë çështje.

**Alush Shala:** E përshëndes drejtorin Susuri, derisa të gjithë po e lëvdojnë kjo është diçka e mirë. Por realisht sa e përfundova leximin e vendimit, nëse është i saktë i kryetarit Haskuka, i cili lavdëron procesin e punës të drejtorisë dhe në fund e anulon. Ky mos koordinim nuk e dëmton as Skender Susurin, as neve si kuvendarë. Po ky mos koordinim, dhe ky mos bashkëveprim, ky e dëmton procesin. Pajtohem plotësisht me atë që tha kolegu im Fatmir Kastrati, që ka me ndikua edhe në vijimësi pengimi, dhe mos realizimi edhe atë që e ka premtua. Edhe atë që dëshiron, jam i bindur që dëshiron Skender Susuri, për ta ndryshua për të mirë. Por si duket ka qëllua në vendin e duhur por me njerëz të gabuar. Prandaj besoj që ka fuqi që ka me rregullua në të ardhmen.

**Dafina Bilaca:** Pajtohem me fjalët kuvendarit të AAK-së dhe kuvendarit tonë baçit Alush. Është shumë e vërtetë që edhe unë kam pas shumë besim te drejtori Susuri. Madje edhe kur kemi qenë bashkë në një emision, pata deklaruar që në qeverisjen Haskuka, nuk besoj absolut hiç. Besoj vetëm në drejtorin e Arsimit. Mirëpo, po më duket që këto pazaret politike e kanë detyruar edhe drejtorin që të merr një vendim ndoshta ta "gabuar" me këta drejtorët e përzgjedhur. P.sh. në shkollën "Abdyl Frashri" ku ka qenë një drejtoreshë shumë e suksesshme, jo vetëm se është e PDK-së. Po Lumnije Rakaj ka dëshmuar vetveten në këto katër vite menaxhim në shkollën "Abdyl Frashri".

Kështu që vjen koha, kur ajo largohet. Mirëpo jo vetëm se ajo largohet. Por shkolla ndahet në dy pjesë. Mirëpo, nuk e di a është nda vetëm për shkak që të bëhet edhe një vend edhe për baxhanakun e z. deputetit Haxhi Avdylyt, apo për çfarë. Besoj drejtori do të na jep informata më shumë për këtë çështje.

**Shukri Quni:** Mua drejtor më të vërtetë po më vjen keq që ke ra në këtë gjendje tash. A të kujtohet kur të kam thënë në KPF, dy vetë kam dëshirë me i pa në qeverisje, ndoshta s'ke harrua. Juve si drejtor i arsimit edhe Artanin në pozitë ku është tash, kryesues. Se vetmja që nuk ka udhëheqë në Prizren, ka qenë VV-ja. Edhe kjo shqyr po e shohim se çka është ka bënë. Kur keni kërkuar interpelancë, nja katër-pesë herë te drejtori i Arsimit, të Prof. dr. Nexhat Çoçaj është ndjellë zi e terr. Po më shumë prej PDK-së mos të harrojmë se ata e qelshin rrugën, atëherë ju keni vazhdua. E tash je në qatë lëkurë edhe ti sot, që po më vjen keq. Këtu sipas kësaj që po shihet, kanë shkua procedurat si është më miri. Ne po të lëvdojmë, po më në fund prapë po të shajmë. Nuk po e bëjë atë, të kam sha më herët, në fakt të kam dhënë kritika edhe më herët, po s'është problem ajo. E kështu që mua kjo nuk po më pëlqen, pasi i keni zgjedh drejtorët me bo anulim. Ne i kemi anuluar ja katër- pesë herë PDK-ja, po nuk i thirrshim në intervistë kandidatet. Kam harrua tash. A kjo që është bërë tash, se unë tash morra vesh që është anulua ky konkurs, se nuk e kam ditë, unë kam mendua që janë vendos këta edhe kanë me vazhdua. Po kolegët të mi të PDK-së, edhe të LDK-së, se këtu koka interes, se s'koka duke iu dhimtë drejtorët, po koka duke iu dhimtë pozita, kush e kënd. E të PDK-së, mos të marrin siklet shumë, se e përmendi edhe Fatmiri që edhe ne jemi kon drejtorë dikur. Bile unë 1995, kur ka qenë më keqi më kanë pas emëruar atëherë, më i riu kam qenë. Po se marrke kush se kogja vështirë. Po kur ardhur Haziz Hodaj në pushtet, të parin që jam largua jam unë. Partia e Hazizit e kam fjalën. Kurrë se ka ngrit zërin as partia ime, as partia e Hazizit, as e dikujt tjetër. E kështu që drejtorët kanë të drejtë të bëjë ankesa. Edhe shumë është e vërtetë që ai që vjen në pushtet, ka mi emërua ata drejtorë që kanë me dëgjua, për të udhëheqë atë politikë. Unë nuk jam kundër asaj që e kam ditë. Që ardhja në pushtet e VV-së, ka me i vendos njerëzit e vetë. Artani atë ditë tha, s'është tash këtu, po ka qenë dashtë me ju përgjigj në atë pyetjen e Ymerit. Kur thash a hala Ymeri po sillet këtu pari a. Unë si me hajgare thash, po ai e mori përnjëmend. Tha, ne VV-ja nuk i largojmë njerëzit. More jeni duke i larguar, bile janë duke u habit shumë kush që se ka pritë atë. Po unë e kam ditë. Tha kolegu Fatmiri, kemi përvojë ne në këtë drejtim. Çdo parti politike kur vjen në pushtet, mos të paraqitemi këtu tash francez të gjithë. Se ne e dimë se ata kanë me i marrë njerëzit e vetë. Nuk këqyrët shumë profesionalizmi, sa këqyrët të dëgjueshmit me qenë këtu në të. Kështu që drejtor anulimi i konkursit, unë edhe si opozitë, po më dhimbset puna në arsim, që nuk është mirë me luajt edhe me këta persona që i keni emërua. Se unë e di që të PDK-së prapë s'kanë me u kthye, shumë është e vërtetë. Këta që kanë qenë drejtorë edhe i kanë heq, këta s'kthehen. Na ta marrim shaminë edhe

të vajtojmë sa të duash. Po ju ka thënë shumicë, se kur të vije pushteti ke mu largua. Se këtu tek ne hala s'është duke shkua me vendos personin që meriton me qenë. Këtu tek ne është duke shkua me persona të cilët janë të dëgjueshëm edhe të partisë. Unë nuk po shohë këtu dikush të PDK-së, që e ka marrë librezën e ndonjë partie tjetër. Cili është ai? Kurrë s'ka qenë ai në PDK-a, le atë muhabete. E di unë më mirë se ti. Po nuk është e vërtetë. Kundër ti është pikërisht LDK-ja. Çka ke ti, për ty si Latif Çoçaj, mos ti marrë me emra këta, tjerët. E kështu që e njëjtë është tash. Unë nuk po të përkrahi në atë aspektin veç më thënë, se edhe përkrahja ima nuk vlen kush e di sa. Se jam në opozitë, edhe duhet me të kritikua gjithë. Me këta drejtorë që i keni emërua nuk keni bo mirë. S'ka qenë dashtë mu e merua këta drejtorë. Për pazaret politike që i keni ato mbesin brenda jush. Se keni bo një koalicion kogja të gjerë. Po shumë jeni kon zotua se keni me udhëheq mirë. Edhe unë kam pas besim. Kur e thash atë fjalë që kam dëshirë me në pushtet këtë, këtë, edhe unë kam besua më të vërtetë që keni me qenë me udhëheqë mirë. Veç që më zhgënjani edhe mua unë nuk di çka bëjnë qytetarët tjerë. Se po më kujtohet tash po mi rri para fytyre këtu drejtori Nexhat Çoçoq, kur derdhshi lot krokodili para kryetarit Muja, që arsimin është duke bërë skandal drejtori i Arsimit. Kështu që unë të kam thënë që nuk është e vërtetë, se e bëjnë krejt tjerët, e ti vetëm bënë vaki je aty që ke mu sulmua prej tjerëve. E kështu që nuk është keq mi kërkua falje Nexhat Çoçës publikisht. Edhe shumë do tjerë. Mëshele, kush është ka flet! Hajgare mos të bëjmë, se s'keni qenë ju këtu qysh është ofendua ai. Edhe fëmijët edhe familjen ja kanë ofendua, nuk është mirë. Kush të ka personale është jashtë. Se unë Skender Susurin e njoh shumë herët. Edhe më vjen keq shumë që është në atë pozitë tash. Me pas qenë unë tash, kurrë nuk ishte anulua që ky konkurs. Këtë po të them. Me pas qenë në vendin tënd, ky s'ishte anulua. I ke emërua drejtorët, edhe po vije puna pi them ti s'je drejtor. Kurrë hiç, ke kush ke. Edhe nuk është mirë tjetër herë, se e pash edhe një reagim parës këtu. Po s'është kryesuesi, se ka qenë dashtë me reagua ju femrat sidomos. Kur qohet një njeri një kuvendarë këtu, edhe i vërsulet një femrës nuk është mirë. Nuk jemi ne këtu me ardhur me bo hajgare. Ka disa momente, po janë disa momente serioze. Se mua është kah më dhimbset. Se të jeni ju në lëkuren e ti, kishit me pa se çka do më thënë mi emërua drejtorët, edhe mu qua kryetari me thënë që e anuloi konkursin. Konkursi anulohet para se me u emërua. Jo kur të emërohen ata. Se jemi kah luajmë ne me arsim. Se unë jam në opozitë, asnjëri s'është te mu dhimt hiç. A doni me ju thënë drejtë. Kam pas dëshirë krejt drejtorët e shkollave ata që kanë qenë më herët. Kanë qenë të suksesshëm të gjithë. Më dhimbsën që i kanë heq. Po edhe ata janë pajtua me atë. Nuk është në pyetje këtu kuvendarë të PDK-së, që janë duke iu dhimt strukturat e PDK-së.

**Karanfil Haxhillari:** U përmend disa herë këtu LVV-je kështu, LVV-je kështu. Vetëm dua me bo të çartë edhe shpresoj që edhe drejtori i Arsimit, që paraprakisht e përgëzoj për punën që e ka bërë deri tash. Më të vërtetë ka

treguar një sukses jashtëzakonisht të madh. Si në shumë reforma nëpër shkolla që janë bo. Po ashtu po kaloj tek LVV-je. Në qoftë se ka pas ndonjë ndërhyrje nga LVV-ja në këtë konkurs. Lirisht le ta sqaroj drejtori. Por edhe tjetra, LVV-je, nuk bënë pazare. Neve e respektojmë institucionin e Drejtorisë së Arsimit. E respektojmë edhe institucionin e kryetarit të Komunës. Pra, si parti politike, ne e kemi organizimin tonë politik. Mirëpo këto janë të ndara. Në fakt kryetari e ka punën e vetë, drejtorja e Arsimit e ka punën e vetë. Po edhe secili drejtor tjetër i ka punët e veta. Prandaj të kursehem me këto akuza të cilat më të vërtetë janë të pabaza.

**Shukri Quni:** Këtu duhet me ju falënderua LVV-je, me shkua mi pi ujë për shëndet Zafir Berishës që ju ka pru me ul në ato karrige atje edhe kryetarin Mytahir Haskuka. Me shtatë kuvendarë, kurrë ai nuk kishte mund me ardhur mu vendos me udhëheqë Prizrenin. Po le ti falënderohet Zafirrit, se Zafiri e ka bo për inat, si e thonë atë fjalën popullore, për inat të djalit le të vdes, jo, jo më mirë po them, reja le të shkon ma mirë. Kështu që nuk ka nevojë fortë me ne, mu fërkua ju pozita. Keni ju detyrat e juaja. Ne kemi të drejtë me ju kritikua sa të mundemi juve. Unë kryesuesit tim i kam thënë kur ka qenë Kujtim Gashit. Ty opozita djali mirë nuk të përqaft. Ty opozita nuk të lëvdon. Në rast se ke mas shpine që i themi ne ndonjë farë marrëveshje, atëherë diçka tjetër. Ne këtu nuk kemi ardhur me lëvdua opozitën. Ne jemi për me kritikua. Unë sa kam qenë në pozitë, ndoshta s' mu ka ndie zoni. Se i kam realizua projektet. Ka shkua puna kam mendua. Tash nuk është kah shkon puna mirë. Edhe duhet normal që me i ngrit. E mos shko shumë personale ti zotëri. Po të folmi në mënyrë të përgjithshme. Ka me u kritikua edhe kryetari Haskuka. Ka mu kritikua edhe kryesuesi. Drejtorët për atë janë. Kur e ka vesh petkun politik drejtori, ai e ka ditë që ka mu ballafaqua me kuvendarët këtu. Këtë desha me ja thënë Ertan Simitçiu. Kur e ke vesh ti petkun politik, edhe të ka emërua ty kryetari aty drejtorë, ty ka me të ardhur lloj, lloj akuze prej nesh. Se ne për atë jemi, nuk jemi për tjera. E kështu që, sikur neve që na keni thënë pajtohuni që jeni në opozitë. Edhe ju tash duhet me u pajtua me ato ne që ju japim vërejtje. Edhe besoj që janë vërejtje me vend.

**Sinan Alijaj:** Unë desha me përgëzua Drejtorin e Arsimit z. Skender Susuri. Sa i përket drejtorëve për mua është krejt në rregull, kënd të duash zgjedhe nuk është asnjë problem. Po flas edhe në emër të Nismës. Asnjë emër i përveçëm që e përmendem ne, nuk ka rëndësi për neve. Por neve na intereson procesi arsimor. Edhe mënyrën edhe programi të cilin e drejton departamenti edhe Drejtorja e Arsimit, kjo neve na intereson. Kështu që ju lutëm mos ti keni fortë këto zhvillime politike, kështu problemi i koalicionet dhe i qeverisjes. Nuk është krejt deri te ajo që është bo deri më sot. Po flasim për një politik e cila ka fillua një proces të ndryshimit, me një mentalitet të ri. Keni parasysh kush do të bëhet, kush është drejtor, a është i Urbanizmit, i Drejtorisë së Arsimit, apo

Shërbimeve Publike. Emrat e përveçëm, ti lëmë njëherë e përgjithmonë, mos të bëhen temë politike e përditshmërisë të dhe jetës tonë. Mos të vije deri te puna e deri te familja e fëmijët tanë. Nuk janë më të rëndësishëm këto. Ne jemi këtu vetëm thjeshtë për rezon, për vizion edhe për zhvillim të vendit edhe të këtij qyteti.

**Skender Susuri:** Unë normal se pak fjalimin tim e kam reduktua për shkak të situatës, se po thoni ju që po shkruajnë portalet. Po unë zyrtarisht nuk merrem shumë me portale. Edhe do të vazhdoj me diskutua atë, çka kam pas me diskutua edhe në mbledhje në fillim. Unë në fakt e kam pas një borxh ndaj profesor Fatmirit, kam qenë duke e përgatit përgjigjen. Por kur e morra informacionin prej kryesuesit që e keni kërkuar me pas raport. Unë jam mundua me bo një raport konciz. Raportin po e them publikisht këtu, janë këtu mediat, kushdo çoftë i qëndroj deri në fund. Fjalët që i ka thënë Haziz Hodaj, unë i mendoj shumë dhe i çka them. Dhe unë i marr vendimet e mia në kohën e duhur, pasi ta takoj kryetarin Haskuka. Po ju garantoj, një shkelje procedurale nëse e lexoi me vëmendje po them. Një shkelje procedurale nuk ka ndodh. Pretendimi i shoqërisë civile se nuk kanë marrë pjesë në vlerësim, është i vërtetë, sepse ata nuk marrin pjesë në vlerësim. Nëse dikush tjetër i ka nxit edhe i ka premtua që marrin pjesë në vlerësimin e kandidatëve e ka pas gabim. Sa të është Skender Susuri drejtor i KDA-së edhe sa të është që ky udhëzim administrativ, kjo nuk mund me ndodhë, pavarësisht kush e ka emirin shoqëri civile. Shoqëria civile ka qenë prej minutës së parë deri në fund në monitorim. Ata kanë qenë shumë të njëanshëm kanë ushtrua presion me vlerësua planet zhvillimore të shkollave. Nuk ju ka mundësua, as nuk ka me ju mundësua. Sepse nuk ju takon me ligj. Sa i përket pikëve që i kanë bo. Është krejt subjektive Skender Susuri, a mendon a ka pas drejtor më të mirë a jo. Ajo është çështje e diskutueshme. Unë mundem me thënë që komisioni e ka bo punën e vetë në mënyrën më të mirë të mundshme. Poenët i qofshin për nder secilit që i ka dhënë në komision. Këtu po vjen keq në anën tjetër nuk ndodhën disa kuvendarë, të cilët kanë abuzua në portale edhe në rrjete sociale. Kanë ra viktimë e atyre që kanë keq interpretua. E kuvendarët është me thënë në kuvend, mos mu marrë me portale, mos mi nëm njerëzi edhe mi quajte kopilë. Absolutisht asnjë kopilë nuk ka pas. Kryetari Haskuka po e bëjë publik, e ka pas një ligj prej tetë emrave që ia ka propozua Drejtoria Komunale e Arsimit. Katër emra i ka emërua, katër emra kryetari nuk i ka pa të arsyeshëm. Po ju them edhe njëherë, po ju garantoj. Grupit Nisma, grupit të LDK-së, grupit VV-je. Asnjë veprim i vetëm i drejtorit komunal nuk ka ndodh pa informimin paraprak të kryetarit Mytaher Haskuka. Asnjë veprim, as nuk ndodh në të ardhmen deri sa unë jam drejtori. Sepse unë e respektoj institucionin e kryetarit. Këtu është përfol për kandidat, gjëja se nuk i kanë plotësua kriteret, gjëja se s'ka pas dokumentacione. Ata të ashtuquajtur shoqëri civile që kanë marr pjesë aty, nuk e di pse i ka emërua Mytaher Haskuka. Ata i kanë shërbye drejt e jo procesit.

Nëse i shikoni CV-it e kandidatëve që ua kam dhënë këtu. Gjene një kandidat të vetëm, vetëm një të vetëm që nuk i plotëson kriteret. Po flas në kuptimin profesional edhe ligjor. Vetëm një kandidatë gjene kanë CV-i të gatshme. A kanë qenë krejt me CV-i. Sigurisht kanë qenë, se mos me pas qenë me CV-i ata nuk u boshin pjesë e intervistimit. Por zgjedhja ka qenë kjo. Nga 18 kandidatë që kanë qenë, se aludohet me një diskutim që janë të Nismës. A absolutisht nuk janë të Nismës. A ka të Nismës, po ka edhe mirë është që ka edhe ka me pas. Sepse tek e fundit partitë politike vinë në pushtet edhe për të udhëheqë me institucione. Po a ka edhe të partisë demokratike, mos me banalizua që s'është ndërrua, ka. Aludimi në shkollën ti ku po aludon, nuk qëndron ashtu. Nuk po dua me të thënë këtu. Po vjen momenti që e them. Nga 18 që kanë konkurrua vetëm 6 janë që janë ndërrua, ose kanë lëvizë. Sepse tetë janë që kanë mbet aty. Jo që na ndoshta kemi dashtë mi lënë, po kanë mbet aty. Janë edhe pesë drejtorë të shkollave të cilët nuk kanë aplikua, për rrethanat të cilat ata i dinë. Realisht ne kemi pas lëvizje vetëm me gjashtë. Edhe njëherë po them publikisht procesi totoleshit është ligjor, pa asnjë shkelje të vetme. Le të del nga krahu i djathë, ju që keni fol nëpër portale, cili prej kandidatëve nuk i plotëson kushtet le thotë këtu. Gjenerali shkeljen e vetme ligjore që e ka bërë Drejtoria Komunale, përkatësisht komisioni. Që ku e keni drejtorin. Nëse juve nuk ju pëlqejnë emrat e kandidatëve, është çështje tjetër. Po nëse doni edhe për emrat e kandidatëve Skender Susuri jua thotë këtu. Skender Susuri nuk ka ra as në presionin që ia kanë bo atje grupet e komuniteteve, që kanë kërkuar anulim konkursi padrejhtësisht. Skender Susuri edhe njëherë po them mbaj përgjegjësi të plotë. Edhe i jap mbështetje të plotë komisionit i cili ka bo poentim. Kur të kthehet kryetari Haskuka, për mos me ju lënë me merak, unë do të bisedoj me kryetari Haskuka. Do ta shoh arsyen, a ka anulua ndonjë pjesë të konkursit apo gjithë konkursin. Dhe varësisht nga qëndrimi i Mytaher Haskuka, Skender Susuri merr vendime për të ardhmen e vetë politike. Sepse unë nuk e kam karrierën politike ose profesionale të lidhur me vendin e drejtorit. Ama Skender Susuri kurrë mbani në mend, kurrë nuk ka me lënë komisionin për përzgjedhje, më thënë që komisioni ka pas faj. Edhe njëherë po ju them, qëndroj fuqishëm prapa komisionit për procedurën, jo për poenët. Poenët nëse ata nuk i vendos mirë, ata e kanë të qartë procesin. Për procedurën, që ku më keni. Për emra të përveçëm tregoni cili prej kandidatëve nuk e ka CV-në. Ata që nuk kanë hy, është normale. Janë poentua kaq sa janë poentua. Por asnjë kandidatë i vetëm nuk është që nuk i ka plotësua kushtet. Prandaj që ky Kuvend duhet ta di që Skender Susuri, komisioni ka punua plotësisht me Udhëzimin Administrativ 8/14. Edhe njëherë po ju them juve që ju kam në anën e majtë. Faleminderit për korrektësinë që keni pas në raport deri te që ky proces.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor, faleminderit ju drejtorë që qëndruat deri në fund këtu, faleminderit nënkryetari i komunës. Kërkoji nga anëtarët e Kuvendit, të fotografohen jashtë, se është duke pritë fotografisti, për ata që nuk i

keni bo fotografitë për ueb sajtin e komunës. Ju kisha lut kryeni sa jeni këtu, sepse po është problem mandej me ju grumbullua të gjithëve. Faleminderit për pjesëmarrje dhe mirë u pafshim në mbledhjen e radhës.

Përfundoi në orën 16:00.

Procesmbajtës;  
Sehat Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit  
Artan Abrashi